Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (86). QERSHOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



INTERVISTË
Dibra duhet të unifikohet me mençurinë
Intervistë me **Dr.SADIK H. LALA** - FAQE 8,9

BOTIME
"Dibranë dhe Tiranas 100 vjet së bashku"
FAQE 19

KRITIKË LETRARE
Ideali kombëtar në një libër
Nga **XHAFER MARTINI** - FAQE 14,15

MENDIME
Të jetosh mes magjisë së shkronjës
Nga **NAMIK SELMANI** - FAQE 18

Rruga e Arbrit, fillimi i rilindjes kombëtare

Deputetë të Dibrës, bëni diçka për Dibrën, sipas rregullave, tani që e keni në dorë. Mos kërkoni që Dibra të trajtohet me preferencë, por thjesht që Dibrës t'i jepet ajo që i takon: Rruga e Arbrit

Nga **GËZIM ALPION** - FAQE 2



Rakip Suli, i pari djathtas,me kryetarin e Partisë Socialistë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

Intervistë me z.Rakip Suli, deputeti dibran i Tiranës

Rruga e Arbrit, një projekt strategjik që do ta çojmë përpara me shumë vullnet

Rruga e Arbrit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për Dibrën, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton distancën mes Tiranës dhe Dibrës, por garanton një zhvillim për një territor të tërë, që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për Partinë Socialiste hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet. Shpreh bindjen e plotë se përfundimi i saj do të jetë një realitet brenda mandatit të parë të qeverisjes së Partisë Socialiste me Edi Ramën kryeministër.

LEXONI NE FAQE 3

PORTRET
Haxhi Lleshi sipas dokumenteve
Nga **HILË LUSHAKU** - FAQE 21,23

KULTURË
Një fenomen artistik i trashëgimisë që duhet mbajtur ndezur
Nga **ESAT RUKA** - FAQE 17

MJEDISI
Menaxhimi i parqeve në zonën ndërkufitare
Nga **BESNIK ALKU** - FAQE 6

AKTUALITET
Rrugës për Brezhdan
Nga **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 7

PORTRET
Eshref Çutra: Kënga na gëzonte
Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 16

POEZI
" …dhe zogjtë e vendlindjes fluturojnë"
Nga **ISLAM ÇENGA** - FAQE 20


cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (86). 1 - 30 Qershor 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Mustafa Tola, Hysen Repa, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Gëzim Alpion
Xhafer MARTINI
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Esat RUKA
Fejzulla GJABRI
Destan RAMA
Islam ÇENGA
Hilë LUSHAKU
Namik SELMANI
Selman MEZIU
Besnik ALKU
Afrim KAROSHI
Ilmi Dervishi

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Le të jetë Rruga e Arbrit fillimi i rilindjes kombëtare



Deputetë të Dibrës, bëni diçka për Dibrën, sipas rregullave, tani që e keni në dorë. Mos kërkoni që Dibra të trajtohet me preferencë; por thjesht që Dibrës t'i jepet ajo që i takon: Rruga e Arbrit

Nga **Dr.Gëzim Alpion** - *Angli*

Tani që rezultatet e zgjedhjeve të 23 Qershorit u pranuan zyrtarisht, ne intelektualët dibranë, që iniciuam peticionin online për Rrugën e Arbrit, do t'iu luteshim të na përkrahni pa rezerva në mënyrë që kjo vepër e rëndësishme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të përfundojë sa më shpejt.

Ne i urojmë suksese Qeverisë se re që do të krijohet së shpejti dhe shpresojmë që të kemi për herë të parë në politikën shqiptare një opozitë konstruktive dhe besnike, ashtu siç ndodh në demokracitë perëndimore, ku interesat e vendit gjithmonë përparësohen mbi interesat e partisë apo kaulicionesh partiake.

Sot është fillimi i vërtetë i peticionit. Ju premtojmë se ne nuk do të rreshtim së lobuari për Rrugën e Arbrit deri në përfundimin e metrit të fundit.

Edi Rama u premtoi dibranëve gjatë fushatës se do ta përfundojë Rrugën e Arbrit po qe se e majta do të fitonte. Intelektualët dibranë do t'ia freskojnë kujtesën Kryeministrit Rama dhe Kabinetit të tij çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj që ata të dëshmojnë me fakte se e kuptojnë se sa e rëndësishme është që në truallin shqiptar të gjitha rrugët të kalojnë në Dibër.

Na vjen vërtet mirë që askush deri tani nuk na kaq quajtur 'lokalistë' dhe se peticioni ynë është përkrahur nga një numër i madh bashkëatdhetarësh në të gjitha trojet shqiptare dhe në Disaporë si dhe nga shumë të huaj nga e gjithë bota. Kjo dëshmon se shqetësimi ynë për gjendjen mjeranë të Dibrës reflekton edhe pakënaqësinë tuaj ndaj Tiranës dhe Prishtinës për injorimin e një numri të madh zonash në Shqipëri dhe Kosovë. Përkrahja juaj dëshmon edhe shqetësimin tuaj të ligjshëm ndaj disa qeverive të tjera në Ballkan të cilat prej kohësh kanë lenë pas dore disa krahina duke ngadalësuar kështu procesin e afrimit të popujve të këtij rajoni me njëri tjetrin dhe integrimin e tyre evropian.

Dhe së fundi, një mesazh i shkurtër për deputetët e rinj të Dibrës. Ne shpresojmë që ju të na përkrahni në iniciativën tonë. Ne nuk do të bëjmë dallim mes deputetëve të së majtës apo të së djathtës. Për ne ju jeni thjesht deputetë të Dibrës. Po qe se flisni si të majtë apo të djathtë, dibranët do të dinë si t'i trajtojnë partitë tuaja pas katër vitesh. Bëni diçka për Dibrën, sipas rregullave, tani që e keni në dorë dhe mos u ngjani merhumëve para jush të cilët, që nga fillimi i shtetit shqiptar, më shumë e kanë çpërfaqësuar një zonë që gjeografikisht dhe historikisht është zemra e kombit shqiptar. Nuk kërkojmë që Dibra të trajtohet me preferencë; duam thjesht që Dibrës t'i jepet ajo që i takon. Le të jetë Rruga e Arbrit fillimi i rilindjes kombëtare.

Jemi të sigurt se shumë prej jush kur të përfundohet Rruga e Arbrit do t'i kaloni pushimet në Dibër, peizazhi epik i së cilës si dhe mikpritja e dibranëve do t'iu mbeten në kujtesë përgjithmonë.

Falenderim i Gëzim Alpion para zgjedhjeve

Ky është mesazhi i fundit që po përcjell në FB për peticionin online për Rrugën e Arbërit para 23 Qershorit.

Në emër të intelektualëve dibranë, që po punojmë me përkushtim për të sensibilizuar opinionin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, për rëndësinë e kësaj Rruge, ju jam shumë mirënjohës për nënshkrimin e këtij peticioni jo politik. Me përkrahjen tuaj ju treguat se dini të dalloni midis devotshmërisë ndaj partive që përkrahni dhe dëshirës së mirë që keni për të shikuar një angazhim të drejtpërdrejtë të shtetit për zhvillimin e krahinave si Dibra të lëna pas dore që nga shpallja e Pavarësisë.

Javët e fundit Dibra veçanërisht është bërë një Mekë për drejtuesit kryesor të shtetit dhe partive kryesore. Ne po i trajtojmë këto pelegrinazhe si një tregues i mbarë, veçanërisht prononcimet publike të Kryeministrit dhe Kryetarit të Opozitës se do të përfundojnë sa më shpejt Rrugën po qe se fitojnë zgjedhjet.

Ne që iniciuam peticionin në asnjë moment nuk kemi sharë apo treguar me gisht ndonjë parti apo qeveri si përgjegjëse për gjendjen mjeranë të Dibrës. Dhe këtë e bëjmë jo se nuk e dimë se kush janë fajtorët por sepse kemi vendosur të shikojmë përpara.

Për shumë nga ju, aktiviteti politik përfundon më 23 qershor. Për intelektualët Dibranë në Shqipëri dhe Diasporë, angazhimi ynë me mjete transparente demokratike për të realizuar sa më parë përfundimin e Rrugës së Arbrit dhe për të shikuar investime konkrete në Dibër fillon menjëherë pas 23 Qershorit.

Unë do t'iu uroj sukses që tani deputeteve të Dibrës që do të zgjidhen më 23 Qershor por dëshiroj që t'iu dërgoj një mesazh parazgjedhor që ta kenë të qartë që tani se ne nuk do t'i lemë rehat deri sa të shikojmë se e justifikojnë besimin e votuesve dibranë.

Mua dhe miqve të mi intelektualë që po lobojmë për Rrugën e Arbrit nuk na intereson politika. Qëllimi ynë i vetëm është ndërtimi i Rrugës dhe progresi i Dibrës. Dhe për t'ia arritur këtij qëllimi, ne nuk do të hezitojmë t'i ngremë llafet (siç thuhet në Dibër) publikisht me këdo që të vij në pushtet më 23 Qershor po qe se pushtetarët e rinj kujtojnë se Dibra do të tolerojë të trajtohet edhe në të ardhmen si një koloni të cilës mund t'i vidhen pasuritë mbitokësore dhe nëntokësore dhe burimet njerëzore.

Le të shpresojmë se do të kemi zgjedhje të ndershme dhe të pakontestueshme.

Edhe një herë, shumë faleminderit për ndihmën që na keni dhënë dhe për përkrahjen që do të na jepni pas 23 Qershorit, që shënon edhe fillimin e vërtet të peticionit.





Rakip Suli duke folur në këndin e fjalës gjatë fushatës elektorale, qershor 2013. Foto: © Jutta Benzenberg

Rruga e Arbrit, një projekt strategjik që do ta çojmë përpara me shumë vullnet

Rruga e Arbrit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për Dibrën, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton distancën mes Tiranës dhe Dibrës, por garanton një zhvillim për një territor të tërë, që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për Partinë Socialiste hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet. Shpreh bindjen e plotë se përfundimi i saj do të jetë një realitet brenda mandatit të parë të qeverisjes së Partisë Socialiste me Edi Ramën kryeministër.

Flet Rakip Suli, deputeti dibran i Tiranës

Unë jam krenar që jam deputet i Njësisë 11. Dhe jo vetëm i atyre që kanë votuar për Rilindjen dhe aleatët e tyre, por për të gjithë banorët, pa dallime partiake, pa dallime krahinore dhe pa dallime origjine. Për të gjithë njëlloj dhe për të gjithë i përkushtuar.

Rakip Suli është njëri nga deputetët e rinj të Parlamentit shqiptar për Qarkun e Tiranës. Një javë pas zgjedhjeve ai shfaqet i qetë në kafen e mëngjesit që në orën 9, por për të ardhur nga hyrja e lokalit deri te tavolina ku e prisja, i duhen më shumë se 10 minuta. Më të gjithë klientët ka një njohje miqësore apo shoqërore, kështu që nuk përton t'i takojë të gjithë. Ata e urojnë për fitoren dhe ai i pret falënderimet me shumë përulësi.

Rakipi ishte drejtori i gazetës Rruga e Arbërit dhe që nga dita e parë e botimit të saj, ka qenë njëri nga donatorët e saj. Tani, me fitimin e mandatit të deputetit, i duhet të tërhiqet nga gazeta. Unë i dorëzoj një kopje të certifikatës nga QKR që ai nuk është më në bordin e gazetës dhe, pasi e lexon, ndjen një lloj mërzie të lehtë, ku dallohen në fytyrën e tij edhe nuancat e keqardhjes.

- Mandati i deputetit ju detyron të bëni një largim nga stafi botues i gazetës, por kontributi juaj në botimin e gazetës Rruga e Arbërit ka qenë shumë i rëndësishëm për krijimin e një medie të lirë dhe të hapur rajonale. Si ndjeheni tani dhe si e kujtoni këtë angazhim?

- Për mua ka qenë një privilegj i madh dhe një kënaqësi e jashtëzakonshme që kam pasur fatin të jem pjesë e një stafi që ka punuar me plot pasion për promovimin e vlerave dibrane, kudo që ndodhen ato. Ka qenë kënaqësi e imja të punoj me Musa Riçkun, Shaqir Skarrën, Bujar Karoshin në themelimin e gazetës dhe së bashku me shumë intelektualë të tjerë që kanë bashkëpunuar me gazetën, arritëm të preknin shumë dimensione reale që lidheshin me Dibrën dhe problematikat që e shqetësojnë atë. Në krijuam një media të hapur dhe për herë të parë krijuam një gazetë që i ka trajtuar problemet e dibranëve pavarësisht ku jetojnë ato, në Republikën e Shqipërisë apo në atë të Maqedonisë, në Tiranë apo New York, në Durrës apo Fushë Krujë, etj. Unë edhe në të ardhmen do të jem një mbështetës i këtij stafi dhe do të ndjek në vazhdimësi sukseset e mëtejshme të tyre.

- Ju nuk keni qenë vetëm një mbështetës i gazetës, por prej gati më shumë se një dekadë, ju jeni edhe një mbështetës i veprimtarive të organizatave joqeveritare dhe keni ndihmuar shumë edhe në promovimin e vlerave të Dibrës, në sport, kulturë, art etj.

- Bashkëpunimi që kam pasur me shoqërinë civile, sidomos atë dibrane, më ka dhënë kënaqësi të pamat. Sukseset e artistëve, sportistëve, shkrimtarëve e poetëve, sado që sot them se ndihma ime ka qenë modeste, më ka bërë të ndjej kënaqësi të herëpashershme. Njëkohësisht, kontaktet që kam pasur me këto shtresa të popullsisë më kanë bërë të shikoj përtej asaj që duket dhe më ka frymëzuar që të hyj në politikë. Por, këtë pozicion të ri do ta shfrytëzoj në maksimum. Do ta përshkallëzoj dhe më tej këtë lloj kontributi, duke shfrytëzuar çdo hapësirë që politika dhe parlamentarizmi më ofron. Mbetem i angazhuar për drejtësi sociale, për fuqizimin e shoqërisë civile dhe për të sjellë një qasje sa më pozitive midis politikës dhe faktorëve jo politikë.

Pastaj biseda shkon te fushata që sapo ka kaluar. Emocionet që Partia Socialiste dhe Aleanca për Shqipërinë Europiane ka fituar dallohen lehtë, por edhe suksesi i tij në zonën që ka kandiduar e bën të ndjehet krenar.

- Dy vjet më parë, ju kandiduat për kryetar të Bashkisë së Kamzës, proces të cilin e humbët me pak diferencë, por Partia Socialiste i fitoi në tërësi zgjedhjet lokale dhe shembulli juaj, bashkë me Kavajën dhe disa zona të tjera ku e djathta dominonte prej 20 vitesh, u kthye në një frymëzim për të majtën në gjithë vendin. Ndërkohë, Partia Socialiste dhe kryetari i saj, ju besoi në këto zgjedhje gjithashtu një bastion të së djathtës në Tiranë. Unë e kam ndjekur fushatën tuaj përmes rrjeteve sociale dhe medias dhe ajo ka qenë shumë e vështirë. Si ndjeheni tani pasi ju fituat mandatin e deputetit dhe a i morët frytet që prisnit?, - ishte një pyetje tjetër rreth politikës aktuale.

- Tani ndjehem shkumë krenar për këtë arritje, thekson Rakip Suli. Ndjehem krenar për rezultatin e thellë, por mbi të gjitha për faktin që së bashku me qytetarët e Njësisë 11, Laprakës dhe zonave përreth, arritëm të sjellim fitore me një votë që u derdh lumë pro Rilindjes. Ndjehem i nderuar që Lapraka me votë besoi, dhe tani ndjehem më i gatshëm që t'i përkushtohem me devotshmëri realizimit të premtimeve dhe programit tonë të qeverisjes. Kjo fitore më ka energjizuar pozitivisht për t'i përfaqësuar ata sa më denjësisht.

- Zona juaj elektorale ka shumë dibranë dhe në një farë mënyre, mund të themi se ju jeni edhe një deputet i Dibrës?

- Po, është e vërtetë. Në Laprakë ka shumë dibranë që banojnë, por atje ka edhe korçarë, gramshiotë, tepelenas, kuksianë, tropojanë, tiranas, etj. Ka nga të gjitha komunitetet dhe unë jam krenar që jam deputet i tyre. Dhe jo vetëm i atyre që kanë votuar për Rilindjen dhe aleatët e tyre, por për të gjithë banorët, pa dallime partiake, pa dallime krahinore dhe pa dallime origjine. Për të gjithë njëlloj dhe për të gjithë i përkushtuar.

- Njëri nga kontributet tuaja të mëparshme ka qenë promovimi dhe lobimi për Rrugën e Arbrit dhe tashmë ky projekt është kthyer edhe në një premtim të rëndësishëm elektoral për partitë politike dhe veçmas për PS, si fituese e zgjedhjeve? Si do ta ruani këtë kontribut, tani që ju jepet mundësia të jeni edhe një zë më shumë në Kuvendin e ardhshëm?

- Do vazhdoj ta jap këtë kontribut deri në realizimin e Rrugës së Arbrit. Edhe pse jam deputet i Tiranës, do të jemi përkrah deputetëve të Dibrës Shkëlqim Cani dhe Ulsi Manja, së bashku me deputetin tjetër të Tiranës, kolegun Sadri Abazi, për ta bërë realitet këtë premtim të dhënë nga Edi Rama. Partia Socialiste dhe deputetët e saj e kanë shprehur vazhdimisht se prioriteti kryesor i tyre është Rruga e Arbrit. Për deputetët e Dibrës dhe gjithë dibranët në Parlament, Rruga e Arbrit është kryesorja, por pa harruar edhe angazhimet tona për minierat, për bujqësinë, infrastrukturën e ujitjes, pemëtarinë etj.

Siç e ka theksuar në këtë fushatë edhe kryeministri i ri, Edi Rama, Rruga e Arbrit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për Dibrën, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton distancën mes Tiranës dhe Dibrës, por garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për Partinë Socialiste hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet. Shpreh bindjen e plotë se përfundimi i saj do të jetë një realitet brenda mandatit të parë të qeverisjes së Partisë Socialiste me Edi Ramën kryeministër.

> Ka qenë kënaqësi e imja të punoj me Musa Riçkun, Shaqir Skarrën, Bujar Karoshin në themelimin e gazetës dhe së bashku me shumë intelektualë të tjerë që kanë bashkëpunuar me gazetën, arritëm të preknin shumë dimensione reale që lidheshin me Dibrën dhe problematikat që e shqetësojnë atë.

- Siç e dini, dy muaj para fushatës, po qarkullon në internet një peticion që do t'i dorëzohej qeverisë së pas zgjedhjeve të 23 qershorit, për t'i mbajtur premtimet për Rrugën e Arbrit. Ju më keni thënë gjatë fushatës se peticionin për Rrugën e Arbrit do ta firmosnit pas zgjedhjeve. Pse e kishit marrë atë vendim?

- Ishte një vendim personal. Vendimi im për ta firmosur pas zgjedhjeve, ishte një sfidë me veten, për ta firmosur në një moment kur përgjegjësia mbi firmën time të ishte edhe më e madhe.

Sot, si deputet në Kuvendin e Shqipërisë i forcës qeverisëse që unë përfaqësoj, kam detyrimin të përmbush këtë angazhim timin të nisur që herët. Dhe unë firmos këtë peticion, bashkë me angazhimin tim, që Rruga e Arbrit do jetë një rrugë me standardet europiane dhe që do të përmbushë vullnetin e gjithë banorëve të qarkut të Dibrës, këndej dhe andej kufirit shtetëror dhe që padyshim do të mbajë firmën e kryeministrit Edi Rama".

Faleminderit dhe suksese, jo vetem si deputet i Njesise 11, por edhe si një përfaqësues i zërit të Dibrës dhe dibranëve në Kuvendin e Shqiperise!

Bisedoi: Bujar Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 86

Hamit Sadiku, KERCOVE, MACEDONIA: Kjo rrugë është shumë e rëndësishme për të gjithë Maqedonasit, Shqiptarët dhe qytetarë të tjerë sepse shkurton rrugën mes Tiranës dhe Shkupit.

opinione

Nuk ka Shqipëri të zhvilluar pa **Rrugën e Arbrit**

Mjaft qytetarë që kanë firmosur peticionin për rrugën e Arbërit, kanë nënshkruar edhe mendimet e tyre se pse ndërtimi i saj është i rëndësishëm për ta. Opinionet janë të hapura në faqen e web "change.org" dhe shumë prej tyre janë në gjuhën angleze. Opinionet do të bëhen publike numër pas numri, duke mbledhur kështu argumentet që do të botohen në një botim të posaçëm, që do t'i bashkëngjitet peticionit.

Redaksia nuk boton opinionet e shprehura në faqen e FB të gazetës apo rrjetet e tjera sociale, përveç rasteve kur ato përcillen me email për botim në adresën e gazetës.

Redaksia do të mirëpresë në vazhdim edhe opinione e studime specialistësh, me argumente të tjera "pro" ndërtimit të rrugës dhe avantazhet që ajo sjell për ekonominë kombëtare.



Foto: © Bujar Karoshi

Valbona Velickova, SPAIN: Sepse është shtëpia e prindërve të mi.

Lea Damzi, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme, jo vetëm për mua por për gjithë komunitetin të cilit i përkas, e më tej për gjithë vendin. Kështu që le ta ndërtojmë këtë rrugë.

Shaban Driza: Të ndërtojmë Shqipërinë e re! Të ndërtojmë Rrugën e Arbërit! Të ndërtojmë të ardhmen tonë! Të ndërtojmë shoqërinë tonë!

Anxhelina Lazri, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Selvana Sadikaj, PESHKOPI, ALBANIA: Mbaj mend që e vogël të flitet për Rrugën e Arbërit dhe akoma ngelet jashtë realitetit... Ndërtimi i kësaj rruge do të ndihmojë në zhvillim, ekonomi, infrastrukturë. Do të lehtësojë së tepërmi transportin Tiranë-Peshkopi që është vërtet i rëndësishëm për në studentet... Rruga është e rëndësishme për të gjithë ne. Ne meritojmë më shumë...

Genta Saraçi, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë do të sjellë zhvillimin e një qyteti dhe një rrethi plot vlera të harruara. Gjithashtu lidhje më të shpejtë të pjesëve lindore të Ballkanit me Italinë dhe më tej në pjesën perëndimore.

Jonida Uka, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme për mua, për gjithë dibranët dhe jo vetëm. Vetëm ne që jemi larg dhe e bëjmë herë pas herë atë rrugë ja dimë rëndësinë e vërtetë realizimit të këtij projekti. Për të gjithë dibranët do jetë një hap drejt zhvillimit dhe afrimit më shumë me kryeqytetin.

Shumë dibranë nuk do detyrohen të shpërngulen nga qyteti i tyre sepse nuk do jetë më e nevojshme. Do rritet më shumë numri i turistëve që do vizitojnë Dibrën dhe kjo patjetër që do e zhvillojë më tej vendin. Është tortuese rruga ekzistuese dhe shumë e gjatë ndërkohë që nuk jemi aq larg në vijë gjeografike nga Tirana. Dibranët nuk e meritojnë të lihen pas dore...Ndaj do e dëshiroja pa masë të ndërtohej Rruga e Arbrit... dhe kam besim që do bëhet!

Marge Palo, ITALY: Sepse rrugët janë të nevojshme për kulturën e për më shumë.

Adriatik Balla, BULQIZË, ALBANIA: Sepse nga rruga Dibra do të ketë përfitime të mëdha ekonomike

Romina Canka, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për të rritur nivelin e jetesës në atë pjesë në të cilën papunësia është e lartë, është një rritje ekonomike për vendin tonë. Do të kemi shume përfitime si shtet nga rregullimi i kësaj infrastrukture.

Alina Adamska - Gurra, WSTON-SUPER-MARE, UNITED KINGDOM: Ndërtimi i kësaj rruge do ta bënte rrugëtimin për në Dibër shumë më të këndshëm dhe të shkurtër në kohë. Shpresoj ta shikoj këtë rrugë të ndërtuar sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të gjithë ta mbështesin këtë peticion për të mirën e të gjithë komunitetit.

Erion Hysa, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse unë jetoj aty.

Andi Karasani, TIRANA, ALBANIA; të përfundojë sa më shpejt rruga e ARBRIT

Valentina Kotani, TIRANË, ALBANIA: Mbështes dhe unë për ndërtimin e Rrugës Arbërit.

Adnan Vranezi, PESHKOPI, ALBANIA: Jep zhvillimin e zonës së Dibrës

Argjend Hoxha, MAQELLARE, ALBANIA: Sepse Krijohet mundësi më e mirë për Dibrën

Selami Rustani, ITALY: Është shumë e rëndësishme në të gjitha aspektet... politikanë, mos humbisni më shumë kohë sepse historia do t'ju dënojë...

Mario Merdini, DIBRA, ALBANIA: Është e rëndësishme për zhvillimin e vendit

Aron Myrte, BULQIZË, ALBANIA: Sepse ndryshe, pa rrugën s'do ketë zhvillim për zonën e Dibrës, rruga është komunikim, zhvillim e integrim drejt së ardhmes, është interes qytetar e jo interes idealizmi politik.

Elsa Toçi, ITALY: Unë jam nga Dibra!

Holta Xhurxhi, TIRANA, ALBANIA: Këtë gjë e dua pasi Vendlindja ime do jetë më afër me Tiranën

Lejdi Dervishi, ITALY: Ndërtimi i infrastrukturës në nivele të larta është e vetmja rrugë për ti dhënë hov zhvillimit të shumëdëshiruar të ekonomisë shqiptare.

Bojken Osmani, PESHKOPI, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për Shqipërinë.

Ernesto Santucci, ROME, ITALY: Rrugë vitale për progresin e Shqipërisë

Baftjar Damzi, DIBËR, ALBANIA: Rruga e Arbërit është nyje shumë e rëndësishme që lidh të dy Dibrat, me Tiranën dhe Durrësin si dhe i jep zhvillim rajonit të Dibrës. Gjithashtu lidh edhe vendet e Ballkanit me Shqipërinë, ku shkurtohet më shume se 100 km. Dibranët janë të lidhur ngushtësisht me Tiranën, ku një pjesë e mirë e tyre kanë gjakun në Tiranë e Durrës. Qeveria duhet ta kishte bërë më parë, por për interesa politike ka bërë rruge të tjera. Prandaj unë mendoj se kjo rrugë duhet të bëhet sa me shpejt, në të mirë të popullit.

Andi Deshati, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë i sjell jetë Peshkopisë sepse tani për tani është "e vdekur"...

Denis Balliu, ITALY: Sepse jetoj në Peshkopi, dhe kam qejf të bëj një udhëtim të rehatshëm. Bëj 1000 km në Itali e as nuk e ndjej fare udhëtimin, pastaj bëj 200 km për Peshkopi nga Durrësi dhe ndjehem i dërrmuar. Por më e rëndësishmja, është për njerëzit që jetojnë aty edhe për vendet e bukura që janë në ato anë.

Bronilta Hysa, BOZEN, ITALY: Sepse jam lindur e rritur aty...

Mihrije Kela, ZÜRICH, SËITZERLAND: E dua vendin tim dhe dua që të jetë vend modern e praktikë për qytetarët.

Arsen Murati, PESHKOPI, ALBANIA: Ndihmon zhvillimin e zonës së Dibrës.

David Peci, GREECE: Për të ndihmuar shqiptarët.

Ina Bajraktari, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Shpetim Nuredini, DIBRA E MADHE, MACEDONIA: Lidh kërthizën e trojeve shqiptare Tiranën dhe bregdetin shqiptar.

Almario Uka, PESHKOPI, ALBANIA: Për zhvillimin ekonomiko-kulturor të zonës së Dibrës.

Erlir Fero, ELBASAN, ALBANIA: E rëndësishme është gjithçka e mirë për këtë vend. Por kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur një vepër reklamohet aq shumë dhe përdoret për vota...pa u bërë... pa u bërë... pa u bërë. Shqipëria duhet të marrë frymë lirisht me rrugë e të mira të tjera por derisa bëhen me paratë tona është mirë ta qepin gojën e mos na shiten si zota e qenie mistike.

Klajdi Deshati, MARINETTE, WI, UNITED STATES, ALBANIA: do të ishte më e lehtë për të udhëtuar dhe jetuar aty.

Almir Kulla, TIRANA, ALBANIA: Sepse shtëpia ime është asaj rruge.

Eni Prifti, TIRANA, ALBANIA: Mbaroni ndërtimin e rrugës së Arbrit.

Enriko Ceko, TIRANA, ALBANIA: Zhvillim ekonomik, social dhe kulturor.

Naim Krasniqi, BRUXELLES, BELGIUM: Për zhvillimin ekonomik të regjionit

Arbër Cami, GERMANY: Origjina e familjes sime është nga Dibra dhe ndjehem sikur i përkas atij vendi. Të gjithë urojnë më të mirat për njerëzit e tyre dhe Dibra është e imja gjithashtu. Do t'ju mundësoje atyre njerëzve që jetojnë aty një jetë më të mirë dhe mundësi më të mira për të konkurruar në treg.

Wojciech Klepuszwski, KOSZALIN, ROMANIA: Rruga do të ndihmojë Shqipërinë të integrohet në Europë.

Ernesto Santucci, ROME, ITALY: Rrugë vitale për progresin e Shqipërisë.

Stephen Guy-Bray, VANCOUVER, CANADA: Ndërtimi i rrugës do të sjellë bashkë disa vende dhe do të përmirësojë infrastrukturën e Ballkanit.



Foto: © Bujar Karoshi

Ildo Nelollari, TIRANA, ALBANIA: Sepse rruga e vjetër është shumë e gjatë dhe është shumë e prishur

Florin Shala, TIRANA, ALBANIA: Sepse dua t'ia di për shqiptarët gjithandej.

Ergys Prifti, TIRANA, ALBANIA: Për një zhvillim ekonomik të të gjithë Shqipërisë

Ziber Lata, DIBËR, MACEDONIA: Rruga e Arbërit, e duam më shpejtë

Merita Brahimi, PRISHTINA, ALBANIA: Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit dhe do ti japë hov zhvillimit të ekonomisë lokale.

Halil Hamzaj, SUHAREKE, KOSOVO: Që rruga të ndërtohet.

Eduard Miftari, TIRANË, ALBANIA: Kjo rrugë nuk është e nevojshme vetëm për ne dibranet, por është e nevojshme për të gjithë shqiptarët, që mendojnë për të mirën e këtij kombi. Në qarkun e Dibrës ndodhet miniera e Bulqizës e cila është e dyta në Evrope mesa di unë. Kemi një pasuri të pallogaritshme, për sa i përket turizmit 'Parkun Kombëtar të Lurës' ku përfitimet e çdo lloj qeverie që mund të jetë në pushtet do jenë tepër të mëdha. Kjo rrugë do ndikoje dukshëm në zhvillimin e import-eksportit me Maqedoninë. Pa shkruajtur shumë gjera të tjera kuptohet se kjo rrugë është e një rëndësie kombëtare. Me respekt Eduard Miftari.

Fatmir Osmani, GRAZ, STMK., AUSTRIA, AUSTRIA: Nuk ka Trup të shëndoshë pa gjymtyre të shëndosha, rrugët janë gjymtyrët e Kombit.

Monika Shehi, GREENVILLE, SC: Që të integrohet më mirë veriu i Shqipërisë. Rrugët janë të shkatërruara dhe e shkatërrojnë turizimin.

Sanela Kolar, MONTENEGRO: Turizm!!

Elisa Spahiu, TIRANA, ALBANIA: Është e domosdoshme për të gjithë shqiptarët...

Luiza Damzi, TIRANA, ALBANIA: Sepse është në të mirë të të gjithë shqiptarëve

Altin Balliu, CORFU, GREECE: Në radhë të parë ndihmon shumë banorë të varfër andej, e dyta është se rrugët duhen në çdo zonë se nuk kemi territor për të humbur, as për të lënë tokat në shkurre, çdo cep në shfrytëzim

Melsi Shahini, TIRANA, ALBANIA: Ndërtoni rrugën e Arbrit.

Ameraldo Muca, BARI, ITALY: Jam lindur në Bulqizë.

Stephen Guy-Bray, VANCOUVER, CANADA: Ndërtimi i rrugës do të sjellë bashkë disa vende dhe do të përmirësojë infrastrukturën e Ballkanit.

Mentor Farruku, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i kësaj rruge sjell dobi.

Selami Rustani, ITALY: është shumë e rëndësishme sepse ju jep dinjitet të gjithë dibranëve e cila është prej kohësh e mohuar. Me respekt Selami Rustani, Itali.

Bledi Meda, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme për shumë arsye.

Ruben Agadzhanyan, RUSSIAN FEDERATION: Sepse jam për integrimin Europian.

Wojciech Klepuszwski, KOSZALIN, ROMANIA: Rruga do të ndihmojë Shqipërinë të integrohet në Europë.

Erald Kojku, PESHKOPI, ALBANIA: Na afron me njëri-tjetrin.

Marija Knezevic, NIKSIC, MONTENEGRO, BOSNIA AND HERZEGOVINA: Udhëtoj shpesh përmes Shqipërisë dhe e vlerësoj rregullimin e çdo lloj rruge. Ndërtimet në gjithë vendin kanë qenë impresionuese në tre vitet e fundit. Kam edhe shumë miq shqiptarë dhe jam e gëzuar të dëgjoj që jeta e tyre përmirësohet dhe janë më të sigurt në rrugët e tyre.

Basri Laçi, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua për arsye se atje kam pronat e mia dhe në qoftë se do të ndërtohet Rruga e Arbërit kështu unë mund të shkoj dhe mund t'i punoj ato ...

Jehana Salkurti, PESHKOPI, ALBANIA: Të përmirësojë jetën e banorëve të Dibrës.

Maksim Cami, DURAZZO, ALBANIA: udhëtime të shpeshta në vendlindje dhe vendeve të bukura që lidh kjo rrugë...

Sonila Sula, DISTRETTO DI TIRANA, ALBANIA: Jam lindur në Dibër.

Ridian Billa, HELSINKI, FINLAND: Vendlindja ime.

Valbona Skarra, ESSEX, UNITED KINGDOM: Lindur në Peshkopi, Dibër, Shqipëri.

Osman Kulemani, YONKERS, NY: Është e rëndësishme për të gjithë ne.

Ahmet Shehu, TIRANË, ALBANIA: Përshendetjet më të sinqerta Dibrane. Shpresojmë në plotësimin sa më të shpejtë të premtimit që shumë pushtetarë kanë bërë. Kjo rrugë është vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë si nga ana ekonomike dhe kulturore..

Alket Gjika, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë rajonin.

Bajram Cara, ALBANIA: Kontribut për vendin tim të lindjes, për vendin ku u rrita, u arsimova e kulturova, për vendin tim që çdo dibran ndihet krenar që është dibran.....

Vani Manjani, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës së Arbrit sa më shpejt

Drilon Letmi, DEBAR, MACEDONIA: Pse është e rëndësishme? Sigurisht që është e rëndësishme, sepse jam 21 vjeç, dhe kam të paktën që kur isha 9 vjeç që e dëgjoj dhe stërdëgjoj si çështje, por aha pa rezultat. (më herët duhet të jetë folur patjetër po nuk mbaj mend, dhe këtë e mbaj mend sepse në 9vjetorin tim dëgjoja që shpërngulja në Tiranë po vinte sepse "Ato nuk kanë ndërmend ta bëjnë Rrugën e Arbrit") dhe mesa duket të drejtë paska pasur im atë që e thoshte gjithnjë. Në fakt, ku do kish me bukur sesa realizimi i një vepre të tillë me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Sa larg ish Kosova, sa afër është tani pas rrugës. Nuk thonë kot, që rrugët dhe infrastruktura janë hapi i pare në zhvillimin e një vendi. Dhe Rruga e Arbërit, do ishte hapi i parë në zhvillimin e Veriut të Shqipërisë!! Ja pse është e rëndësishme

Orana Sinani, TIRANA, ALBANIA: Jam krenar që jam nga Dibra. Jam krenar që jam nga një zonë me shumë tradita e njerëz të mirë. Do ta vlerësoja shumë, nëse kjo rrugë mbaron një ditë, sepse dua të jem më afër njerëzve të mi të dashur. Shpresoj të ndodhë shpejt!

Blendi Osmani, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua sepse jam më afër familjarëve.

Irma Kaja, VOLOS, GREECE: Dua që qyteti im të jetë më i bukur.

Dorjan Balliu, ATHENS, GREECE: Sepse kjo rrugë është e ardhmja e Shqiëprisë.

Genc Kamishi, BULQIZË, ALBANIA: Do të jetë një mrekulli për ne.

Anila Ruçi, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam dibrane, sepse e dua atë rrugë të bëhet.

Mehmet Gërguri, PRISHTINË, ALBANIA: Kjo zonë e Republikës së Shqipërisë duhet të zhvillohet dhe të lidhet me pjesën tjetër të shtetit e me të gjithë shqiptarët.

Ramadan Çipuri, TIRANA, ALBANIA: Peshkpia është vendlindja ime.

Përparim Spahiu, TIRANA, ALBANIA: Sepse dibranët meritojnë më shumë se kaq... Kjo është gjëja më e vogël që qeveritarët mund të bënin për dibranët... Mirënjohje për iniciuesin dhe mbështetësit e këtij peticioni.

Silvana Shini, BELGIQUE, BELGIUM: Rruga e Arbërit është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetet dhe jo vetëm për Dibrën, unë jam dibrane dhe votoj për Rrugën e Arbërit

Rovena Xhili, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo është e rëndësishme jo vetëm për mua por për të gjithë shqiptarët.

Kujtim Jusufi, GOSTIVAR, MACEDONIA: Afrimin e Gostivarit me Tiranën dhe shqiptarët e Maqedonisë me Shtetin Amë.

Armand Kadriu, TIRANA, ALBANIA: Sepse jetoj aty.

Alba Koka, TIRANA, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës do të ndihmojë zonën e Dibrës të emancipohet.

Hamit Sadiku, KERCOVE, MACEDONIA: Kjo rrugë është shumë e rëndësishme për të gjithë Maqedonasit, Shqiptarët dhe qytetarë të tjerë sepse shkurton rrugën mes Tiranës dhe Shkupit. Shpresoj, që kjo do të tërheqë vëmendjen edhe të qeverisë maqedonase, sepse duket se s'duan t'ia dinë shumë për këtë zonë të territorit të tyre.

Ilinor Murrja, TIRANA, ALBANIA: Sjell zhvillim ekonomik me qendrat përreth

Habedin Cibaku, PESHKOPI, ALBANIA: Është vonuar përfundimi i kësaj rruge, kjo rruge duhej të kishte përfunduar sepse është një rruge që sjell zhvillim për kombin tonë.

Afrim Goxha, GOSTIVAR, MACEDONIA: Prioritet i lartë kombëtar për Shqipërinë.

Arbër Cami, GERMANY: Origjina e familjes sime është nga Dibra dhe ndjehem sikur i përkas atij vendi. Të gjithë urojnë më të mirat për njerëzit e tyre dhe Dibra është e imja gjithashtu. Do t'ju mundësoje atyre njerëzve që jetojnë aty një jetë më të mirë dhe mundësi më të mira për të konkurruar në treg.

Sabaudin Zhuta, SKOPJE, MACEDONIA: Sabaudin ZHUTA - Shkup, Strugë: Dekadat e periudhës së komunizmit Dibra u trajtua si një zorrë qorre - e ndarë dhe e lënë anash botës shqiptare.

Edhe pse me një potencial shumë të pasur si me resurse njerëzore e intelektuale, (ishte pjesa me vitale e kombit të cilët me shekuj punuan për ruajtjen dhe avancimin e çështjes kombëtare), ashtu edhe me ato natyrale, ekologjike, ujëra termike e pasuri nëntokësore; ajo vetëm u eksplorua e gati asgjë nuk iu kthye. Shteti i IRJM-së i ka borxh gati për 70 vjetë anashkalim në financime. Ishin pra shkaqet ekonomike ato të cilat detyruan mijëra familje dibrane të emigrojnë në SHBA e vendet tjera perëndimore duke boshatisur Dibrën dhe vetëm për të siguruar kafshatën e gojës e një jete më dinjitoze. Kujtoj se është kohë e fundit për kyçjen e kësaj ane me pjesët tjera të vendit si me shtetin amë - Shqipërinë, ashtu edhe me pjesët tjera të rajonit (Strugën, Gostivarin, Tetovën, Shkupin, Kosovën etj.)

Një rrugë e ndërtuar buzë Radikës piktoreske që nga koha e perandorisë osmane, sot ka ngelur në mëshirën e kohës- pothuajse vështirë e kaluar. Kjo popullatë e vyeshme e ka merituar së paku një rrugë dinjitoze sa për të qenë në komunikim normal me botën e shekullit 21. Rruga e Arbërit mendoj se është një projekt shpresëdhënës dhe duhet sa më parë mundësuar për realizim.

Bujar Çollaku, SKOPJE, MACEDONIA: Për arsye se ajo rrugë hyn gati se në "arteriet kryesore" të Trojeve Shqiptare....dhe që të bëhet më shpejt thjeshtë Shqipëria Natyrale, siç ka qenë, apo më thjeshtë siç kanë thënë "Shqipëria e Madhe"

Dorjan Bodini, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbërit është një nga rrugët më të rëndësishme në vend dhe më e rëndësishmja për Shqiptarët që jetojnë në Maqedoni

Jetmire Maljiki-Ibraimi, ALSIP, IL: Jam Shqiptar dhe do të bëja ç'të jetë e mundur për të mbështetur vendin tim.

Alisetar Ramadani, SHKUP, MACEDONIA: Rruga e Arbërit është një arterie e rëndësishme kombëtare, do thoja më mirë, është aorta e gjithëkomunikimit ndërshqipar dhe prandaj me botën - Adelina Marku

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

SHËNIM I REDAKSISË: Komentet janë të pacensuruara. Redaksia ka ndërhyrë në komente vetëm për korrigjime drejtshkrimore. Gjithashtu, në këtë përmbledhje janë përfshira vetëm komentet e shënuara në faqen e peticionit në change.org.

Rruga e Arbërit nr. 86

Projekti do të jetë një risi për çështjen e menaxhimit të parqeve të Lurës dhe Korab-Koritnik, dhe një vlerë e shtuar si në aspektin e teknologjisë së re moderne

projekt

Përmirësimi i menaxhimit të parqeve natyrore në zonën ndërkufitare

Nga **BESNIK ALKU**



Në kuadër të programeve IPA cross border mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, këto ditë ka filluar nga zbatimi Projekti "Përmirësimi i menaxhimit të parqeve natyrore në zonën ndërkufitare", i cili përfshin parkun kombëtar të Lurës dhe parkun natyror të Korab-Koritnik në Shqipëri dhe parqet kombëtare të Mavrovës dhe Pelisterit në Maqedoni. Ky projekt financohet nga fondet e Komunitetit Europian dhe zbatohet nga ALCDF (Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale) në Shqipëri, në partneritet me Parkun e Mavrovës në Maqedoni.

Ky projekt do të zbatohet në zonën e Dibrës, në dy zonat e mbrojtura te Parku i Lurës, i cili është shpallur park kombëtar që më 1966, me një sipërfaqe prej 1200 ha (nën kategorinë II të zonave të mbrojtura) dhe parku natyror i Korab-Koritnik (nën kategorinë IV të zonave të mbrojtura), me një sipërfaqe prej 55,550 ha dhe që është shpallur zonë e mbrojtur në 2011 me vendim të Qeverisë Shqiptare. ALCDF, si Organizata zbatuese e këtij projekti në partneritet me Federatën Kombëtare të Pyjeve dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në Dibër, Qarkun e Dibrës, njësitë e Qeverisjes Vendore ku shtrihen këto parqe, si dhe Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve Komunale, do të bashkërendojnë veprimet e tyre për të përmirësuar menaxhimin e dy parqeve natyrore të Lurës dhe të Korabit.

Megjithëse problematika e menaxhimit të qëndrueshëm të parqeve është shumë komplekse, dhe situate aktuale është e rëndë, pasi kemi dëmtim të vazhdueshëm të natyrës, florës dhe faunës në këto parqe, kuadri ligjor dhe strukturat menaxhuese nuk janë efektive, ndërgjegjësimi i komunitetit dhe aktorëve të tjerë lokale nuk është në nivelin që kërkohet, bashkëpunimi mes Njësive të Qeverisjes lokale dhe qeverisë qendrore për këtë qëllim mungon dhe një sërë faktorësh të tjerë, projekti kërkon të kontribuoje në mënyrë modeste në përmirësimin e menaxhimit të parqeve natyrore në dy anët e kufirit.

Projekti synon të arrijë një prezantim sa më të lartë dhe bashkëkohor të mënyrës së menaxhimit të parqeve natyrore dhe një shtim në nivele më të larta të ndërgjegjësimit të gjithë aktorëve për mbrojtjen e parqeve kombëtare dhe natyrore në zonën ndërkufitare, si vlera dhe pasuri për sot dhe për të ardhmen.

Nëpërmjet krijimit të një sistemi të dhënash të sakta dhe të detajuara, moderne dhe bashkëkohore GIS për gjithë territorin e dy parqeve të Lurës dhe të Korabit do të bëhet e mundur që të identifikohen saktë situatë aktuale në këto parqe, do të përditësohen këto dhëna, do të monitorohet më mirë situatë në parqe, duke i rritur eficencën në mbrojtjen e natyrës. Ky sistem do t'u shërbejë jo vetëm stafit të parqeve, njësive të qeverisjes lokale, por dhe studiuesve, institucioneve të tjerave të cilët do të përshpejtojnë marrjen dhe adaptimin e informacionit me të dhëna të sakta për gjithë territorin, florën dhe faunën, pasuritë hidrogjeologjike, infrastrukturën etj.

> Komuniteti Europian mbështet Zhvillimin e Qëndrueshëm duke mbrojtur, promovuar dhe menaxhuar parqet natyrore dhe ekosistemin në zonën ndërkufitare në Rajonin e Dibrës!

Sistemi i të dhënave në GIS për të dy parqet, hartat dixhitale dhe një staf i kualifikuar i administratës së Parqeve dhe Njësive vendore të cilët mund të pasurojnë dhe përditësojnë të dhënat në GIS dhe me teknologji të pasur profesionale me GPS dhe me teknologji të tjera bashkëkohore do të përmirësojnë menaxhimin e parqeve duke siguruar mbrojtje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të mjedisit në këto parqe.

Gjithashtu projekti synon që nëpërmjet aktiviteteve të tij të promovoje dhe Turizmin në territorin e këtyre parqeve, nga i cili do të përfitojnë i gjithë komuniteti i zonës. Dy webpage, nga një për secilin park, materiale të tjera promovuese si broshura, fletë palosje, harta turistike dhe një sërë aktivitetesh bashkëpunuese me zonat fqinje të parkut të Mavrovës dhe Pelisterit në Maqedoni ku do të merret eksperiencë nga menaxhimi i vlerave natyrore në favor të zhvillimit të Turizmit, do të çojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe aktorëve lokalë por dhe më gjerë në nivel kombëtar dhe rajonal në një spektër sa më të gjerë të sektorit privat dhe atij publik.

Projekti do të jetë një risi për çështjen e menaxhimit të parqeve të Lurës dhe Korab-Koritnik, dhe një vlerë e shtuar si në aspektin e teknologjisë së re moderne të sistemit të të dhënave në GIS, pajisjeve GPS, serverëve dhe programeve moderne kompjuterike, njohurive të kualifikuara profesionale në nivelet më të larta duke krijuar një model dhe për parqet e tjera në Shqipëri, por dhe një eksperiencë e re e bashkëpunimit ndër-kufitare dhe bashkërendues me partneret e parqeve të tjera fqinje të Mavrovës dhe Pelisterit duke krijuar një mjedis sa më të mbrojtur dhe të qëndrueshëm në gjithë territorin ndërkufitar.

Projekti megjithëse do të zgjasë vetëm 18 muaj, besojmë se strukturat e dy parqeve dhe njësitë e qeverisjes vendore do të vazhdojnë këtë punë të nisur dhe do ta pasurojnë atë si me të dhëna të tjera, duke e parë këtë si një nisje e një procesi të vazhdueshëm të menaxhimit të parqeve duke mbrojtur dhe promovuar vlerat natyrore të këtyre dy parqeve.

> Projekti synon të arrijë një prezantim sa më të lartë dhe bashkëkohor të mënyrës së menaxhimit të parqeve natyrore dhe një shtim në nivele më të larta të ndërgjegjësimit të gjithë aktorëve për mbrojtjen e parqeve kombëtare dhe natyrore në zonën ndërkufitare, si vlera dhe pasuri për sot dhe për të ardhmen.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Rrugës për **Brezhdan**

- Në dashjen time që të mposht shurdhërinë që më imponon politika e "zërave të ngjirur".



Ujëmbledhësi në tokat e fisit Zhuzhe. Foto.©A.Ashiku

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ushurdhova. Më është çarë copë-copë daullja e veshit dhe nuk po e kuptoj se nga më vijnë e si më vijnë zërat. Fjalën e kam për zërat që më vijnë nga fushat e malet, nga politikanë të ulur "gju më gju" e "ballë për ballë" me "popullin". Bërtasin sa kanë në krye, në shkallën më të lartë të notave të pentagramit muzikor...

...Bujqësia... ujitja... kanalet...fermat... nafta... serrat... Bërtasin si të kishin zbuluar "Amerikën", si në bërtitjen historike pitagoriane EUREKA apo e lexuar në origjinal EVRIKA kuptimi i së cilës nga greqishtja e lashtë dhe e re është E GJETA.

Unë kam mbaruar për agronomi para 67 vjetësh, kam dhënë ndihmesën time modeste në piketimin dhe mbjelljen e plantacioneve frutorë në Dibër, një kurorë e bukur që nuk mund ti vihet përsëdyti Luginës Madhështore të Drinit të Zi. Kam qenë edhe pedagog në Shkollën e Mesme Bujqësore "Nazmi Rushiti" në Peshkopi dhe nxënësit e mi edhe nga Tropoja dhe Vermoshi i largët... më përcjellin mesazhe dashurie e respekti edhe nga përtej Atlantikut. Një mik imi këtu në mërgatën e zezë më thoshte një ditë se në se do të njohësh se sa e saktë është një enciklopedi lexo atë që di më mirë. E kam bërë timen këtë këshillë dhe mbi bazën e saj dua ta ngjis timpanin e çarë të veshit për tu thënë politikanëve: "Pushoni, tani e kam fjalën unë..." Po nisem për në katundin tim të lindjes, në Brezhdan-Zdojan shtëpitë e para të të cilit janë diku tek pesë kilometra larg Peshkopisë kurse të fundit diku tek dhjetë kilometra larg. Prej këtu ku jam ngujuar prej shtatëmbëdhjetë vjetësh po nisem "me mend" ndërsa fizikisht, për të fundit herë, jam nisur e kthyer më 1 shtator 2012.

...Nga Peshkopia dola, si me dalë nga një fushë me zamkë shtruar në një katrahurë urbanistike, duke kërcyer gropave që siç i kisha lënë i gjeta... Kthesa tek Vorret e Deliasanit, rruga drejt katundit tim, më befasoi, më ngrohu, më bëri të them me plot gojën "Bravo! Ju lumshin duart!". Rruga në katër metra gjerësi ishte tepsi e zezë, e rrafshët dhe e asfaltuar. Anash, në krah të djathtë uji i "Vijës së Malit" siç e kanë quajtur nëpër breza shekullorë, ishte e tëra në beton dhe uji gurgullonte me një muzikalitet që të hynte në shpirt. Fugoni ku kisha bërë vend në ndenjësen e parë rrëshqiste sa kafja në filxhan nuk bënte as dallgën më të vogël. Arat, në të dy anët e rrugës gjelbëronin nga misri kokërqumësht e nga jonxha. Majtas më kalonin në sy bahçe të mrekullueshme me mollë në distanca në vogla, si në një vresht, e me kokrra të kuqe e të verdha gati në pjekje. E ndjeva të bukurën thellë në shpirt dhe pyeta, duke kujtuar "Baltat e Rashnapojës":

"Pse thonë se nuk është bërë asgjë"? Rashnapoja, rruga dhe vija e betonuar ku uji kthehet sa majtas djathtas duke i dhënë vendit gjelbërim e begati ishte shembulli më i mirë se punohet... Me këto mendime i rashë mes përmes tokave të Rashnapojës, hodha sytë në kërkim të mullirit "të gjallë" siç thoshim sepse guri rrotullohej ditë e natë, e ndala vështrimin tek rruga që të çon në Ushtelencë e në lagjen Çemalle, tek rruga tjetër që përshkon tërë lugun për tu ndalë tek Shehlerët, Gazidetet, Karasanet, Bumçet e Xharret... Kudo, gjelbërim, kudo kopshte të vegjël disa dynymësh me mollë e pemë të tjera, me pjergulla e me groshë varur pas misrash mustaqemëdhenj... Kjo pamje do të më shoqëronte deri në arat e fundit të Rashnapojës... Pas tyre, sapo para meje u hap pamja e shtëpive të para të Sopotëve e Ashikëve, gjithçka ndryshoi, gjithçka digjej nën rrezet e nxehta të diellit, një shkretëtirë e tërë. Kanali i betontë ishte tërësisht i thatë, pikë uji nuk rridhte. Mollët në radhë në një kopsht të punuar me kujdes nga një i fisit të Sopotëve kishin varur gjethet gati në tharje e kokrrat ishin rrudhur e vyshkur. Për gjelbërim misri e jonxhe nuk bëhej fjalë... Rruga e asfaltuar mbaronte atje ku dikur kanë qenë zyrat e sektorit të kooperativës bujqësore.

> ...Bujqësia... ujitja... kanalet...fermat... nafta... serrat... Bërtasin si të kishin zbuluar "Amerikën", si në bërtitjen historike pitagoriane EUREKA apo e lexuar në origjinal EVRIKA kuptimi i së cilës nga greqishtja e lashtë dhe e re është E GJETA!

Edhe kanali i betontë aty ndalej... E përshkova rrugën me fugon mes përmes Zdojanit duke lënë majtas rrugën që të çon në Brezhdan e më tej në Ushtelencë, rrugë që gropa-gropa të çon tek trojet e kryetarit të Qarkut e njëkohësisht të kryetarit të PD-së të rrethit. Katundi im i lindjes, Brezhdan-Zdojani që mbaja mend ishte tjetërsuar, ishte tharë e copëtuar. Kërkova ndonjë ndërtim të ri, ndonjë vilë apo objekt socialkulturor i domosdoshëm për një katund që në vitin 1980 kishte mbi 3200 banorë. Fshati im i lindjes ishte konservuar në kaluarën e vet si në piramidat e Egjiptit. Nuk po shkruaj për pamjet rreth çezmave të ujit në pika në qendër të lagjeve, enët e bakrit, teneqesë, plastikës dhe gratë e vajzat në pritje të pikës së ujit për pirje. E kisha lënë katundin tim në pikën fundore të saldimit të tubave në pritje të rrjedhës së ujit nga Sopanika, në anën tjetër të Drinit, në gji të Çidhnës. Tubat e salduar, të lyer me zift e të futur në tokë i kishte shkulë kuçedra për të marrë "ekskluzivin" e furnizimit me ujë... ...E lash Ujin e Malit dhe gjelbërimin në skajin fundor të tokave të Rashnapojës, katund i cili një herë e një kohë (kur kishte besë burrash dhe shtet) nga uji i malit merrte vetëm disa ditë në muaj (nuk e mbaj mend sa) kohë për ujitjen e tokave.

Ditët tjera brazhda e saj bashkohej me brazhdën e Brezhdanit për të ujitur tokat deri në Gjarajcë e Çap. Askush nuk mund ta prekte ujin, nuk mund ta ndante atë për të ujitur kopshtin apo arat me misër. Lihej, me lejen e fshatit vetëm një curril i vogël uji sa gishti vetëm për të prerë plita e bërë baltë për ndërtimet e shtëpive. Më vonë , për ti ngopur bimët me ujë. fshatarët morën vetë ujin e Drinit dhe ujitën me të gjithë fushën. Misrin e fushës së Çapit nuk e çante kali e groshën nuk e nxinin thasët. Më vonë u ndërtuan dy ujëmbledhës, njeri në fund të Brezhdanit e tjetri në rrëzë të Gjarajcës. Më vonë me ndërtimin e sifonit të Muhurrit uji i Murrës erdhi në Brezhdan, Zdojan e Rreth Kale.

Më vonë uji i Setës, nëpërmjet sifonit dhe kanalit "17 kilometra të gjatë" ndërtuar me goditje të përqendruar në dhjetor 1967 rrodhi edhe në Fushë të Thatë, Vakuf e Zdojan... Uji i Malit në vitet '50-të vinte në lëvizje 7 mullinj bloje vetëm në rrjedhën Tomin-Brezhdan. Uji i Malit në vjeshtë të viti 1955 nëpërmjet një hidrocentrali u dha dritë dhe kulturë të treqind shtëpive të Brezhdan-Zdojanit të atëhershëm... Një njeri plot pasion për fotografinë një muaj më parë, nga lartësia e Gjarajcës, dikur e mbuluar me gjelbërimin e mollëve, kumbullave dhe arrave, kishte fiksuar disa pamje të Brezhdan-Zdojanit tim. Ndër to ishte edhe ujëmbledhësi i Gjarajcës që ujiste gjysmën e fushës së Çapit. Tokat që dhjetëra vite më parë i kishte mbuluar uji i ujëmbledhësit, toka të cilat unë i njihja me pëllëmbë sepse ishin prona të vëllezërve e kushërinjve të nënës sime, ishin shndërruar thjesht në bërraka... Ujëmbledhësi kishte dalë tërësisht nga funksioni ashtu siç kishte dalë ujëmbledhësi tjetër rreth një kilometër më larg... Tokat e katundit më të madh e të begatë, Brezhdan- Zdojanit, i pashë të zhuritura dje, i shoh nga larg (nëpërmjet asaj fotografie në internet) të zhuritura edhe sot... E dini atë meselenë e qypit me tëlyen, njeriut që e shiste atë toptan dhe njeriut që futi gishtin thellë? E dini edhe thirrjen shqetësuese të pronarit: "mos se del gjizë"? Berisha në ekstazë, me sa i ha zëri i ngjirur, bërtet e thërret... për ujë, ujësjellës, rrugë, kanale ujitës, ferma, fermerë... ndërtuar "kaç e fug".

Kërkon të na i shesë të tëra "toptan"... pa e kuptuar se pas shtresës së hollë të tëlyenit në qypin e tij ka dalë gjiza...

Miku im këtu në mërgatë më pat thënë se saktësinë e një enciklopedie mate me atë që di më mirë

Unë më mirë se sa njoh katundin tim të lindjes nuk njoh vend tjetër. E pashë me sytë e mi vjet, më 1 shtator 2012. Nuk besoj se këtë vit ujësjellësit do tu japin ujë banorëve në çezmat kolektive në qendër të lagjeve ditë e natë... Nuk besoj që rruga e asfaltuar të përshkojë tërë fshatin, apo të paktën deri tek shtëpia e kryetarit të qarkut e kryetarit të PD-së të rrethit...

Nuk besoj që ujëmbledhësit të jenë mbushur me ujë e kanalet ujitës, të ujisin tokat e katundit... Unë kështu e shoh sepse e njoh mirë atë shprehjen fluturake "Mos gërryej sepse del gjizë".

Mua në atë udhëtim më doli...gëlqere. Po ju, në atë që njihni më mirë çfarë u ka dalë?

Ju lutem, në se ndonjë gjë që nga shtatori 2012 ka ndryshuar për mbarë në Brezhdan-Zdojanin tim (nga ato që përmenda), më korrigjoni.

Njeriu, në këto kohë të zhurmshme, kur politika po i çan daullen e veshit dhe po ia mbush sytë me hi të nxehtë zjarri, edhe rrëshqet...

Athinë, 8 qershor 2013

Dibra *duhet të unifikohet* **me mençurinë dibrane**



Dibranët nuk mund të unifikohen as me politikanët as me biznesmenët, por me përvojën shekullore të urtësisë dhe mençurisë dibrane, për të cilën krenohemi shumë por që fatkeqësisht e vlerësojmë shumë pak. Mbase një "revolucion trëndafilash", mund të ndryshojë Dibrën dhe Shqipërinë.

Nga profesioni im kam nxjerrë një konkluzion që përputhet me një thënie të shquar
"Jeta është e thjeshtë, njerëzit e bëjnë atë të komplikuar".

- Para pak kohësh dolët para lexuesit me librin tuaj më të ri "Psikopatologji". Është ky një libër vetëm për studentët, mjekët, profesionistët, pedagogët apo për më gjerë?

- Libri si mund të perceptohet edhe nga emri: "Psikopatologji" dhe jo Psikopatologjia është diçka më tepër se një tekst mësimor i nivelit universitar-pasuniversitar. Është një libër i shkruar jo vetëm për profesionistët por edhe për lexues të tjerë të kualifikuar të fushës.

Jam përpjekur të sjell për herë të parë në literaturën profesionale shqiptare të kësaj fushe arritjet më të reja dhe spikatura të kësaj shkence veçanërisht arritjet e dhjetëvjeçarit të fundit. është një punë disa vjeçare e vazhdueshme dhe e testuar dhe përpunuar në afro 240 orë leksione prej afro 5 vitesh. Me modestinë dhe vetëvlerësimin më të më të natyrshëm mund të them se nuk guxoja ta quaja Psikopatologjia por Psikopatologji, edhe për një arsye tjetër, do të jetë niveli akademik ai që do ta testojë vlerën e tij. Jam përpjekur të përdor një gjuhë sa më të kuptueshme edhe për lexuesit e thjeshtë. Jetojmë në një kohë çudirash dhe paradoksesh, kur blihen diploma, bëhen plagjiatura, merren tituj të gjithëfarëllojshëm nga gjithfarëlloj njerëzish, apo botohen libra autobiografikë familjarë për "gjyshër të rrallë" historira luftrash etj. pa pikën e dinjitetit.

Në këtë treg të përçartur një botim shkencor shpresoj dhe besoj se do të vlerësohet ashtu siç e meriton, është koha ajo që i vlerëson gjërat pavarësisht nga dëshira jonë. Në punimet shkencore ka standarde që duhen respektuar për të qenë të tilla dhe referencat e sakta janë një element i tyre.

- Profesioni juaj sa i bukur, human por dhe mjaft i vështirë. Je penduar ndonjëherë pse zgjodhët këtë profesion?

- Është e vërtetë ashtu si çdo degë e mjekësisë është shumë humane, por mbase dhe më i vështiri. Sepse në fushën e shëndetit mendor ka shumë pak metoda specifike dhe aparatura diagnostikimi, që e bën më të vështirë si profesion. Të dish të komunikosh me njerëzit është pjesë e punës së mjekut në përgjithësi, ndërsa për profesionin e psikiatrit është një domosdoshmëri. Gjithnjë është e vështirë të futesh në botën e brendshme të dikujt, dhe kjo nuk mund të arrihet kurrë nëse ti nuk fiton besimin e tij. Për të krijuar këtë besim duhen përveç profesionalizmit patjetër edhe disa cilësi individuale të cilat njerëz të ndryshëm i kanë në masa të ndryshme. Mendoj se disa nga cilësitë më të nevojshme janë kultura e përgjithshme, aftësia për të toleruar, aftësitë argumentuese por dhe një stil komunikimi fin pa llogaritur dhe të qenit i hapur me të tjerët.

Më pyetët nëse jam penduar ndonjëherë pse zgjodha këtë profesion. Jo! Absolutisht jo. Ka qenë një zgjedhje që unë për shkak të rrethanave kam pritur gjatë ta realizoja, nëse nuk do të kisha pritur të vinte çasti oportun sot mund të kisha qenë në mënyrë të detyruar nga mjek infeksionist, edhe ky një profesion shumë i dobishëm dhe i nderuar por jo dëshira ime.

-Profesioni ka qenë një zgjedhje e juaja apo ua diktuan prindërit?

- Të them të drejtën duke shmangur termin "diktuan" mund të them se ka ndikuar shumë im atë, i cili, ndjesë pastë, kish dëshirë që unë të isha mjek. Dëshira ime, pas mbarimit të gjimnazit ka qenë të studioja për Letërsi.

E kam patur një dëshirë të zjarrtë nga e cila as sot nuk kam hequr dorë plotësisht. Kjo mbase ishte një prirje individuale po mbase u ndikua edhe nga librat e shumtë që kishim në shtëpi. Mund të them pa ndroje se kemi patur ndoshta një ndër bibliotekat familjare më të pasura në shtëpi. Im atë ka ndikuar shumë në përzgjedhjen në lexim sipas moshës.

Nuk mund të rri pa e kujtuar profesorin tim të letërsisë të ndjerin të nderuarin Qani Përtafi, ndikimi i të cilit në vitet e mëvonshme i dha më shumë hov dëshirës time. Gjatë atyre viteve kam botuar gjëra të thjeshta në gazetën lokale zëri i rinisë dhe një herë në një konkurs në një gazetë letrare. Kam ca poezi dhe tregime të shkurtra qe e kam parë të arsyeshme të mos i botoj, s dihet mbase ndonjë ditë më kap dhe mua dëliri i madhështisë ...

- Në formimin tuaj intelektual sa keni përfituar nga babai juaj, Hysen Lala, një emër ky shumë i njohur dhe i nderuar në qarqet intelektuale dibrane?

- Ju faleminderit. Babai im ka qenë një njeri i kompletuar për të gjithë ata që e kanë njohur.

Për mua ka qenë njeri shumë kërkues, shumë i rreptë por dhe shumë i drejtë, ndërsa unë shumë "i prapë" gjithnjë nëse mund të shprehem nëse do të kemi parasysh edhe kontekstin e moshës. Ai ish vetmi njeri që mua më dukej se në mënyrë magjike mund depërtonte në vetëdijen time. Shpresoj ti ngjaj sadopak në këmbënguljen, sistematizimin dhe çdo gjëje tjetër përveçse kryeneçësisë që ndonëse e cilësoj si virtyt, sepse ka brenda revoltën e ndershme është një virtyt që kushton shtrenjtë sidomos në ditët tona. Kryeneçësia e tim eti ish e atij tipi qe ai nuk pranonte të bënte kompromis me gjërat të cilat ai i konsideronte të shenjta si burrëria besa dhe morali. Kjo nuk do të thotë se këto parime nuk funksionojnë tek unë por kam parasysh një këshillë të vlefshme tim eti në vitet e fundit të jetës...

- Dita juaj mjaft e ngjeshur, në klinikë, në auditore ku jepni mësim, dhe besoj që dhe mjaft kohë ua merr patjetër edhe studimi. Po koha e lirë për ju si është?

Nga profesioni im kam nxjerrë një konkluzion që përputhet me një thënie të shquar "Jeta është e thjeshtë, njerëzit e bëjnë atë të komplikuar".

Kur merresh me punë nuk ke kohe të prishësh as humorin tënd dhe as të të tjerëve, natyrisht ndikon dhe tipi i personalitetit që ke. Unë përgjithësisht besoj se jam tip i hapur, besoj di të toleroj aq sa duhet dhe të pranoj njerëzit ashtu siç janë.

Natyrisht përmirësoj gjithnjë e më tepër radhën e prioriteteve të mija. Kjo vika me kalimin e viteve siç duket. Planifikimi i kohës është problematik për shumë njerëz, ndonëse personalisht besoj se nuk kam probleme të këtij lloji.

Në momentin kur mu propozua nga i ndjeri prof Ulvi Vehbiu të punoja me kohe të pjesshme si asistent i tij në një Universitet, hezitova pak me gjithë dëshirën time duke e konsideruar si privilegj dhe vlerësim, por njëkohësisht edhe përgjegjësi. Ajo ish një kohë kur fillova të besoj për herë të parë se planifikimi i kohës nuk ish dhe aq i thjeshtë. Në atë kohë drejtoja një klinikë me shtretër, vizitat ambulatore, planet e krijuese të cilat ai dhe kolegët e mi të stafit tonë te ngushtë mi kanë mbështetur vazhdimisht, mu "gufos" pake agjenda, por jemi ne ata që mund të planifikojmë më mirë gjërat... Kjo është një agjendë e mirë.

Koha e lirë: më pëlqen shumë të udhëtoj, si brenda dhe jashtë. Përgjithësisht më pëlqej në vende ku nuk kam qenë si dhe në dy tre vende ku shkoj gjithnjë me qejf dhe me mall veçanërisht në vendlindjen time në Qafëmurrë.

Më pëlqen të udhëtoj në dimër dhe në kohë të vështira bore, më pëlqen sfida dhe marr thuajse gjithnjë me vete djalin tim, Enin. Jam amator gjuetie dhe i skive, pasion ky që nga fëmijëria ime.

- Përmendët vendlindjen tuaj Qafë-Murrën, një nga mrekullitë e Dibrës, një perlë kjo për turizëm, por që në vitet e fundit ka filluar të braktiset dhe nga ato pak banorë që kanë mbetur. Sa jeni i lidhur ju me vendlindjen?

- Unë jam shumë i lidhur me vendlindjen. Këtë e them me bindje se jam shumë më i lidhur edhe se shumë të cilët kanë jetuar pjesën më të madhe të jetës atje. Shkoj çdo vit, madje edhe disa herë ndonëse nuk rri shumë gjatë. Para një jave isha dy ditë me një mikun tim gjerman Horst dhe shoqen time të fëmijërisë këngëtaren Elida S. Shehu. Unë jam larguar rreth 7 vjeç nga vendlindja, por pushimet i kam kaluar gjithnjë atje. Një nder kujtimet e mia më të bukura dhe më të dhimbshme është Kadishi, gjyshi im, me të cilin kam qenë shumë i lidhur edhe më shumë se me babain. Në përfytyrimin tim ka dy Qafëmurra, një të fëmijërisë dhe një të tanishme.....

Unë kam akoma shtëpinë që mban emrin tim të gdhendur mbi harkun e portës dhuratë nga im atë dhe plot kujtime të mrekullueshme që më mbushin dhe më trishtojnë njëkohësisht.


→

Dibranët unifikohen me përvojën shekullore të urtësisë dhe mençurisë

Kam qenë me fat se shtëpia vazhdon të jetë e banueshme falë përkujdesjeve të kushëririt tim.

Është e dhimbshme të mendosh që askush nga komuniteti i biznesmenëve të Katër Grykëve nuk kanë bërë as më të voglin përpjekje për të riparuar të paktën një pjese problematikë të rrugës së vendlindjes së tyre. Herën e fundit që isha para një jave vumë një tabelë orientuese me një urim mirëseardhje me shpenzimet tona tek ura e Lunarës, sepse shpesh herë të huajt që vijnë për turizëm humbasin rrugën. Kuriozët mund të shohin foton në adresën Katër Grykët në facebook. Unë kam qenë disa herë në Qafëmurrë me miq të ndryshëm të rinj e të vjetër nga Zvicra, Gjermania, Austria, dhe që të gjithë e vlerësojnë si një perlë turistike. Miku im Horst më është shprehur se rruga për në Qafëmurrë nga të dy drejtimet është më befasuese se sa rruga për më Maçu-Piçu në Peru. Imagjinoni sa vlerë merr kjo deklaratë nga një njeri që ka shëtitur shumë dhe është amator i turizmit malor.

Unë jam i bindur se së afërmi Qafëmurra dhe Katër Grykët do të kenë sërish gjallërinë që kanë patur dikur madje shumë më të mirë.



Unë jam shumë i lidhur me vendlindjen. Këtë e them me bindje se jam shumë më i lidhur edhe se shumë të cilët kanë jetuar pjesën më të madhe të jetës atje. Shkoj çdo vit, madje edhe disa herë ndonëse nuk rri shumë gjatë. Para një jave isha dy ditë me një mikun tim gjerman Horst dhe shoqen time të fëmijërisë këngëtaren Elida S. Shehu.

-Dibranët njëzet e ca vite demokraci kanë pritur vetëm nga politika se çfarë do të bëje ajo për to. Po dibranët çfarë duhet të bëjmë për Dibrën?

Personalisht nuk më ka pëlqyer kurrë të përfshihem dhe as të merrem me politikë. Shumë pak lexoj nga shtypi i përditshëm dhe në darkë ndjek vetëm lajmet shkurt. Im atë ka qenë anëtar i PPSH-së. Vitet e fundit e dërguan për "riedukim" në minierën e Balgjajt... i bënë edhe një gjyq farsë, i cili e akuzoi për "humbje të vigjilencës revolucionare". Mbeti kandidat partie...i PPSH-së së asaj kohe, refuzoi teserën e PS por nuk mori as atë të PD-së. Kur filluan proceset demokratike dhe deri pak kohë para se të vdiste në muajin Korrik 1992, bënim biseda të ndryshme mbi politikën dhe njerëzit që ishin përfshirë në politikë. Nuk i kam harruar kurrë ato që më ka thënë: "Koha është e juaja, merru me cilën parti të duash por ..me shokë të mirë përkrah..."

Natyrisht që më të rrallë e kundërshtoja për ndonjë gjë deri ditën kur më tha: "Biri im, ti je akoma i ri, por një gjë mos harro kurrë se duhet ti referohemi gjithnjë historisë së përvojave të të tjerëve. Kujto revolucionet franceze, herët a vonë idealistët përfundojnë në gijotinë, vjen një periudhë qeverisje nga maskarenjtë, çdo kombi i duhet ca kohë që të stabilizojë punët e veta si duhet".

Vitet e fundit im atë i kaloi në vendlindje, i zvetënuar nga shumë gjëra dhe nuk është sekret të them se im atë votoi për PR-në. Mu duk pak e habitshme por ma argumentoi: pronat, persona me integritet ...dhe uronte të forcohej gjithnjë si një forcë e pavarur. Nuk nguli këmbë kurrë që edhe unë të votoja sipas mendimit të tij. I thashë këto për tim atë në përgjigje të pyetjes tuaj për politikën. Kjo është optika ime për politikën: Mendimi im personal është se me politikë merren vetëm tre kategori njerëzish: njerëzit të cilët politikën e kanë profesion, njerëz të cilët hyjnë me idenë se do japin kontribute dhe njerëzit që e konsiderojnë politikën biznes dhe të gjithë e dimë se çfarë parimesh morale kanë.

Këto vite të dhimbshme tranzicioni të zgjatur kanë treguar më se miri se sa fatkeq është populli ynë, që udhëhiqet nga kjo klasë politike e dyshimtë politike. Burrat e mençur të dikurshëm nuk ekzistojnë më por mbetet fjala e tyre e mençur.

Ata që mund të japin kontribute ose janë sehirxhij dhe shohin punën e tyre ose janë të pafuqishëm për të ndikuar ose i ka kapluar përgjumja e kamjes së beftë. E keqja më e madhe për mendimin tim është se na mungon aftësia për të dëgjuar të urtët dhe për tu organizuar si shoqëri.

Dibranët nuk mund të unifikohen as me politikanët as me biznesmenët, por me përvojën shekullore të urtësisë dhe mençurisë dibrane, për të cilën krenohemi shumë por që fatkeqësisht e vlerësojmë shumë pak. Mbase një "revolucion trëndafilash", mund të ndryshojë Dibrën dhe Shqipërinë.

Bisedoi: ***Shaqir Skarra***

Prezantohet *libri* **"100 figura dibranësh – 2"**

Më 28 qershor 2013, në sallën e Akademisë së Shkencave u promovua libri i dytë me figura të shquara dibrane i Prof. Dr. Arian Kadiu "Edhe 100 figura dibranësh". Në këtë aktivitet, të organizuar nga "Miqtë e autorit", dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe artistëve" në bashkëpunim me shoqatën "Bashkësia Dibrane", "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe shoqata "Çamëria", mori pjesë edhe Presidenti i Shqipërisë, z. Bujar Nishani, si dhe mjaft personalitete si kryetari i Gjykatës Kushtetuese z. Bashkim Dedja, artisti Bujar Kapexhiu, kompozitori Agim Krajka, muzikologu Ramazan Bogdani, shkrimtarët Lutfi Hanku e Namik Selmani, gazetarë, poetë e miq të autorit.

Prezantimin e librit e moderoi z. Saimir Shatku, sekretari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", i cili bëri një panoramë të shkurtër të veprimtarive me rastin e 100-vjetorit të eksodit të dibranëve. Më pas foli zonja Flutura Hasko dhe zoti Njazi Kosovrasti, i cili u ndal në vlerat e librit, në figurat historike e letrare që janë përfshirë në këtë libër. Namik Selmani në diskutimin e tij "Monumenti i fjalës kombëtare" mes të tjerash tha: "Është një libër serioz, libri i librave për Dibrën dhe kombin". Mes emocionesh foli dhe prof. Ismet Bellova dhe pas tij z. Bujar Kapexhiu.



Duke i shprehur mirënjohjen autorit përpunën e madhe shkencore, Presidenti Nishani theksoi se kjo vepër i bën jehonë kontributit mbarëkombëtar të trevës dibrane.

Më tej, duke vlerësuar lart patriotizmin, atdhedashurinë, kontributin e madh të brezave të tërë të kësaj treve, Kreu i Shtetit vuri në dukje se dibranët me mençurinë e tyre kanë arritur të mëkojnë tek të gjithë shqiptarët një ndjenjë të madhe respekti.

Presidenti i Republikës vlerësoi punën e shoqatës "Bashkësia dibrane" në promovimin e veprave të tilla duke e konsideruar këtë mbështetje një akt të përgjegjshmërisë qytetare dhe një shembull që duhet marrë edhe nga shoqatat e tjera.

Pasi shprehu angazhimin e tij në vlerësimin e personaliteteve të shquara nga çdo trevë e vendit, Presidenti Nishani inkurajoi shoqatat e ndryshme që të bashkëpunojnë më fort me institucionet e shtetit për evidentimin e vlerave dhe kontributeve të shquara ende të pavlerësuara.

Pas largimit të Presidentit Nishani, takimi vazhdoi përsëri me diskutime. Në fund për të pranishmit pati dhe një koktej.

Ilmi Dervishi

Rruga e Arbërit nr. 86

Duke kujtuar rrugët e vjetra që të çonin drejt Tiranës me kuaj dhe në kam, ndërsa sot në ketë fillim shekulli, rëndësia ekonomike, kulturale, shoqërore, tregtare, turistike, strategjike që paraqet vazhdimi i punimeve të Rrugës së Arbrit në cilësi e shpejtësi.

reportazh

Buzëqeshje pranverore

Nga **SELMAN MEZIU**

Nuk e përfytyroja se një fatkeqësi do të më detyronte, të mos flija, të derdhja lot dhimbje, të shkruaja lajme vdekje. E kisha dëgjuar së ajo është mbretëresha e të papriturave dhe e mundimeve të shfrenuara. Dhe e kundërta që nga aeroporti i Pizës e deri në Dibrën në mes malesh kreshpëbardha do të ndjeja aromën e luleve, buzëqeshjen e pranverës. Por ja që njeriut në jetë i ndodhkan gjithfarë ngjarjesh, e iu shfaqkan ëndrra të trishtuese e realitete bukurindjellëse por edhe rrëqethëse. Dhe ja si ndodhi:

URA E GJUNJËZUAR DHE KALATË ILIRE

Nata kaloi nën peshën e kujtimeve për *NANËN,* të njeriut që më donte dhe e doja pa kufi. Të asaj që më përkundi në djepin e drunjtë e ushqeu me qumështin e saj, më mëkoi me lugën prej druri dhe me edukatën e mirë.

Ora katër e mëngjesit më solli mbrapshtinë e parë. Avioni do të nisesh dy orë me vonesë. Ishte në rrezik, ndoshta e pamundur të merrja pjesë në ceremoninë e varrimit. Dëshiroja më gjithë forcën e shpirtit tim, ta shikoja për herë të fundit apo dhe të mundesha ti puthja ballin! Puthja e lamtumirës, hedhja e një grushti dhe mbi varrin e sajë, do te ishin për mua ringjallja. Por….



Ura mbi lumin e Matit

Aeroplani me fletët gjigante prej alumini çau hapësirat duke "notuar" mbi re. Nuk vonoi shumë dhe filloi të "vallëzoi" mbi qytetin e Durrësit të tejzmadhuar me pas në malësitw e Tiranës. Në Qafë Krrabë devijoi drejt veriperëndimit deri sa filloi uljen duke iu afruar Kalasë së Prezës. Ndërsa në pistën e aeroportit "Nënë Tereza" eci me rrotat e tij të vockla, duke çarë ajrin e mëmëdheut tim të braktisur prej dhjetëvjeçarësh. Shkela në asfalt si mbi dheun e arës time të sapo lëruar apo të kopshtit të lulëzuar, e prodhim shumtë. Ah ky malli qe hanë gurin dhe jo…..

MakinaeMerushitsapokaloimbikalimin e Fushë Krujës, e unë përpiqesha të përfshija me vështrimin tim gjithçka, ndërtesa banimi, magazine, dyqane, edhe makina të shumta që lëviznin si mizat përdhese në një rrugë automobilistike here një e herë dy kalimshe. Vështroi shpatet e Krastës së Krujës,të copëtuar nga kantieret e prodhimit të gurit apo të fabrikave të çimentos, që vjellin vazhdimisht tymra e re pluhurash. Një ish panoramë krejtësisht e gjelbërt e thellë gjithëkund e njëtrajtshme pishnajash. Tani më duket si një kafshë gjigante prehistorike e plagosur nga shoqëria e politika ambientale e sotme, në udhëtimet e saja përgjatë ditëve, muajve, viteve e dhjetëvjeçareve. Ajo loton, shungullon nga dhimbjet therëse, por askush nuk përkujdeset, veç lëngon duke ndjerë shkymjen e ujqërve të uritur të kohës sonë. Kambanat e shkatërrimeve do të vulosin mjerimin vdekjeprurës mbi gjithë gjallesat përqark, në shekujt që do të vijnë.

Sa kaq më shfaqet ura me harqe, më duket si një shpend gjigant fluturues. Kërkoi të gjejë, kur filloi, kush e projektoi, a ka shkruar ndokush historinë e saj? Por kush e dine? Cili ia shfaq popullit, të banuar rrethe qark apo kalimtar? Dhe ja ca grimca të dhënash. U projektua nga inxhinier Italian. Gurët e gdhendur erdhën nga Lisi i Matit. Punimet mbaruan në vitin 1928. Thirresh me dy emra: Ura e Matit ose Ura e Zogut. Tani ajo pushon, e gjunjëzuar e përgjumur. Shikojmë në hyrje një bllok çimentoje që pengon hyrjen e gjithçkaje. Jo sepse janë ndërtuar brenda tridhjetë vjetëve edhe dy ura të tjera. Por fatmirësisht ajo ka dalë në pension, s'mundet ma të mbajë mbi "supe" pesha të rënda dhe aq sa të lehta.

Udhëtoi mbi ish trasenë e një hekurudhe, që pati ndoshta jetën më të shkurtër në historinë botërore të hekurudhave në



Pamje nga Klosi

pikëpamjen e funksionimit, të ndërtimit, të shkatërrimit, ishte ajo Milot - Rrëshen –Klos. Ndërkaq, një vinç, e disa punëtor që hedhin blloqe betoni, për të penguar ujërat e shumta të lumit te Matit, që të mos shkatërrojnë skrapatën e "autostradës". Dhe ja na shfaqet një ndërtesë me arkitekture vendase, krejtësisht prej guri të latuar, e cila ka vite që hedh shtat avash-avash. Nuk shikojmë asnjë mjeshtër apo punëtor. Nuk e dimë përse kjo gjendje?

Ashtu kokë varur ndjek lakesat e udhës, pas një tuneli të shkurtër shfaqet fshati Shkopet. Me disa pallate, shtëpi përdhese dhe lumi i Matit me ujin e kthjellët dhe që udhëton furishëm në mes gurëve të bardhë dhe rrapeve kurore gjerë të sapo veshur me gjethe në formim e sipër. Qetësi! Heshtjen e prishin, herë– herë cicërima zogjsh, e ndonjë zë që vinte nga njerëzit në klubin mbi udhën e asfaltuar.

Por të kërkosh në zgafellat e kohërave, ky peizazh i gurtë malor, ka dy kala të kohës Ilire, dhe janë gjetur disa varre përreth tyre. Dhe me tej, ne vitin gjashtëqind quhesh *Sceupton* (Skepi tonë ndoshta S.M) ndërsa në vitin njëmijë e katërqind *Skopedhi* me kishën e Shën Mëhillit e ngritur në një kodër. Një shtrirje historike për tu admiruar, shkruajtur, fotografuar pse jo dhe filmuar. Përballemi me një masiv gjigantë shkëmbor gëlqeror, ku e përshkojmë mespërmes. Papritur, mahnitës e bukuri rrallë, shfaqet pasqyra e liqenit. Sapo e kaluam digën ku nëpërmjet dy portash shkumëzonte uji, i bardhë si bora. Diga beton e hekur asht pothuajse dyzetë e tetë metra e lartë ku mban, frenon e hedh sa për të lëvizur turbinat, jo më pak se katërmbëdhjetë mijë metrokub uji. Në mes dy shpatesh të pjerrësueme, pyje shumta, me gjelbërimin e dushkut që sa ka filluar t'i ndryshojë pamjen nga e kafejtë në të blertën. Ndërsa vazhdojmë udhën e pishat e egra tanimë me të gjelbërtën e errët, që kanë fituar qytetarin prej më se tre dhjetëvjeçarësh, me dushkun, frashrin bushin shumë formësh dhe lofatën e cila zbukuron peisazhin me lulet ngjyrë roza. Të gjitha jetojnë sëbashku. Këto u janë mbërthyer këtyre shpateve të pjerrëta me pak shtresë dheu dhe mbijetojnë shëndetshëm.

Fshatrat Madheshi e Lundra me pak shtëpi, janë të lidhura me një urë teli mbi sipërfaqen e liqenit, që të ngjall tmerr kur e shikon, pse jo edhe të nxit kureshtjen. Fëmijët që vazhdojnë shkollën si e kalojnë vallë? Po dyqanet ku i kanë për të blerë sadopak ushqime e gjëra të tjera të domosdoshme? Si e bëjnë jetën këto njerëz, me shtëpia të vendosura aty këtu nëpër faqet e shpatit e në mes pyjeve me pak toke buke? Padyshim kjo kërkon një studim e shkrim në vete. Do të ishte shume kureshtëndjelles. Apo jo!

Në liqe një qetësi absolute, as vark me vela dhe jo ma me motor, që as mendohet. Heshtjen e prishin gurgullima të ujrave të shumta të përrenjve të Gurit të Mollës, të Gjapit dhe të Liqenit. Në një restorant pranë një përroi me ujë të bollshëm, arti i mozaikëve, me lule të ndryshme, me shpendë si pëllumbi i bardhë, shqiponja e zezë dykrerëshe, në fluturim, e skalitur me mjeshtëri shtangin nga habia. Mjeshtëria e derdhur dhe domethënia e tyre e thellë e zhbiruese na venë në mendime. Janë këto malësor që dinë te krijojnë me plote fantazi e zgjuarsi, këngë, të gdhendin gurin e drurin, të prodhojnë bulmetra e të mbajnë gjallënueshëm këto mjedise piktoreske, në mes malesh kreshtë shumtë e kaltërsisë se ujërave rrëzë tyre, që prodhojnë edhe dritë elektrike. E shkruar në gazetat e kohës, e gjiruar në filma e fiksuar në celuloid, e ruajtur e trashëguar brez pas brezi në mendjen e vendasve, kronikat e punës të qindra punëtorëve që përdornin qysqitë, tokmaqet, kazmat, lopatat e karroca prej druri. Filloi në vitin 1952 ndërtimi i kësaj rruge, që pas përurimit të hidrocentralit me emrin F.Engëls, më dhjetë Korrik 1963, pra plotë gjysmë shekulli më parë, mori emrin Rruga e Dritës.

Por, kushdo që udhëton takon krahas kësaj bukuri mahnitëse, tërheqëse, të shpateve që zbresin sertshëm, drejt pasqyrës së kaltër, edhe shumë lapidar të vegjël ose pllaka përkujtimore. Në të cilët lexon mjaft emra, të moshave të ndryshme, të cilat zbukurohen me lulet artificiale shumë ngjyrëshe. Janë ato që kanë humbur drejtimin e udhës dhe kane përfunduar në liqe. Shkurt quhen *AKSIDENTE*. Duke sjellë ujëvara me lot nënash, prindërish të fejuarish, fëmijësh…. Pas viteve '90 statistikat e humbjes së jetës në mënyrë të tillë, janë me mijëra. E prandaj vjen natyrshëm kështillimi: **"Kujdes njerëz të mirë, kujdes, vëmendshmëri e siguri të vazhdueshme në drejtimin e makinave të çfarëdo marke e tonazhi, sytë bani katërsh sepse jeta ashtë e vetme, një dhe vetëm një dhe e papërsëritshme."**

NGA SANXHAKU I PËRMBYTUR, TEK KLOSI I BOMBARDUAR

Nuk ngopesh së vështruari këto peizazhe të copëtuara, luginash të mbuluara disi me bimësi e kurrize heje-heje të zhveshura që "rrokullisen tërbueshëm" mbi kaltërsinë e liqenit që vazhdon si gjuhëz e hollë deri….. Me kalimi e disa kthesave, shihen disa pallate në një kodër, në mes gjelbërimit ku të shpie rruga e makinës.

Kjo është Ulëza. Këtu janë *ulur (ulë-S.M)*, me shtëpia e familje, banorët e Sanxhakut të përmbytura më 1957 nga ujërat e liqenit më të njëjtin emër. Edhe për këtë vendbanim të lashtë Ilir, siç asht dokumentuar nga zbulimi i Tumave të kësaj periudhe, flasin e shkruajnë me hollësi gazetat e revistat e atyre kohëve, por edhe cilat ishin fiset e fshatit, sa banore ishin, gjendja materiale e pasuritë etnografike, kulturore shpirtërore etj.

Zbresim një qafë ku befasueshëm, hapet para nesh një hapësirë e stërmadhe me ngjyrën blu të thellë. E pra ky asht liqeni i Ulzës, me sipërfaqe 350 hektar, dhe më tej kurioziteti më mahnitës: 13,5 milion metro kub ujë, ndodhen tani në nivelin kulmor. E gjithë kjo masë, mbahet për bukuri që prej pesëdhjetë e gjashtë vjetësh, nga një digë e fuqishme me lartësi gjashtëdhjetë metra. Udhëtimi bahet ma i këndshëm kur na shoqërojnë masivet e dushkajave që sapo kanë murgulluar, ndërsa sipërfaqja e liqenit asht ma e qetë se kurrë, vetëm rrezet e dielli te prekin duke i dhuruar një pamje kënaqësi ndjellëse, me plotë reflekse mahnitëse drite.

Hedh vështrimin në krahun verior dhe lodroi mbi një vargmal me pamje të butë, si e latuar nga një dorë mjeshtërore. Fillon me Kodrën e Bokës, 351 metra lartësi nga deti, vazhdon me Çukën e Lepurit duke ndjekur kurrizin deri në majën e Gurit te Keq, me 471 metra lartësi e më pas maja e Lurthit e cila duke ndjekur nje kurriz bie te Qafa e Frolletës. Ndoshta *Foljetës,* pra lojfata që ka pushtuar natyrën e këtyre anëve duke i dhanë edhe emrin. Shpate me përthyerje të ëmbla zbresin "miqësisht" mbi buzët e ujërave kaltëroshe të liqenit, të shoqëruara nga pyjet e dushkajave të dendura, me valëzime sipas terrenit dhe të shëndetshme.

Duke "humbur" në këto pamje të brishta tërheqëse, mëndja të shkon, tek fshatrat turistike, tek shtëpitë e pushimit, hotelet etj. Një rruge automobilistike që mund të lidh qytezën e Ulzës me fshatin Prosek e më pas me rrugën e vjetër Rrëshen – Burrel. Vetëm kështu i krijohet unaza që e lidh me Veriun dhe Shqipërinë e mesme. Kush vallë mund ta marrin iniciativën të parët: politikanët, institutet private e shtetërore të projektimit, deputetet qe ngrohin kolltukët në parlament apo??? Kur do të arrijmë ti shëmbëllejmë sadopak Zvicrës? Natyrën e kemi, por mungon……

Nuk mungojnë zërat poetik të *Simon Kacës* dhe të *Etleva Çokut,* që nga kjo qytëzë me vështrimin mbi natyrën magjepse për rreth, buçët ngrohtësisht vargu plotë nektar frymëzimi dhe nerv emocionues:

Shko, poezia ime,
Tek liqeni i Ulzës,
Dhe merr një gurë zalli, etj (S.Kaca)

Ndërkaq përballohemi me një pllajë me vështrim nga pasqyra e liqenit, me shtëpia te reja, disa në ndërtim e të vjetra si kutia shkrepse por që bardhësojnë, të shoqërueme nga gjelbërimi i pemëve e livadheve luleshumtë. Jemi në Bushkash. Ose më mirë, vendi i shkurres përherë blertë të Bushit. E cila në lulishtet e vilave të konteve, dukëve të vendeve mesdhetare, përdoresh në gardhet zbukuruese apo si bimë që me anë të krasitjes merrte forma të ndryshme me pamje të mrekullueshme. Pika turistike e Qafë Shtamës ka diçka që ka mbetur nga vitet tridhjetë të shekullit të kaluar. Ndërsa më pas asht lanë që të jetoi i lire në natyrë. Por çfarë të mendosh për mbretin e lulishteve të stilit klasik të shekullit të nëntëmbëdhjetë: se jemi të varfër, se pesëdhjetë vjet të shkuara jetuan në barazi dhe…, apo se nuk kemi kapacitete financiare, intelektuale e profesionale për ta përdorur! Ashtë e vështirë të gërvishtësh në koren e kohës e që andej të zbulosh te vërtetën. Ndoshta dikush do të ulet të mendojë, shkruaj, projektoi e zbatoi në zbukurimin e mjediseve private, komunale e shtetërore! Emri i këtij fshati ka në thelb këtë emër shkurreje përherëgjelbërt. Apo…….!

Ngjitemi drejt fshatit Baz, i ngritur mbi një kodër por dhe i shtrirë më shumë në pjesën jugore e perëndimore. Ndërsa sodit me kureshtje vargmalin nga maja e Xibrit me lartësi 1531 metra duke vazhduar me majën e Hotit, ndoshta këtu kanë banuar njerëz të ardhur nga malësitë e Hotit të Shkodrës më pas vargmali ngjitet duke arritur në majën e Liqenit, dikur ka qenë prania e tyre në forma rrethore sot gropa të mbuluara me bar. Dhe vazhdon me majën e Bretit e më pas përfundon me Tumenishtin, ose tanima jemi mësuar, ta quajmë Mali i Skënderbeut. Edhe këtu peizazhet kanë copëzime vertikale e horizontale duke i dhënë relievit pamje tërheqëse. Nga burimet e shumta të këtyre masiveve formohen edhe përrenjtë e Qafë Shtamës, Gërmenit, atijë të Zallit etj, të cilët ne i takojmë gjatë udhëtimit për në qytetin e Burrelit e më tej.

Në qendër të qytetit na "përshëndet" ish mbreti i Shqipërisë, Zogu i Parë. Shtatoria e tij nuk ka më se një vit e përuruar. Ky birë i fisit të zogajve nga Burgajeti, ndoshta emri vjen nga *borgo* në Italisht ose *çiflik* në turqisht, i cili me dorën e hekurt dhe me politikën e dyerve të hapura kundrejt, qeverisë e mbretërisë italiane e futi Shqipërinë në shinat e zhvillimit ekonomik e kulturor.

Ndoshta ky qytet ka nevojë edhe për shtatore të mendimtarëve të penës, që janë me bollëk në krahinën e Matit. Mund të marrim si shembull dy dyshepuj të kohërave shumë të largëta njëra nga tjetra: *Pjetër Budin* dhe *Aref Matin*, i fundit, zbuloi me punën e palodhshme studiuese e kërkuese, rrënjët e vërteta të prejardhjes shqiptare nga *PELLAZGËT*.

Deri këtu edhe sa zbritëm te ura që lidh dy brigjet e lumit të Matit, rruga ishte e asfaltuar për mrekulli. Dhe unë po e realizoja dëshirën. Por…. Ndërsa udha automobilistike, Kurdari - Suç – Klos, ishte kthyer në gropa e kurrize të kalueshme lehtësisht nga traktorët me zinxhir. E prandaj u desh sëpaku dy orë, që ta përshkonim. Zemërimi i kaloi kufijtë e arsyes. Por kujt t'i ankohesha, Merushit që e bënte rrugën me kthesa për të mos ngecur diferenciali në kurrizet artificiale, apo qeveritarëve, pushtetit lokal etj. Vetëm shtrëngova nofullat nga dhimbje e zemërimi njëkohësisht të cilat më kishin pushtuar marrëzisht gjithë qenien time. Unë isha i pafuqishëm, isha një zvarranik që lodhet duke ecur në këtë mënyrë gjithë jetën. Fatkeqësisht!

Nuk u besoja syve, kaluam urën normale, sigurisht edhe kjo me gropa, vështrimi më kapi një urë prej guri me harqe, kushedi sa e moçme duhet të jetë por i lumtë: u ka rezistuar qindravjeçarëve, ndërsa bulevardi i *"QYTETIT"* të *Klosit*, ishte kthyer në një kanal gjigant. Mendova se mos e kanë bombarduar me predha te kalibrit të lartë. Ndoshta nga ajri, ndoshta nga ish kalaja e Skënderbeut tek Guri i Bardhe, ndoshta…… Një tmerr me sy hapur. Jo më pak se njëzetë minuta për të kaluar këtë copë "udhë" na u desh.

Pamë banorët qe shikonin makinat, ndonjë lopë apo kope dhensh që kalonte mes për mes, dikush pinte duhan, apo ishte ulur mbi një gur dhe mendohesh me dy gishtat në tëmtha. Njerëz ca të leckosur e ndonjëri me një trastë bezeje ku dukej cepi i një buke dhe fletët e gjelbërta të prasve. Ku jam vallë, mendova? Personazhet migjeniane me dilnin përpara si në ndonjë film hollivudian.

Ku asht Klosi i dingave të barotit ku sëbashku me qendrat e tjera, mbante peshën kryesore në prodhimin e barotit në Shqipëri. I ngritur mbi gërmadhat e vendbanimit Ilir: *STRAGJ*, zbulimet nga arkeologët e tre nekropole dhe pesë tumave ilire janë me vlera të pallogaritshme kulturore për historinë e lashtë të këtij vendbanimi njëkohësisht tregues i një lulëzimi të madh. Ishte shpërfytyruar plotësisht në fillimin e shekullit të njëzetë e njëjtë. Kurse e kaluara shprehte dëshminë reale, konkrete të një zhvillimi të gjithanshëm. Ishte qendër e zhvillueme e Krye-Matit me tregun e vetë "Pazari i Urës." Ku asht vallë punishtja e rakisë dhe e verës me firmën "Mati"? Është zhdukur. Pa çka se në dalje te tij shikohen një mori shtyllash tre ose katër metra, të mbuluar me dushqe ferra, edhe këto dëshmi e një projekti të dështuar: Stacionit hekurudhor Klos.

Nga që nuk mundesha të kujtoja atë që sapo kalova, mendja fluturoi tek vargmali i Dejës, bardhësuar nga bora, një pamje jo e zakonshme, me një hijeshi që të qetësonte, të tërhiqte si një fushë manjetike duke të ngjallur emocione. Zbrita përgjatë relieveve të përthyera në Dukagjin. Përshëndet këtë dhuratë madhështore të natyrës, lisin monument natyre, qindra vjeçar, kurorë gjigante e lartësi njëzetë e pesë metra të lartë e tani dëshiroja të mendoja, flisja, shkruaja me gjuhën e historisë. Pikërisht këtu ngrihesh madhështore *Kisha e Shën-Kollit* ku brenda saj në Shkurtin e vitit 1602 u mblodhën njëmijë e gjashtëqind e dy delegatë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë se Mesme e të Veriut për të vendosur mbi çështjen shqiptare. Një e kaluar e skalitur në emra vendesh- toponimesh dhe që pllenon mendjet e breznive njëra pas tjetrës.

Dibrën e përfaqësonin *Josif Kastrioti, Lazer Koshi* (prifti i Bulaçit), *Martin Maneshi dhe Jovan Çidhna,* kështu shkruajnë dokumentet e kohës, burrat e dheut kuvendonin krye më krye për të pleqnue si me u organizue kundër pushtuesit turk duke kërkuar bashkëpunimin e Europës perëndimore.

→

Më shumë se tre dynym pisha të zeza ishin zhdukur dhe me qindra drurë ishin “përgjakun” nga gurët e shumtë ose pesha e dheut, të thara e gjysëm të tilla. Një masakrim natyre i papërfytyrueshëm. Shpërdorim parash si në mallin e pazot. Punë pa tregues e udhëzues inxhinierik e studim mjedisor.

Fortesa e Arbës ngrihesh me mure të forta e bedena të shumta mbi Dukagjinin, ku së fundi ashtë gjetur poshtë saj edhe një varr me disa relike të çmuara, dëshmi e zhvillimit ekonomik e kulturor të kësaj qendre të madhe ekonomiko kulturore të gropës së Matit në ato kohëra.

Ndërkaq ngjitemi kthesave të forta të Klosit mjeran të sotëm ku përball më shfaqet një masiv i madh pishash, me reliev të përthyer. Zaten e gjelbërta e thellë dhe kurorat e tyre me nivele të ndryshme skalitin një arkitekturë joshëse. Mbjellur rreth dyzetë vjet më parë nga ndërmarrja e Pyjeve Burrel me drejtor *inxhinierin Akile Pite*.

Nga klubi i ngritur mbi një kodër, vështroi luginën e Matit me kodërza, kurrize e pllaja e me një mori fshatrash të ndara njëri nga tjetri me kufij natyror. Natyrshëm me vijnë ndërmend fëmijët gjatë muajit gusht që kam zbathur e dorë të shtrira shqiptonin fjalët: *Bleni një misër te pjekur ju lutem!* Përgjatë udhëtimit i shikonim grupe - grupe, me zjarrin bubulak ku dikush i piqte, të tjerë i shisnin, një tjetër i sillte me kosha ose shporta nga arat. Pamja e tyre, mënyra e veshjes, dhe zëri i tyre i ngjirur të plaste shpirtin e të shkulte nga vendi zemrën. Një realitet më se trishtues e revoltues njëkohësisht. Po pse vallë të ndodh kështu?

Dhe shënoi Qendrat e Prodhimit të Barutit (nantëmbëdhjetë ishin gjithësjt S.M.), shkëputur nga një faqe reviste ”Ematia”: *Klos, Bel, Dars, Fshat, Ketë, Guri i Bardhë dhe Bejn* me fiset që e prodhonin dhe tregtonin: *Kaceli, Alstafa, Reçi, Halili, Bebja, Llaveshi, Cenalla, Farruku, Shurdhi, Dishi, Lleshi dhe Pana*. Industria e parë kimike në Shqipëri që funksionoi për mrekulli, pothuajse për pesë shekuj, në këtë krahinë duke i dhanë zhvillimit ekonomik një shtytje të madhe përpara po kështu edhe kulturës e jetës së këtyre vendbanimeve. Sakaq vështroi e livadhis me mendjen time: A do të munden këto qyteza, fshatra me e ringjallë zejtarinë e tyre me mjeshtrit plotë mençuri, të prodhojnë e tregtojnë duke e rizgjuar zhvillimin e ekonomisë, rritur mirëqenien e banorëve dhe qytezat e fshatrat të lulëzojnë? Shpresojmë!

VËSHTROI LUGINËN E EBUS DHE RRUGËN E ARBRIT

Makina përshkon vetëtimthi kthesat e rrugës, e unë lodroi në peizazhet natyrore, poshtë luginës ku shtrihet fshati, Plani i Bardhë. Përbri tij shquaj trasenë e rrugës së Arbrit. Më duket e vjetëruar. E përgjumur. E copëtuar në trase të rregullt dhe e ndërprerë me shpatin e malit që vazhdon lirshëm. As një lëvizje makinerish skavatorash, njerëzish etj. Çfarë duhet të ketë ndodhur vallë? Pyes veten në heshtje.

I afrohemi Qafës së Buallit. Një zgavër gjigante. Sikur aty do të dale në detin e hapur, transoqeaniku gjigant që u fundos më 15 Prill 1912. Ndërsa makineritë që mbanin emrin “Menarini” nuk dukeshin gjëkundi. Më shumë se tre dynym pisha të zeza, pra pyll përherë gjelbërt, ishin zhdukur dhe me qindra drurë ishin “përgjakun” nga gurët e shumtë ose pesha e dheut, të thara e gjysëm të tilla. Një masakrim natyre i papërfytyrueshëm. Shpërdorim parash si në mallin e pazot. Punë pa tregues e udhëzues inxhinierik e studim mjedisor.

Përpara fabrikës ku bahet seleksionimi i kromit një radhë e madhe makinash të tonazheve të mëdha. Nuk më durohesh ma dhe pyeta:

- E këto çfarë presin, pse neve nuk pamë as edhe një makinë të tillë gjatë udhëtimit?

- Ata ngarkohen e rrugëtojnë natën - më përgjigjet duke nënqeshur njëri nga bashkëudhëtarët.

Përsëri ndërhyra: E përse xhanëm kështu?

Nuk mora përgjigje. Përsëri fillova të gatuaj në mendjen time, me ato çfarë kisha lexuar, dëgjuar dhe parë në televizion. Kush vallë i bën këto lëvizje të maskuara?



Rruga e Arbrit, lugina e Planit të Bardhë



Lugina e Eubes (Bulqiza)

Mafiozët politik e ordiner apo….. Hajdutët të veshur me pushtet apo….. Njerëzit që përthithin djersën e gjakun e dhjetëra minatorëve që punojnë 100 e 200 metra nëntokë, veprojnë në fshehtësi, të maskuar, ndoshta edhe të mbrojtur nga…. Pse vallë të lejohet kjo në një shtet demokratik?

Qyteti i minatorëve, kishte pak gjallëri. Grupe të rinjsh që ecnin e bisedonin, kushedi se për çfarë. Asfalti i baltosur e trotuaret me pllaka gjysma te thyeme i shikoje kudo. Nga dyqanet dilnin tek-tuk ndonjë grua me trastën gjysmë të mbushur. Ndonjë makinë e rrallë lëvizte, ndërsa parkimet e makinave dukeshin pa kurrfarë rregulli. Një mjedis i hidhur, i pa shije…..

Në të dalë të qytetit, fare pranë ku dikur kanë qenë ndërtesat e repartit ushtarak, një meso burrë, duke bërë edhe me gisht na thotë: -Ja, tek ai klubi, duken akoma njollat e gjakut, mbram janë vrarë disa te rinj. Na u rrënqethën mishrat kur pamë shenjat e asaj përleshje me armë. Ishin edhe kushërinj të dytë. Dy vëllezërit Ternova nga Vajkali, dy të tjerët nga Kodra e Danit. Nga shkëmbimi zjarrit ka humbur jetën Shefqet Shehu, dyzetë vjeçar dhe plagosur vëllai Vehapi. Fadil Ternova dhe I vëllai kanë përfunduar në burg. E të gjitha këto ndodhën mbrëmjen e njëzetë Prillit. Natë vdekjesh paqësore e me të shtëna armësh. Sa keq!

Kujtojmë se më tetëmbëdhjete Shkurt 1948, u bë shpërthimi i parë i minave duke dhanë sinjalin e fillimit të punimeve për ti shkëputur nëntokës së kësaj treve floririn dhe kromin, për t’i bërë të dobishme: lugën për të ngrënë, gjilpanën për të qepur, majën e penës për të shkruar etj. Filloi beteja e pandalshme e të jetuarit me punëra tepër të vështirë, duke çarë galeritë në drejtime të ndryshme. Shumë djersë, rrëke gjaku të punëtorëve që vdisnin aksidentalisht të mbuluar nga gurët e mineralit apo të gjymtuar përjetë. E të gjitha këto për të fituar bukën e gojës. Për të mbajtur familjen: nënën, babain, gjyshin, për të rritur fëmijët për të ……

Po ky gjak i derdhur kështu, kot së koti, pa kurrfarë motiv jete, përse të ngjajë? Këtu arsye njerëzore duhet të triumfojë. Logjika e ftohtë, mençuria, rrugëdalje paqësore janë metodat ma të pëlqyeshme. Qëllimi i rrëkeve të gjakut në zgavrat e zeza, qindra metra nën tokë, kanë lejtmotivin: Përpara për të punuar, për të shijuar jetën mbi tokë, në shtëpi me familjen, me shokët, me miqtë, me të afërmit, etj, etj. Ndërsa gjaku iderdhur në mes kushërinjsh ashtë e kundërta, antiteza e të jetuarit me gjithë të mirat, vuajtjet, buzëqeshjen e shkëmbimin e fjalëve ditën apo natën mirë dhe mirë u pafshim nesër e... Duke ndjekur rrugën për Fushë Bulqizë e Peladhi, shoqërohemi nga: gur të rënë nga skrapata të latuara nga govatat e skavatorëve gjigand, dheu kishte kaluar murin fundor, dhe kishte ramun mbi asfalt. Disa mure mbajtëse kishin vumun barkë apo çarë nga pesha e materialeve të rrëshqitura. Sakaq, biseda mori udhë:

-Nuk kanë më shumë se dy apo tre vjet. E janë damllosun kështu, – u shpreh një djalosh me futyrë të zgjature flokë kaçurrel të zeza.

- Asht vjedhur more vëlla edhe këtu. Se nuk bahen muret mbajtëse pa lidhje hekuri. Ndërkaq me kujtoheshin rrugët automobilistike, Vau i Dejes-Gomsiqe – Pukë; apo Milot - Rreshen - Lurë, rruga e Qafë Krrabës me drejtimin Elbasan, projektuar nga inxhinier Italian e ndjekur punimet po prej tyre. Muret mbrojtëse edhe të veshura me gure apo beton e hekur ende qëndrojnë pa u dalë edhe një ashkël guri a plasaritje e hollë. Mosha e tyre i ka kaluar të shtatëdhjetë vjetët.

Qetësinë e gjeje duke depërtuar në labirinthet e lashtësisë. Tek ato burra të zgjuar që kishin fituar besimin e mbretërive të Europës, për zhvillimin ekonomik, e mbrojtjen e principatave. Dhe lexojmë: Karli i I Anzhu i Napoli më tetëmbëdhjetë Maji 1273 i jep në Zotërim Bujarit Pal Gropa në Luginën e Ebus këto vendbanime: Radikën, Kllobçishtin, Gjoricën, Zerqanin, Sebishtin, Krajkën. E vërtetuar nga historiani Kristo Frashëri dhe e perforcuar nga Destan Rama, origjina e Gropajve asht nga fshati me të njëjtin emër që ndodhet në afërsi të Sopotit, pra ne Grykën e Madhe. Vështroi nga rruga këto treva e fshatra dhe kërkoi të gjejë pika bashkimi, dhe vizime e shenja të zhdukura për të ndërtuar karakollet që të vështroi të ardhmen dhe të mësoi nga e kaluara sesi, të ndërtoi të ardhmen paqësore e te lumtur të banorëve të sotëm te krahinës së gjerë të Ebus.

Pasi kaloi Shupenzën me të njëjtën gjendje, me këto udhë me gropa mbushura me uji dhe kurrizëdaluna, pres që nga Gjurasi të shohë se si zbresin, makina të tonazheve të medhaja, me blloqet e mermerit. Pa çka se me kujtohet se prej tre ose katër vjetësh këto llojë automjetesh nuk i shohë ma. Çfarë ka ndodhur vallë me këtë minierë?Me sa duket jetojmë në kohën e çudirave.

Nata filloi të hedh vellon e sajë të errësirës, megjithatë, udhët e makinave i gjejmë pas çdo metri e kilometri në të njëjtën mënyrë si e kemi përshkruar më sipër. U befasuam kur kaluam mbi urën e Drinit në Muhurr, ajo ishte shtruar me dërrasa të reja, shoferët e makinave të motorrave, këmbësorët dhe blegtoria kalonin normalisht, pse jo mjaft të kënaqur. Nuk do ta harrojnë kurrë të mësipërmit se u deshën te vuanin për mjaft kohë po kështu edhe kalimtarët nga Katër Grykët, Çidhna, Arrasi, Zallë Dardha, Sinja etj

NGA RINGJALLJA TEK SYRGJYNOSJA

Atë mëngjes edhe pse qepallat më rëndonin shumë, e sytë më kruheshin nga pagjumësia dhe lodhja, vështrova përreth për t’u qetësuar sadopak. Vargmali i Korabit dhe i Runjës përgjatë gjithë gjatësisë së tyre, me të ulurat e të ngriturat e tyre. Nuk di përse më ngjanin si një valle burrash dibrane, qeleshe bardhë e supë më supë të ngjitur midis tyre. Bardhësia e borës në kreshtat e tyre, dhe zbritja përmes peizazheve të thyera, plazmohesh gradualisht me gjelbërimin, i cili sa kishte filluar të ndryshoi pamjen e kafejtë të dimrit, deri në shtratin e Drinit ujë shumtë e kaltërosh. Kjo asht gropa e Dibrës, e formuar në mijëra vjeçar nga fise të ndryshme, të ngulur mbi këto shpate, njerëzit kanë punuar e luftuar pa pushuar, duke e mbajtur të gjallë dhe zbukuruar shpatet, luginat, mbjellë arat e kopshtiet, ndërtuar shtëpi për vete e kasolle për blegtori duke krijuar fshatrat, gjithashtu ngritur në kodra, kala e qyteza. Historia asht transmetuar gojë më goje në kuvendet e burrave, në veshje, në zejtari dhe së fundi po shkruhet me vërtetësi nga intelektualet Dibranë e më gjerë.

Të shumtë më vijnë për *krejt -shnosh,* nga Girokastra, *Kleanthi Mandi*, nga Tirana, *Gjon Fierza*, nga Peshkopia, *Bekim Qosja*, *Rasim Bunguri dhe Hyqmet Topuzi, Munir Hoxha* nga Blliçja e dhjetra të tjerë. Bisedonim për pyjet e ulëta të lisit, raporti i pronësisë private me atë shtetërore, dëmtuesit që nuk e pshtynë dorën në asnjë stinë të vitit. Për peticioni e intelektualit Dibranë Gëzim Alpion, që kishte çuar peshë Dibrën mbarë etj.

Duke kujtuar rrugët e vjetra që të çonin drejt Tiranës me kuaj dhe në kam, ndërsa sot në ketë fillim shekulli, rëndësia ekonomike, kulturale, shoqërore, tregtare, turistike, strategjike që paraqet vazhdimi i punimeve të Rrugës së Arbërit në cilësi e shpejtësi. Arsyea që u ndërpren punimet sipas bashkëbiseduesve ishte sepse, partitë në pushtet, kërkojnë të marrin votat e elbasanlive. Binin pa pushue daullet e zgjedhjeve të reja.

Më pas bisedat rrokullisen mbi kthimin e shumë të rinjve nga kurbeti në Greqi, Itali etj. Disa janë kthyer duke punuar tokat e babait ose duke ruajtur dhentë e dhitë. Të tjerë ia kanë mbathur për në shtetet e Anglisë, Gjermanisë të Sh.B.A. etj. Ndokush, i ka hyrë kriminalitetit dhe vjedhjeve. Shoqëria shqiptare vuan nga ethet e forta të varfërisë shumë përmaseshe.

Në Minierën e Mermerit në Zabel te Madh, ka filluar puna, që me një Shtator 2012, e tani punojnë Idris Lika me skavator, Ali Rina, Agim Pana dhe Agim Skana. Të gjitha punimet kryhen me makineri të reja, si fadroma, sonda për kërkime gjeologjike të mermerit, dhe makina e prerjes së blloqeve. Ndërsa dallëndyshet që fluturojnë këtyre anëve lajmërojnë ardhjen e pranverës. Vendalijte dëgjojnë çfarë thuhet e lexojnë çka shkruhet, shikojnë qiellin e natyrën përreth e shpresojnë në të ardhmen më të mirë.

Një agim i ri sapo ka hedhur rrezet duke ndriçuar shtigjet e një së ardhmeje të re, në trevën e Muhurrit, ashtu si mësuesit përmes viteve 1945 - 1955 mbollën farën e diturisë, për të ecur përpara me prozhektorët e dijes pra duke mësuar me zell alfabetin shqip me abetaren e më pas gjeografinë, historinë etj, edhe sot diçka rrezaton. Dhe ja cilët ishin: *Ndoc Turqia nga Shkodra, Kurt* e *Nazif Hoxha nga Muhurri, Selman Biba nga Selishta, Gani Keta me të bijën Lirien nga Shengjergji i Tiranes*. Kjo asht koha që lenë gjurmë të brezat njerëzor, duke i zgjuar e përgjumur, e përsëri shpërthime energjish, për të vazhduar atë. Të gjitha këto gjase i ngjajnë përroit të Murrës plakë, që shtratin e saj e ka formuar përgjatë gurgullimës se shekujve, dhe e gëzon, përdor, sundon e së fundi e qeveris ajo vetë.

Ashtu si bora e cila ndiqet hap pas hapi nga murgulli i bimësisë drunore, shkurrore e barishtore, duke u ngjitur përtueshëm drejt shpateve, luginave, kurrizeve dhe drejt majave hijerëndë, edhe mua më duhet të largohem. Për borën ashtë shtysa dielli pranveror për mua asht të jetuarit e të punuarit në dhe të huaj. Puna asht shtylla kurrizore e jetës njerëzore njëkohësisht edhe gjeneratori i fuqishëm i ndryshimeve të natyrës e shoqërisë njerëzore. Ndryshimi asht se e para asht proces natyror mijëra vjeçar ndërsa ikja ime dhe e qindra mijëra shqiptarëve, asht dukuri shoqërore, ekonomike, e lidhur pazgjidhshmërisht me politikat ekonomike të shtetit si instrument i zgjedhur për drejtim nga populli.

Mikrobusi përshkoi të njëjtën rrugë automobilistike, veçse pasagjerët ishin të ndryshëm. Ato bisedonin, bënin shaka, dhe qanin hallet e jetës mbushur me dallgë vuajtjesh e dhimbjesh. I mençur asht ai që zgjedh një veprim, që duke trazuar në trastën e vuajtjeve, të zgjedh atë që të shkakton dhimbje më të pakta. Befasohemi kur pasi kalojmë Kodër Kamzën dhe më pas urën, ndërtesa gjigante ku shohim të shkruajtur *Materiale Kopshtarie* ishte boshatisur. Një heshtje varri mbretëronte aty përreth. Drejtkëndëshat e shumta si vende parkimi të makinave u shikojmë vetëm konturet e bardha, të boshatisura. Vetëm një roje që na dukesh si milingone, kur e shihnim të lëvizte në atë fushë parkimi makinash. Një mjedis i shkretuar, ku mbretëronte heshtja.

- Aty kishte gjithçka, për lulishte, bujqësi e blegtori, vegla pune të thjeshta e makineri, plehra kimike e organike etj-na tregon një mesoburrë i cili kishte blerë disa herë.

- U shkri si flluskë sapuni, nuk dimë asgjë se çfarë i ndodhi- u hodh një djalosh fare pranë meje. Vështronim përroin që kishte prurje të pakta uji, e kërkonim ta akuzonim se ndoshta…..

Pasi kaluam linjën hekurudhore diku pranë mbi kalimit të projektuar e ndërtuar nga një ndërmarrje austriake, mikrobuzi u ndal dhe zbrita. Ky vend para njëzetë vjetësh quhesh *Kthesa e Kamzës,* më pas me ndërtimin e një kompleksi dyqanesh nga një shoqëri Italiane thirret edhe *Kaza Italia*. Të tjerë e quajnë tek *Mbikalimi i Austriakut*. Arkitektura e saj tërheqëse, materialet e ndërtimit të përdorura, gjelbërimi për rreth me ullinj shekullor dhe oleandrin si shkurre zbukuruese, tregojnë qartë për një kulturë perëndimore qe ka zane rrënjë këtu.

Pranë saj më befasoi një ndërtesë prej xhami e hekuri me një formë të çuditshme, e shumë e lartë. Ndoshta kur të përfundoi, kësaj nyje të rëndësishme që lidh Veriun e Shqipërisë me kryeqytetin dhe Durrësin do ti ndryshojë përsëri emri. Jetojmë në kohërat e ndryshimeve të mëdha dhe të papriturave të hidhura e të këndshme.

Taksixhiu ishte një djalë simpatik, i veshur hijshëm, flokë të zinj dhe me ca sy të vegjël në një fytyrë pothuajse të rrumbullakët. Ai bisedonte me një vajzë për pallatet e rejan ë qendër të Tiranës për politikën, dhe për provimet që duhej të jepte. Ajo sakaq dhe zbriti, me plote elegance, e veshur sipas modës që i shikojmë shpesh vajzat në Firence, me një çantë librash dhe një kompjuter. Pasi pagoi e përshëndeti shoferin u largua drejt ndërtesës së universitetit Turk.

Kalova të gjitha kontrollet në aeroport. Avioni filloi të lëvizë drejt, duke ecur me rrota e më pas mori vrull dhe u ngjit mbi re. Nuk ishte hera e parë që ndjeja në thellësi të qenies sime drithërimat e syrgjynosjes. Edhe pse ngushëlloja veten me ato që mora në hojet e trurit, si pamje të gjithë llojshme, fragmente bisedash me fluturime në horizontet e kohërave, mallin përvëlonjës për gjithçka, megjithatë syrgjynosa për të vazhduar jetën me gjithë pamjet e saja, si të një prizmi prej qelqi, në një vend tjetër, me kulture e zakone të ndryshme. Por……..

* * *

Kërkova të më shoqëronit me mëndje dhe me sy, me përfytyrimet me të bukura por edhe me të dhimbshmet e dërmuese të shpresave e të së ardhmes. Dëshiroja t’iu prezantojmë peizazhet e natyrës dhe të atyre te krijuara me një mijë sakrifica nga njeriu i kësaj toke të stërlashte. Me Doktorin e shkencave Aref Matin me origjinë nga Rremulla, që zbuloi me një punë tridhjetëvjeçare në kopshtin e lulëzuar të dijenive botërore për gjatë mijëravjeçarëve, zotërit e vërtet të këtij trualli që prej tre mijë vjet para krishtit. Kryemjeshtrin i ndërtimit të Dingave të barotit, Sefedin Kurtin i cili, kënaq dhe mahnit marrëzishëm vizitorët në muzetë e Prishtinës, Tiranës, Gjirokastrës, Shkodrës, Burrelit etj. me mjeshtrinë e mençurinë e përzierjeve të lëndëve të ndryshme për të prodhuar *BAROTIN*, duke i njohur konkretisht me historinë e tij shumëshekullore. Të njiheshim me *Dr. Gëzim Alpionin*, që po lufton me të gjitha format e propagandës e të mjeteve moderne e demokratike, për realizimin e ëndrrës së *Madhe te Dibranëve*, për të nxjerrë nga humbëtirat e fshehura të shekujve një rrugë të vjetër por me përmasa të reja, ku *Stambolli, Shkupi, Selaniku, Dibra* e *Madhe dhe* e *Vogël të udhëtojnë shpejt, mirë e lirë drejt qytetërimit evropian*.

Shpresojmë tek ringjallja e ekonomisë, e kulturës e këtij populli që po përpëlitet në mes kudhrës e çekanit por megjithatë ai shpreson e vështron përpara me gjithë forcën e shpirtit heroik e energjive që e ushqen e kaluara.”....**Por duhet të merremi seriozisht e të shqetësohemi për ti dhanë Shqipërisë një sistemim natyral përfundimtar, kjo ashtë detyrë e të gjithë atyre qe zotërojnë aftësi për ta çuar këtë popull në kushte sa më të mira, për të ngjitur kështu, shkallët më te larta të qytetërimit në një kohë sa më të shkurtër “-** kështu shkruante, shpresonte që në vitin 1918 studiuesi i shquar arbëresh Zef Skirio.

Firence 20.05. 2013



Shqiponja, Shkopet

foto fakt

Kalaja e Grazhdanit është monumenti antik më i madh në Shqipëri, madje edhe në Ballkan

Foto: © Bujar Karoshi




Në foto tregohen dy tabela të thyera në Kalanë e Grazhdanit, në të cilat informoheshin vizitorët mbi historikun e saj. Në Dibër ka shumë vende historike të vizitueshme nga turistët e huaj dhe vendas, por nuk ka informacione mbi to. Ato ose nuk janë vendosur fare, ose janë thyer si në foton e mësipërme.

Kalaja e Grazhdanit ndodhet ne veri të pellgut të Dibrës, në mes të qytetit të Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe. Ajo është e ndërtuar në një terren kodrinor 500-600 metër mbi nivelin e detit. Muri lindor i kalasë, i zbuluar para pak kohësh nga gërmimet arkeologjike, kalon disa metra në lindje të rrugës nacionale, ndërsa në perëndim afrohet me Drinin e Zi. Kalaja ka pasur një pozitë të rëndësishme strategjike në kontroll të rrugës së Drinit të Zi, që e lidh atë me dy arteriet më të rëndësishme transballkanike të periudhës romake: via Egnatian në Jug dhe atë Lissus – Naissus në veri.

Rëndësia e kësaj pozite rritet edhe nga fakti se ajo ndodhet në pikëtakimin e provincave të Epirit të Ri, Macedonia Secunda, Prevalitanisë dhe Dardanisë.

Kalaja e Grazhdanit është monumenti antik më i madh në Shqipëri, madje edhe në Ballkan për përmasat e saj rreth 34 ha sipërfaqe dhe gjatësia prej 3.5 km e mureve që e rrethojnë këtë sipërfaqe. Por kjo qendër ka rëndësi, veçanërisht, sepse mendohet që ishte pikërisht ajo që i dha emrin krahinës së Dibrës.

Por këto informacione shumë të vlefshme për turistët, nuk mund të lexohen më, të paktën derisa institucionet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre, të kujtohen t'i zëvendësojnë.



Librin HISTORIA E DIBRËS
të Kristo Frashërit mund ta gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Dibër të Madhe: Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

Thirrje për sponsorizim

Shtëpia Botuese "M&B" ka në proces botimi
dy libra me vlera historike, kulturore
dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë:
"ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE"
dhe monografinë **"ABDYL FRASHËRI"**
- Jeta, veprimtaria dhe shkrimet
të **Akademikut KRISTO FRASHËRI.**

Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen
bashkëkontribues në këto projekte,
mund të na shkruajnë në email:
mbbotime@gmail.com/ botimemb@gmail.com
ose në tel: 069 20 68 603.
Faleminderit!

Një spektakël i prezantuar me shumë sukses nga **Lunada Methasani**

Ka plot të rinj të talentuar dibranë që na nderojnë kudo. Një prej tyre është Lunada Methasani, e bija e gazetarit shumë të njohur sportiv, dibranit Dëfrim Methasani.

Lunada ka lindur më 20 qershor 1993 në Peshkopi. Studion për Ekonomi, mirëpo pasioni i saj për gazetarinë i është ushqyer vazhdimisht nga shembulli i përkryer babait të saj.

Ka patur disa eksperienca të suksesshme në botën e televizionit, por më e spikatura ka qenë së fundmi kur ka prekur nga afër ëndrrën e saj për të ecur në hapat e të atit. "Bora Fashion", një institucion mode në Kosovë, duke pare talentin e saj në këtë fushë e zgjedh atë prezantuese dhe moderatore të sfilatës që ajo mbajti në Tiranë për herë të parë.

Një sfilatë me veshje të kohëve të vjetra, të salloneve mondane, të shekujve të ndryshëm të njerëzit, por edhe veshje moderne, duke gërshetuar stilet e reja, punimet me dorë. Një spektakël i vërtetë, me këngëtarë dhe grupe muzikore të ftuara, por nuk kanë munguar dhe numrat e shpejtësisë.

Me plot gojën ishte një super event mode, një mbrëmje e veçantë me kreatoren dhe dizajnere nga kosova Bora Balaj dhe që u drejtua me shumë sukses nga Lunada



Methasani, e cila spikati shumë në këtë mbrëmje. Pas këtij suksesi, ajo ka marrë kështu ftesa nga shumë institucione dhe organizatorë të tjerë për bashkëpunime.

Suksese Lunada!



Lunada ka lindur më 20 qershor 1993 në Peshkopi. Studion për Ekonomi, mirëpo pasioni i saj për gazetarinë i është ushqyer vazhdimisht nga shembulli i përkryer babait të saj, gazetarit shumë të njohur sportiv, dibranit Defrim Methasani.





Ideali kombëtar në një libër

> "Një vështrim tjetër i historisë" është mbështetur mbi një literaturë të gjerë. Po garancia e tij më e madhe shkencore qëndron në faktin që është shkruar nga një njeri i ndershëm, me integritet të fortë moral, me burrërinë e shqiptarëve të hershëm, tek të cilët nderi e dinjiteti dhe dashuria për atdhe peshojnë shumë.

Nga **XHAFER MARTINI**

Libri "Një vështrim tjetër i historisë", shkruar nga shoku im i fakultetit Myrteza Bajraktari, është i veçantë. Një libër duhet gjykuar për përmbajtjen e për nivelin e me të cilin është shkruar.

Autori i tij është në plan të dytë. "Një vështrim tjetër i historisë" fiton vlera edhe për faktin se është shkruar nga një atdhedashës i shkëlqyer.

CILI ËSHTË MYRTEZA BAJRAKTARI?

Lindi në Gostivar më 1933. Këto viste ku janë ngritur qytete, si: Kumanova, Tetova, Shkupi, Gostivari, Dibra, Kërçova, Struga, Ohri, Manastiri bashkë me rrethinat e tyre, autori i emërton Shqipëria Lindore. Myrtezai u shkollua në Tetovë dhe në Shkup deri në nivelin e shkollës së mesme. Duke qenë njëkohësisht edhe student i filozofisë dhe gazetar i *Flakës së Vllaznimit* në Shkup, kontribuon për çështjen kombëtare shqiptare. Në kohën kur ishte mësues në Kumanovë, në vitin 1953, arrestohet si kryetar i organizatës ilegale SHKËNDIJA. Torturohet dhe dënohet për idetë e tij nacionaliste 7 vjet, që i kaloi në burgun e Idrizovës.

Mbasi del nga burgu, arratiset për në shtetin amë, në Shqipëri, ku e presin disa muaj hetuesi dhe internimi në kampin e Semanit. Në vitin 1966 i jepet e drejta për të ndjekur studimet e larta për gjuhë e letërsi në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Tiranë, të cilin e përfundon si student i rregullt në vitin 1970. Kam pasur fatin ta kem shok kursi. Po këtë vit arrestohet prapë dhe dënohet me akuzën si "...element me pikëpamje nacionaliste dhe kundërshtar i sistemit socialist." Mbasi kryen dënimin, detyrohet të punojë punë të rënda, duke u privuar nga e drejta e profesionit.

Qysh në korrik të vitit 1990 hidhet në punë ilegale duke formuar grupin FRONTI ANTIKOMUNIST SHQIPTAR.

Në janar të vitit 1993 emërohet konsull i Shqipërisë në Zvicër, ku, po atë vit nxiret në asistencë, megjithëse punoi shumë për hapjen e Bankës së Diasporës në Shqipëri.

Ka vite që jeton në Bruksel duke u marrë me veprimtari nacionaliste.

CILAT JANË VLERAT E LIBRIT?

Këto i pohon vetë titulli**: "Një vështrim tjetër i historisë".** Myrtezai shkruan për historinë e kombit, sidomos për atë pjesë të historisë më të re (1939 e në vazhdim), që, sipas tij, është manipuluar, shtrembëruar dhe tjetërsuar. Myrtezai ka jetuar dhe ka punuar edhe në Shqipërinë Lindore, edhe në Shqipërinë Londineze, siç është kjo e sotmja ku jetojmë ne. Të dy realitetet i njeh mirë dhe i jep me vërtetësi. Por më shumë ai hedh dritë mbi Shqipërinë Lindore dhe mbi Kosovën duke trajtuar ngjarjet më të rëndësishme dhe duke na bërë të njohur veprimtarinë atdhetare të shumë protagonsitëve historikë që nga historiografia jonë e periudhës së socializmit janë paraqitur krejt ndryshe nga ç\i trajton Myrtezai. Autori nëpërmjet këtij libri synon të ngrejë kulturën politike, filozofike, historike e morale të shqiptarëve, që, si thotë ai, janë mëkuar me gënjeshtra nga sistemi totalitar.

Myrtezai nuk shkruan nga pozitat e asnjë partie politike, as për të shkuarën, as për të sotmen. Ai ka një masë për të vlerësuar çdo ngjarje dhe çdo personalitet historik: interesi kombëtar. Sipas tij, interesi kombëtar ishte krijimi me çdo çmim i Shqipërisë Etnike. Nëse një gjë është në dobi të këtij qëllimi, për Myrtezain është e mirë dhe e vlerësuar, nëse shkon kundër këtij qëllimi, është e keqe dhe e dënuar.

PËRMBAJTJA E LIBRIT

Libri është botuar nga West Print më 2011 dhe hapet me parathënien e shkruar nga Qemal Velija. Kapitulli i parë i kushtohet shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Autori tregon se dorëheqja e Ismail Qemalit qe e imponuar. Kalimin e pushtetit në duart e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit ai e shikon si vepër të politikanëve shqiptarë, të cilët, ende pa u formuar shteti shqiptar, tregojnë ambicie të pafrenuar për ta rjepur atë sa më shumë. Zotërues në politikën tonë që kur u krijua shteti shqiptar e deri më sot, thotë libri i Myrtezait, ka qenë lidershpi që është udhëhequr nga interesat personale. Ata lider që kanë parë interesat kombëtare kanë qenë më të pakët, kanë pas më pak përkrahje edhe nga populli, dhe aspak nga faktori ndërkombëtar. Historia e kombit tonë është shkruar, natyrisht, nga fitimtarët, pohon Myrtezai në librin e tij, por nga fitimtarë cinikë dhe të egër, që nuk u njohën asnjë meritë kundërshtarëve politikë, atyre që mendonin ndryshe dhe që e donin ndryshe atdheun. Egërisa me të cilën u sollën fituesit ndaj humbësve gjatë gjithë kohës kur luftohej për fatet e atdheut, depërtoi edhe në histori, në gjithçka. Po shkenca që bëhet me egërsi, me gënjeshtra dhe manipulime, gjithçka mund të jetë, vetëm shkencë dhe kulturë nuk është, sepse misioni i tyre është dritëdhënës dhe jo errësues dhe mbytës. Myrteza Bajraktari në librin e tij tregon anën tjetër të medaljes, por para se të shkojmë tek ngjarjet dhe personalitetet, le të japim esencën, themelin, bazën filozofike e mendore mbi të cilën është ngritur ky libër. Këtë e ka thënë me pak fjalë Qemal Velija në parathënie: **"Njësimi kombëtar u quajt pushtim – shpërbërja e njësisë kombëtare u quajt çlirim; mbrojtësit e kufijve etnikë u quajtën reaksionarë e gjakatarë – falësit e atyre kufijve u quajtën çlirimtarë; politikanët nacionalistë u quajtën kolaboracionistë – politikanët vegla të serbëve dhe të grekëve u quajtën shpëtimtarë; luftimet ndaj forcave serbe e greke u quajtën në shërbim të pushtuesve – lufta civile mes palëve që synonin pushtetin në shtetin e cungët të pasluftës u quajt nacionalçlirimtare; Rexhep Mitrovica, Mehdi Frashëri, Patër Anton Harapi, Xhefer Deva, Lef Nosi, Mihal Zallari etj., u cilësuan tradhtarë se bashkëpunonin me Nojbaherin për ruajtjen e njësisë shtetërore kombëtare – Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Ramiz Alia e kompani u vlerësuan si atdhetarë se bashkëpunonin me Mugoshën e Popoviçin për të shpëtuar hegjemoninë serbe të pasluftës në Gadishull, e kështu me radhë."**("Një vështrim tjetër i historisë, f. 11)

Ky libër nuk është shkruar për të ndërruar bindjet e askujt. Megjithatë, këtë libër është më mirë ta lexosh sesa të mos e lexosh.

Në libër ka shumë ngjarje. Do të ndalemi tek ato më kryesoret. Autori thotë se gjatë Luftës së Dytë Botërore u krijuan edhe një herë shanset për të bërë Shqipërinë Etnike. Koha më e përshtashme ishte ajo kur kapitulloi Italia fashiste dhe kur vendin e saj në Ballkan e në Shqipëri e zuri Gjermania. Autori përdor togfjalëshin **"Trojet e Lirueme"** për Shqipërinë Lindore, të cilën e përkufizuam pak më lart. Këto troje quhen të lirueme mbasi ushtria gjermane shkatërroi nga themelet shtetin e egër, shtypës dhe policor serbojugosllav. Autori me njohjen e thellë që ka, na sjell plotë imtësi. Ja si paraqitet gjendja në në këto vise fill pas kapitullimit të Italisë: "Në Trojet e Lirueme, - shkruan autori, - administrata civile nuk pësoi asnjë ndryshim edhe mbas kapitullimit të Italisë. Në Strugë, Kërçovë, Dibër, Gostivar, Tetovë, e deri në fshatin Grupçi në afërsi të Shkupit, ku ishte kufiri i Shqipërisë me Bullgarinë, njerëzit jetonin në harmoni, ndonëse ishte kohë lufte. Rendin dhe qetësinë e ruante policia shqiptare, kryesisht vendas, njerëz të zgjedhur nga paria e qytetit, por që i ishin nënshtruar edhe një testimi profesional nga një komision ekspertësh për policinë, i cili ishte nga Tirana."(Një vështrim tjetër i historisë, f. 171) Nga ky pasazh del që edhe Italia kishte lejuar krijimin e shtetit shqiptar në kuptimin e vendosjes së një administrate shqiptare kudo. Gjithashtu del që Tirana ishte kryeqendra e vendit, që njihej edhe nga qytetet e tjera që nuk bënin pjesë në Shqipërinë Londineze.

Autori portretizon disa atdhetarë shqiptarë, që në periudhën e diktaturës u satanizuan. Njëri prej tyre është edhe Xhemë Gostivarit (Simnica), i cili në vitin 1933, mbasi kishte vrarë dy xhandarë jugosllavë në shtëpinë e tij, arratiset në Shqipëri dhe jeton në kazermat e Ali Rizasë në periferi të Tiranës, ku i nënshtrohet një disipline të rreptë, por edhe mëson artin ushtarak. "Mbas kapitullimit të Italisë, ishte shumë e natyrshme që në krye të vullnetarëve të armatosur të ishte Xhemë Gostivari, një njeri që nuk "e zinte plumbi", një njeri, që, kur gjëmonte, tundeshin malet...Kush tjetër përveç atij mund t\i mbronte me vetëmohim më të madh kufijtë e shejtë të atdheut të shejtë, Shqipërisë?Njeriu autoritar dhe me integritet kreshnikësh!"(f. 175) Të njejtën gjë bën autori edhe për personalitete të tjera që luftuan me vetëmohim dhe sakrifikuan gjithçka për sendërtimin e idealit kombëtar: bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Me dashuri autori përshkruan Mentor Qokun, Murat Llabunishtin, Hysni Demën, Nazim Tateshin, Beqir Agën etj. Por me dashuri të jashtëzakonshme dhe me krenarinë që i përkisnin racës shqiptare Myrteza Bajraktari ka skalitur portretet e më kryesorëve në Lëvizjen për Shqipërinë Etnike siç ishin Mit\hat Frashëri, Xhafer Deva, Prenk Previzi, Muharrem Lika, Muharrem Bajraktari, Sami Koka, Tahsim Bishqemi, Haziz Blloshmi, Daut Çarçani , Qazim Komani, Fuat Dibra, Shefki Shatku, Lek Margjini, Gjon Çipi, Xhelal Mitrovica, Ibrahim Biçaku, Mehdi Frashëri, Lef Nosi, Mustafa Ulqinaku, Patër Anton Harapi, Eqrem Çabej, Gjon Marka Gjoni, Kolë Bibë Mirakaj, Sulçe bej Bushati, Maliq bej Bushati etj., etj.

Prej këtyre, më i njohuri, por i njohur për keq, ka qenë Xhafer Deva, njeriu që kreu masakrën e 4 shkurtit duke vrarë tetëdhjetë e katër vetë, ajkën e djemërisë shqiptare.

Kështu është shkruar për të në komunizëm. Autori për Xhafer Devën thotë të tjera gjëra: "Reputacioni dhe kontributi i tij për krijimin dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptar bënë që ai, së bashku me udhëheqës të tjerë, edhe pas luftës të pritej dhe të konsiderohej nga demokracitë perëndimore si *eminence grise* e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, e cila e afirmoi Kosovën si krahina më vitale e Shqipërisë. Për këtë dëshmojnë vizitat e tij të shumta dhe pritjet me nderime që iu rezervuan në Shtëpinë e Bardhë, Romë, Londër, Ankara e Bon."(f. 135) Myrteza Bajraktari jep një tablo krejt tjetër, të kundërt me atë që është dhënë në diktaturën komuniste për masakrën e 4 shkurtit ku janë vrarë 8 vetë dhe këta në një konflikt të rastit, pa paramendim dhe pa dijeninë e Xhafer Devës, dhe jo 84 siç thuhej në historinë e periudhës së diktaturës. "Ngjarja e 4 shkurtit lidhet, pa dyshim, me një zëvendëskomisar që kishte dezertuar nga një brigadë partizane, sepse ishte i zhgënjyer dhe i frikësuar, kishte nuhatur se Mehmeti me Dushanin po përgatiteshin ta eleminonin, - shkruan autori.- Ky ishte Xhelal Staravecka, i cili, duke kuptuar dinakëritë dhe mizoritë e eprorëve të tij, gjeti mënyrën të paraqitej tek Xhafer Deva dhe ta informonte se komunistët po përgatiteshin të sulmonin Ministrinë e Brendshme. Natën e 3 shkurtit, Xhafer Deva dha urdhër që të dyfishoheshin rojet përreth ministrisë dhe ngarkoi me detyrën e drejtimit të rojeve të nipin e tij, meqenëse Pajazit Boletini, i cili e kishte këtë përgjegjësi, nuk ndodhej në Tiranë. Gjatë kryerjes së kësaj detyre dhe inspektimit të rojeve pranë urës së Lanës, afër Hotel Dajtit, një njësit komunist që vepronte në atë vend dhe e kishte bazën në shtëpinë e Kujtim Spahivoglit, u ndesh me rojet dhe goditi për vdekje nipin e Xhaferit. Në këto rrethana, rojet zunë pozicione luftimi dhe hapën zjarr.

Autori thotë se ideali ynë kombëtar është i papërmbushur edhe sot

Pra, kjo është "Maskara e 4 shkurtit", ku u vranë tetë vetë, sipas dokumenteve të Arkivit të Shtetit, dhe jo 84 sipas legjendës komuniste. Partia Komuniste ka spekulluar e manipuluar gjerësisht me këtë ngjarje". (136)

Po ngjarja më madhore për të cilën në historiografinë tonë të periudhs së diktaturës është heshtuar, është Lidhja e Dytë e Prizrenit, që nisi më 16 shtator 1943 me iniciativën e prefektit të këtij qyteti, Asllan Boletini, në përkrahje të të cilit ishin edhe zotërijtë Musa Shehzade, Sheh Hasani, Tahir Zajmi, Llukë S. Mjeda, Pjetër Vukaj, Qazim Bllaca, Rexhep Mitrovica, Muhamet Frashëri etj. Në Tiranë ishte ngritur qeveria shqiptare, për të cilën do të flasim më vonë, por prej kryeqytetit shqiptar shkoi një delegacion për të marrë pjesë në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, në përbërjen e të cilit ishin: Xhafer Deva, Rrok Maloku, Bedri Pejani, Xhelal Mitrovica, Masar Sopoti etj. Në Kuvendin e Prizrenit morën pjesë 42 delegatë që përfaqësonin Tiranën, Shkodrën, Durrësin, Elbasanin, Ohrin, Strugën, Gostivarin, Tetovën, Dibrën, Mitrovicën, Prishtinën për të përmendur vetëm disa prej qyteteve kryesore. Detyrat e Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin këto: "Bashkimi i trojeve shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë Shqiptare e të Malit të Zi me Mbretërinë e Shqipërisë; mbrojtja e këtyre tokave nga ekspansioni komunist sllav; sigurimi në rrugë historike dhe diplomatike i qenies së shqiptarëve në këto toka. "(f. 130)

Lidhja zgjodhi edhe Komitetin Qendror të saj me vota të fshehta, sipas të cilave z. Rexhep Mitrovica u zgjodh kryetar, z. Musa Shehzade nënkryetar, Kolë Margjini nënkryetar, ndërsa Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi dhe Qazim Ballanca u zgjodhën anëtarë...Më 21 shtator 1943 delegatët e Kuvendit firmosën në selinë historike të Lidhjes së Parë të Prizrenit vendimet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Statuti i Lidhjes përbëhej prej 22 pikash dhe u njoh nga Këshilli i Lartë i Shtetit Shqiptar, që kryesohej nga z. Mehdi Frashëri."(f. 131)Shqiptarët atdhedashës e shpallën Shqipërinë Etnike shtet të pavaruar qysh me kapitullimin e Italisë fashiste, megjithatë, për t\i vënë gjithçkaje vulën juridike dhe frymë kushtetuese, në tetor të vitit 1943 u mblodh në Tiranë Asambleja Kushtetuese. Me këtë rast erdhi në Tiranë dhe njohu Pavarësinë e Shqipërisë përfaqësuesi i qeverisë gjermane, Nojerbah. U krijua Këshilli i Regjencës në përbërjen e të cilit ishin zotërinjtë Mehdi Frashëri, Patër Anton Harapi, Lef Nosi e Mustafa Ulqinaku. Regjenca qeveris, siç dihet, në vend të mbretit, i cili ishte dëbuar me luftë nga froni. Kur të vinte mbreti, Shqipëria do të vazhdonte jetën normale. Duke njohur Regjencën, Gjermania njohu mbretërinë shqiptare, legjitimitetin e saj. Nojerbahu, edhe nën prezencën e dy gjeneralëve gjermanë, firmosi tok me Këshillin e Regjencës Shqiptare aktin e "*Pavarësisë relative*

> "Rryma e parë pati si bosht mendimi se edhe me cilindo mund të bashkëpunohej, vetëm që të fitohej e të ruhej tërësia e katër vilajeteve, apo e Shqipërisë Etnike.

në kushtet e luftës". (f. 142) Nga Asambleja Kushtetuese u krijua një Qeveri Provizore me kryeministër Ibrahim Biçakun. Kryetar i Asmablesë u zgjodh profesor Mihal Zallari. Më 16 tetor 1943 u mblodh në Tiranë Kuvendi Kombëtar dhe me 15 nëntor Regjenca krijoi qeverinë e re me kryeministër z. Rexhep Mitrovica. Asambleja Kombëtare, me këtë rast, me pjesëmarrjen e delegatëve edhe nga Çamëria, shpall pavarësinë dhe neutralitetin e Shqipërisë Etnike.

Për shkak të kundërveprimit të ashpër të komunistëve shqiptarë në unison me ata jugosllavë, për shkak edhe të rrethanave të luftës, qeveritë shqiptare ndërroheshin shpesh. Qeveria e tretë, brenda një harku kohor prej 10 muajsh, u krijua më 18 korrik 1944, me kryeministër Fiqiri Dinen, i cili mbante edhe postin e ministrit të punëve të brendshme. Anëtarë të tjerë të këtij kabineti ishin Prenk Pervizi, ministër i mbrojtjes kombëtare, me gradën gjeneral; Eqrem Vlora, ministër i jashtëm dhe i drejtësisë; Rrog Gega, ministër i financave; Rifat Begolli, ministër i ekonomisë; Koço Muka, ministër i arsimit dhe Mark Gjon Markaj, ministër i kulturës popullore. Myrteza Bajraktari, nëpërmjet fakteve dhe dokumeneve, por edhe të logjikës historike, tregon se forcat nacionaliste, me gjithë organizimin që patën, nuk mundën të fitonin. Gjermania si i vetmi shtet që përkrahte Shqipërinë Etnike dhe atdhetarët që ishin mbështetës të kësaj ideje, e humbi luftën.

Njeri nga shtetet më të fortë që doli edhe fitues në këtë luftë, Anglia, ishte kundër Lëvizjes për Shqipërinë Etnike, madje kundër edhe asaj copë Shqipërie që ishte njohur nga Londra më 1913. Çurçilli ka qenë përkrahës i Greqisë dhe mospërfillës ndaj popullit shqiptar, racës shqiptare dhe nocionit shqiptar. Anglia, duke mos e njohur mbretin e shqiptarëve dhe qeverinë shqiptare në mërgim, e humbi legjitimitetin e shtetit shqiptar me qeveritë që përmendëm më lart, dhe u krijoi mundësinë komunistëve që të marrin fatet e vendit në dorë. Autori ka sjell material interesant që dëshmon se krejt ndryshe ishte plani amerikan i 10 shtatorit 1943, sipas të cilit, ajo që duhej mbrojtur ishte Shqipëria ETNIKE. "Sipas kësaj alternative, territori shqiptar do të mbetej (ashtu siç ishte) i zgjeruar me Kosovën dhe Luginën e Vardarit, e kufiri do të ndërpriste hekurudhën Kragujevac-Mitrovicë-Shkup, domethënë një nga vijat strategjike të komunikimit me Jugosllavinë. Sipas mendimit të studiuesve amerikanë, për këtë duhej bërë një referendum me mbikqyrjen e ndërkombëtarëve"(f. 198) Por Anglia ishte shumë e fortë në vendimarrje në zonën e Ballkanit dhe se përfaqësuesit amerikanë në Shqipëri në periudhën e luftës ishin nën ndikimin e anglezëve. Shumë plane u hartuan, shumë strategji u përdorën, shumë manovrime u bënë, shumë gjak u derdh për Shqipërinë Etnike, thotë autori, por përfundimi qe i hidhur: Shqipëria Londineze ra në duar të komunistëve shqiptarë, kurse pjesa tjetër e Shqipërisë iu dha komunistëve sllavë dhe grekëve. Autori tregon se veprimet e mosveprimet, betejat dhe luftërat, projektet e kundërprojektet ndaj të ardhmes së Shqipërisë kishin të bënin me dy ide, me dy qëllime, me dy baza filozofike, me dy rryma mendimi krejt të kundërta e të papajtueshme:

"Rryma e parë pati si bosht mendimi se edhe me cilindo mund të bashkëpunohej, vetëm që të fitohej e të ruhej tërësia e katër vilajeteve , apo e Shqipërisë Etnike. Rryma e dytë e mbajti dhe mban si bosht mendimin feudal e provincial se duhet bashkëpunuar me çdo kënd e duhet bërë urë e vasal i cilitdo, vetëm që në atë feud apo krahinë të jem unë zot."(f. 201)

Sipas këtyre pikëmpajeve analizohet dhe i jepet zgjidhje edhe kolaboracionizmit një dukuri mbarë botërore, por në Ballkan dhe, veçanërisht në Shqipëri, ka veçoritë e veta. Baza filozofike e rrymës së parë është interesi kombëtar. Ky interes i detyroi nacionalistët dhe ithtarët e Shqipërisë Etnike të bashkëpunonin me gjermanin. Qëllimi ishte të përfitonin nga ndihma e të vetmit vend të madh që i përkrahte për realizimin e idealit kombëtar. Për interesa kombëtare edhe shtete e kombe më të mëdha se Shqipëria dhe shqiptarët jo thjesht janë mbështetur, por edhe janë rreshtuar në luftë përkrah Gjermanisë. Një prej këtyre vendeve ka qenë Rumania. Por atë askush nuk e dënoi përse u radhit përkrah gjermanëve dhe italianëve në Luftën e Dytë Botërore. Një studiues rumun i çështjes së kolaboracionizmit, për t\iu përgjigjur atyre që ngrinin ndonjë akuzë mbi ata rumunë që mbajtën anën e Gjermanisë dhe u radhitën përkrah saj, ka shkruar:

"Në ngjarjet e Europës, në vitin 1940, aleatët dhe miqtë na braktisën tërësisht, duke i lejuar kështu fqinjët e pandershëm që të na zhvatin e të na zhveshin. Në përgjigje të britmave tona, asnjeri nga aleatët tanë të mëdhenj të asaj kohe, nuk mori përsipër të na sigurojë kufijtë, ashtu të copëtuar siç ishin. Kështu ne na hodhën në krahët e gjermanëve, nga halli që të mos binim pre e Rusisë, e cila na kërcënonte dhe na fyente çdo ditë. Gjermania na mbeti i vetmi vend i botës e cila, me kërkesën tonë, pranoi që të na garantonte, në ato ditë tragjike, ekzistencën e kombit tonë." (Nicola Bacui: "Si u tradhtua dhe u shit Europa e Lindjes", Tiranë 2007, f. 154)

Kështu ndodhi edhe në vendin tonë. Asnjë nga vendet e mëdha të Evropës nuk tha një fjalë kur Italia pushtoi Shqipërinë më 7 prill 1939. Me heshtjen që mbajtën, shtetet e mëdha aprovuan pushtimin e Shqipërisë.

Gjatë luftës aleatët ndihmuan komunistët që ishin të lidhur me Jugosllavinë dhe zbatonin urdhërat e saj. Kuptohet se në ato rrethana, për deri sa ishin nën urdhërat e Jugosllavisë, komunistët shqiptarë, edhe po të donin, nuk mund të bënin asgjë për Shqipërinë Etnike. Po ata nuk donin. Në një copë Shqipëri mund të bëhesh mbret i pakurorëzuar siç qe në të vërtetë Enver Hoxha e shokët e tij, kurse në një komb të bashkuar nuk mund ta bësh një gjë të tillë. Dritëro Agolli thotë: "Në tre milionë banorë bëhesh leht bajraktar dhe sundimtar feudal. Në shtatë milionë nuk bëhesh leht feudal sundimtar, pasi mendimi i përparuar është më i gjerë dhe më i madh. Pastaj janë pasuritë kombëtare të mëdha: minierat, bujqësia, industria. Po librat?Me një Shqipëri të plotë ka kulturë të plotë. Këmbimi i mendimeve do të jetë i gjerë. Fantazia e pasur. Shpirti nuk do të jetë i vockël" (D. Agolli: "Teshtimat e lirisë", Tiranë 1967, f. 610) Haxhi Lleshi dëshmon se Enver Hoxha jepte vazhdimisht porosi që të mos respektoheshin ato kufij që ishin vendosur gjatë Luftës së Dytë Botërore nga Italia dhe më vonë nga Gjermania, me një fjalë t\u liroheshin tokat shqiptare sllavëve, që të sundonin përjetësisht në to. Enver Hoxhës i mjaftonte Shqipëria Londineze për të sunduar më leht. Ja si shkruan Haxhi Lleshi:

" Enveri nisi të fliste për punën e veçantë që duhej bërë me popullsinë shqiptare në zonat që kishin qenë nën pushtimin e Jugosllavisë.

– Më mirë se ti e shokët e tu dhe me të tjerë që do të dërgojmë ne, askush nuk mund ta bëjë këtë punë, - më tha. – Fashistët thjesht për interesat e tyre, por edhe për demagogji tani kanë vendosur kufinj të tjerë. Ne nuk i njohim ata, sepse padrejtësitë e fuqive më 1913 nuk mund të ndreqen nga fashistët...Këtë duhet t\ua bëni të qartë njerëzve , që...të mos bien në kurthin e armiqve, që e përdorin kartën e Shqipërisë Etnike për të përçarë popujt."(H.Lleshi: "Vite, njerëz, ngjarje"). Si rezultat i kësaj politike në Dibrën e çliruar u ndez lufta civile midis forcave nacionaliste që mbanin pushtetin dhe kishin siguruar qetësinë dhe rendin dhe forcave partizane të komunistëve sllavomaqedonas dhe të komunistëve shqiptarë që luftonin për ta lënë Dibrën e qytete të tjera të Shqipërisë Etnike në duar të Jugosllavëve. Ka qenë një luftë shumë e egër, ku u derdh shumë gjak shqiptarësh. Myrteza Bajraktari i jep me hollësi betejat e zhvilluara në Dibër. Autori thotë se ideali ynë kombëtar është i papërmbushur edhe sot. Rasti për ta përmbushur ka ardhur në krye të disa dhjetëvjeçarëve. Shpërbërja e Jugosllavisë e krijoi sërish këtë shans. Por shqiptarët prapë u vonuan. Shqiptarët nuk patën ndonjë projekt kombëtar për të përfituar nga kjo krizë, as në shtetin amë, as në Kosovë dhe as në Maqedoninë Lindore.

Në Shqipëri nuk është e udhës ta përdorësh fjalën nacionalizëm, se ta marrin sikur je kundër integrimit të vendit në Bashkimin Evropian. Por ky lloj të menduari nuk mban parasysh të vërtetën se "Cilësia e Evropës është afirmimi i idesë kombëtare dhe jo shuarja e idesë kombëtare" (R. Xhunga: "12 porosi të Arbën Xhaferit", f. 51, 2012) Kurse Kadare shkruan: "... në krejt Gadishullin e Ballkanit, në kohën kur shumica e vendeve u përfshin në valët e egra nacionaliste, tek shqiptarët ndodhi e kundërta. Kjo është një rënie në kurth nga më të pakuptueshmet e një kombi."(Kadare: "Kombi shqiptare në prag të mijëvjeçarit të tretë", Tiranë 1998, f. 24)

Libri . "Një vështrim tjetër i historisë" është mbështetur mbi një literaturë të gjerë. Po garancia e tij më e madhe shkencore qëndron në faktin që është shkruar nga një njeri i ndershëm, me integritet të fortë moral, me burrërinë e shqiptarëve të hershëm, tek të cilët nderi e dinjiteti dhe dashuria për atdhe peshojnë shumë.

Botim i ri



Bashkim Rama
BALLKANI PAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT – VETËVENDOSJA "VERSUS" TËRËSIA TERRITORIALE

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-03-7
Çmimi: 1250 lekë

Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

**Bisedë me Eshref Çutran,
fizamornicistin nga Dibra e Madhe**

Kënga *na gëzonte*



Nga REXHEP TORTE

Fizarmonicistin 80 vjeçar Eshref Çutra, udhëheqësin e orkestrës së SHKA "Liman Kaba", virtuozin e muzikës dhe promotorin shumëvjeçar të aktiviteteve kulturore dibrane në kohët kur një këngë kushtonte survejim dhe maltrajtime policore nga më të ndryshmet, e takuam këtyre ditëve dhe zhvilluam një bisedë të rastësishme, por shumë interesante.

Si gjithnjë entuziast dhe i gatshëm për të biseduar, pyetjes sonë për fillimet dhe aktivitetet me muzikë, iu përgjigj: "Pas çlirimit nga nazifashizmi, të rinjtë entuziastë dibranë themeluan grupin muzikor që shëtiste dhe shfaqte program nëpër shumë qytete të Maqedonisë, që në vitin 1946 u pagëzua me emrin "Liman Kaba". Në fizarmonikë asokohe luante vëllai im më i madh, Irfani. Ai ishte shumë i apasionuar pas këtij instrumenti dhe nuk lejonte askwnd t'ia prekte. Atyre viteve organizonim valwlzime dhe koncerte. Unë shfrytëzoja çdo moment dhe merrja fizarmonikën dhe me Eshref Çutrën, fizarmonicistin nga Dibra e Madhe ushtroheshim vjedhurazi. Entuziazmi dhe talenti më ndihmuan që këtë instrument ta mësoj shpejt, kështu që u bëra anëtar i rregullt i grupit muzikor. Ushtronim dhe punonim shumë dhe ishim tepër të popullarizuar".

KONCERTE NË MAQEDONI, KOSOVË DHE SHQIPËRI

Lidhur me pjesëmarrjen me koncerte në trojet shqiptare e më gjerë, Eshref Çutra, tregon:

"Në vitin 1950 morëm pjesë në Festivalin e Parë Shqiptar Muzikor që u organizua në Tetovë nën patronazhin e ministrit dibran Xhafer Kodra. Në këtë festival grupi ynë muzikor zuri vendin e parë.

Me SHKA "Liman Kaba" në vitin 1951 shkuam në turne në Kosovë me këngëtarët tanë Bukurie Shemsiu, Bukurie Kasapi dhe Bukurie Mezelxhiu etj., dhe vallen dyshe dibrane luajtur nga Refik Papraniku dhe Abedin Kolari.

Vajtja e ime dhe e disa anëtarëve të shoqërisë në vitin 1953 për të kryer shërbimin ushtarak e pezulloi aktivitetin e shoqërisë muzikore për gati 13 vite.

Me nismë të Lidhjes së Studentëve Shqiptarë në Dibër, të udhëhequr nga studenti Rexhep Torte, në vitin 1966, kjo shoqëri u riaktivizua dhe u rimëkëmb me grupin orkestral, grupin këngëtar të meshkujve dhe me solistët Violeta (Marku) Turkeshi, Sulejman Borova, Avni Papraniku, Bashkim Paçuku, Haxhi Maqellara, Luan Paçuku, Bukurije Sela, Shqipe Kasapi, Zuliha Sela etj. Me këtë filluan sërish pjesëmarrjet tona me program muzikor në Manastir, Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Shkup, Kumanovë, Ditët e Ilindenit në Krushevë etj., dhe nëpërmjet Qendrës për Kulturë të Kosovës edhe në Festivalin "Kosovarja këndon", ku vlerësoheshim ndër më të mirët. Asokohe në vitet 1969-1970 i shfaqnim koncertet tona në Prishtinë, Kaçanik, Ferizaj, Gjilan, Bujanoc, Preshevë, Gllogoc, Prizren, Suharekë, Pejë, Gjakovë. Ishin kohë kur sistemi i atëhershëm komunist mezi e pranonte këngën tonë dhe nuk e shihte me sy të mirë. Më kujtohet rasti në Suharekë, kur autoritetet e atjeshme nuk deshin ta hapin sallën e koncerteve dhe ne vendosëm koncertin ta mbajmë nën qiell të hapur në oborrin e një shkolle. Megjithatë populli u organizua dhe e hapi sallën. Gjithandej na bëhej pritje madhështore. Më kujtohet që në amfiteatrin e mbushur përplot në Prishtinë funksionari i atëhershëm Rexhai Surroi, na uroi dhe përshëndeti publikisht.

Vizita në Shqipëri në vitin 1972 ishte kulminacioni i sukseseve tona. Ishim ftuar të jemi mysafirë të Teatrit "Aleksandër Moisiu" në Durrës dhe pastaj vazhduam turneun tonë në Kavajë, Berat, Gjirokastër, Tiranë, Laç, Burrel dhe Peshkopi. Trupa jonë muzikore hyri në vendkalimin Qafë Thanë dhe doli në vendkalimin Bllatë në Dibër. Në përbërje të programit tonë kishim edhe grupin argëtues të të rinjve Ejup dhe Zini Borova, dhe Zeni Maqellara.

Orkestrina jonë përbëhej Eshref Çutra - fizarmonikë, Sabri Meçe-klarinet, Atli Qormemeti, Atli Piperku, Munir Xhelili - kitarë, Zini dhe Abdulla Tabaku, Muhamet Papraniku, Ylber Daci dhe Petrit Dibra - mandolinë dhe Zirako Demiri - dajre, ndërsa udhëheqës artistik ishte Musa Piperku.

Atëherë ne ishim ambasadorë të muzikës sonë dhe ndjeheshim tepër të entuziazmuar. Me të kthyer nga kjo turne u ndryshua udhëheqja dhe komiteti i partisë komuniste të qytetit filloi të na imponojë me forcë, që ne në programin tonë, të fusim sa më shumë këngë maqedonase, gjë që ne nuk e pranonim dhe nuk aktivizoheshim".

KËNGA E TËRMETIT

Në pyetjen tonë lidhur me guximin e tij që pas disa muajve të humbjes së djalit të tij në tërmet, e rroku sërish fizarmonikën, Eshref Çutra, vazhdoi rëfimin e tij:

"Në vitin 1967 Dibrën e goditi një tërmet i fuqishëm dhe shkatërrues. Në mesin e viktimave ishte dhe djali im tetë vjeç e gjysmë, Agimi. Kjo humbje e djalit më preku thellë në zemër. Pas disa muajve na u dha rasti që me SHKA "Liman Kaba" të shkojnë në një turne nëpër Kosovë dhe të marrim pjesë edhe në manifestimin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në Gjakovë, në maj të vitit 1968. Për këto aktivitete nevojitej përgatitje serioze e programit tonë. Asnjë nga shokët nuk guxonte të më thoshte që sërish ta kap fizarmonikën. Isha i vetëdijshëm se pa mua shoqëria nuk mund ta realizonte këtë turne.

> "Sot në mesin tonë ka shumë të rinj të talentuar për muzikë, ndaj kisha porositur që të rinjtë dibranë kurrë të mos i ndahen këngës dhe valles, e para për ta gjallëruar qytetin në lëmin e kulturës, dhe e dyta, që tradita e kulturës dibrane të mos humbë kurrë".

Kjo gjë më mundoi netë të tëra dhe më në fund, e mora guximin dhe i ftova shokët t'i vazhdojmë provat për koncertet që do t'i shfaqnim. Më kujtohet që kur e vura fizarmonikën krahëve mu rrënqeth çdo pjesë e trupit, ndërsa anëtarëve të shoqërisë iu mbushën sytë me lot për këtë vendosmëri timen që me këngë ta mposhtim dhimbjen. Vargjet e këngës së tërmetit të kompozuar nga Musa Piperku *"Pse vajton moj Dibra ime / Ç'të paska ndodhur ty sot kështu / Prej lotve të tu rrjedhin hidhërime / Prej tërmetit që ke pësu / Ç'kanë këto vajza që po vajtojnë / Në këtë ditë feste në agim/ Vjollcën, Agimin, Shuipin kërkojnë / Ndër gërmadha të vendit tim"*, nuk lënë pa përlotur asnjë nga publiku kudo që dhamë koncerte.

Turneu nëpër qytetet e Kosovës pati jehonë të madhe dhe me programin tonë në vitin 1968 morëm pjesë edhe në manifestimin e 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut në Gjakovë.

Në vitin 1969 vizituam edhe Beogradin ku dhanë koncerte për punëtorët shqiptarë që jetonin dhe punonin në Beograd. Atje emisioni në gjuhën shqipe "Pasqyra televizive" incizoi një program të pasur, të cilin e emetoi për shikuesit shqiptarë, gjithashtu programin e shoqërisë sonë e incizuan edhe TV-Prishtina dhe TV-Shkupi, ndërsa pati edhe shumë shkrime në shtypin ditor në gjuhën shqipe.

SHKA "Liman Kaba" në vitin 1977 mori pjesë edhe në Festivalin Ndërkombëtar të Folklorit në Zagreb, ku zuri vendin e parë, ndërsa grupi i instrumentistëve popullorë mori pjesë në Gjermani, Francë e Belgjikë".

MIRËNJOHJE EDHE PËRNDJEKJE

Duke folur për përshtypjet e mira të jetës së tij të gjatë në muzikë, Eshref Çutra nuk nguroi të tregojë:

"Në shenjë mirënjohje për punën dhe sakrificën time në SHKA "Liman Kaba", përfaqësues të redaksisë "Rilindja" nga Prishtina në vitin 1972 erdhën në Dibër dhe më dhuruan komplete librash të autorëve shqiptarë që i ruaj me dashurinë më të madhe.

Aktivitetet tona muzikore na mundësuan që të krijojmë marrëdhënie shumë të mira me SHKA "Besa" nga Gostivari, "Xheladin Zeqiri" nga Tetova, "Hajdar Dushi" nga Gjakova dhe shumë shoqëri tjera".

Ndërsa për rastin e tij të hidhur që e pësoi në karierën e tij si muzikant, Eshref Çutra, tregon:

"Sa herë që shokët tanë kishin ceremoni dasmash, ne si shoqëri venim dhe hijeshonim atmosferën me këngë e valle. Në gusht të vitit 1975, ishim ftuar në synetin e djalit të një shokut tonë. Darka kaloi për mrekulli. Ndërkaq të nesërmen organet policore më burgosën me akuzë se gjoja në këtë dasmë kam kënduar këngën *"Moj parti të qofsha falë"*, gjë që nuk ishte aspak e vërtetë. Ne patëm kënduar shumë këngë, por këtë këngë jo. Me mbajtën një muaj në hetime dhe pastaj më liruan në mungesë provash.

Deklaratën e rrejshme në polici, se gjoja unë e paskam kënduar atë këngë problematike, e kishin dhënë dy burra që sot kanë ndërruar jetë dhe arsimtari poet, i cili aso kohe pretendonte të zinte vendin e drejtorit të shkollës fillore, gjë që nuk arriti, ndërsa sot shitet si patriot i madh dhe pa farë turpi shkruan vjersha patriotike".

Shuarja e SHKA "Liman Kaba"

Në pyetjen tonë pse u shua SHKA "Liman Kaba", Eshref Çutra me keqardhje, shprehet se:

"Në vitin 1976 ndërroi jetë njëri nga këngëtarët e grupit dhe shoku ynë i dashur Din Duraku, pastaj u ndryshua edhe udhëheqja e shoqërisë. Këmbëngulej dhe na imponohej që në programin tonë muzikor të fusnim sa më shumë edhe këngë maqedonase. Në nuk ishim të gatshëm të bëjmë një gjë të tillë dhe e ndërpremë aktivitetin tonë.

Nga ish SHKA "Liman Kaba" tani kemi themeluar Grupin e këngëve qytetare "Penestia" dhe me programin tonë marrim pjesë rregullisht në akademitë dhe manifestimet përkatëse".

Pyetjes sonë, se cili do të ishte mesazhi i juaj për të rinjtë e talentuar dibranë në lëmin e muzikës, Eshref Çutra, u përgjigj:

"Sot në mesin tonë ka shumë të rinj të talentuar për muzikë, ndaj kisha porositur që të rinjtë dibranë kurrë të mos i ndahen këngës dhe valles, e para për ta gjallëruar qytetin në lëmin e kulturës, dhe e dyta, që tradita e kulturës dibrane të mos humbë kurrë.

Përkundër këtij aktiviteti të dendur kulturor, asnjë nga pushtetarët vendorë gjer më sot nuk është kujtuar që Eshref Çutrës, këtij kolosi muzikor, t'i japë një mirënjohje, me çka do ta nderonin edhe veten,

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

kulturë



Orkestrina e vajzave te Bruçit v.1970

Sania, Dylberja, Mexhitja, Xhevahirja, Mira, Drita, Nafija, Vera, Beharja, Manja, Valentina, Nadirja, etj., mbaruan shkollën e mesme dhe u kthyen në krye të grupeve të tyre, me "amanetin" e mësuesit të tyre për ta mbajtur ndezur "prushin në mangall"

Një fenomen artistik i trashëgimisë që duhet mbajtur ndezur

***Nga* ESAT RUKA**

Tradita muzikore folklorike, që në zanafillën e veprimtarive lokale e kombëtare, në fillimin e gjysmës së dytë të shekullit XX, ka dëshmuar për vlera të spikatura dhe përpjekje serioze institucionale, për të arritur standarde gjithnjë e më të reja në punën me talentet e rinj. Këto standarde janë mirëpritur jo vetëm nga artdashësit, por edhe nga mendimi i specializuar i kohës.

Edhe pse dokumentimi i tyre len mjaft për të dëshiruar, në memorien e ndonjë prej protagonistëve të lëvizjes folklorike apo drejtuesve të tyre ende na ofrohet si ndonjë gatim tradicional që tashmë preferohet në shumë restorante.

Nga historiku, që kemi mundur të gjurmojmë, po shkëpusim disa prej "thërrmijave" vezulluese nga treva e Matit që ndoqën me guxim rrjedhën dallgëzuese në skenat artistike lokale e kombëtare. Që nga viti 1947 e më pas 1953, 1957,... përfaqësia folklorike e Matit do të përbëhej nga valltarë, rapsodë dhe orkestrinën me instrumente. Në të gjitha përballjet artistike ka patur vlerësime me çmime e ngazëllime, por ka patur edhe raste që është ndërprerë entuziazmi dhe hareja artistike edhe për shkak humbje jete në skenë. Kështu ka ndodhur me muziktarin virtuoz në ciganë Lit Haxhiu nga Kurdaria, i cili ishte përzgjedhur nga komisioni i profesionistëve të kohës bashkë me shokët e tij muziktarë për në Festivalin Ndërkombëtar të të rinjve që do mbahej në Moskë në vitin 1957.

Një kapitull më vete përbën edhe roli i kurbetqarëve matjanë që qarkullonin në Stamboll, Siri e Egjipt edhe elementë të kulturës e traditës, përveç të ardhurave financiare që siguronin. Mbahen mend shumë instrumentistë e valltarë që çudisnin mjedisin me virtuozitetin e tyre edhe në kohën kur thuhej se *"diamanti nuk shkëlqen në gishtin e fukarait"*. Met Rrahman Hysa i Rukajve në vitet '30 të shekullit XX, "shembi pazarin" për ta ndjekur teksa i binte çiftelisë. "Çou, ashik, çou se bllokove mejhanen e Demnerit", i luteshin bashkëmoshatarët, pasi ai përhumbej në muzën e magjisë së artit të lojës në këtë instrument. Ky virtuoz, "i detyroi" ustallarët e mejhanes të linin vendin e punës, sepse pronari i ofroi bakshish të majmë për ta patur mik special në ditët e pazarit. Të tillë ishin edhe Lam Kryekurti, Shahin Doçi, Sali Dika në çifteli, Lit Haxhiu e Can Ferra në ciganë, Dali Fasliu e Sali Kurti në Lauri, Daut Bajrami e Enver Kurti në lodër, Xhemal Lela e Ymer Kurti në kavall e deri tek maja e instrumentimit virtuoz me Ymer Nelin "artist i Merituar" dhe i biri Behari.

Pse i përmenda këto !?

Sepse me talentin dhe përkushtimin e tyre në rrugëtimin e gjatë artistik, disa gjenerata të folklorit në Mat janë shquar duke lënë një pasuri të vyer jo vetëm arkivore. Ajo thërret për vlerësim e përkujdesje për ti shërbyer me kurajo e vendosmëri blerimit të vazhdimësisë së kësaj tradite shumë domethënëse.

Është e pamundur që të përmbledhësh në një shkrim historinë e këtij kontributi, shtratin në të cilin mbahet aq ngrohtë, dinamikën e rrezatimin e tyre, risitë e stilit të tingëllimit, numrin e madh të artistëve interpretues që kanë kaluar nëpër këtë "shkollë" të kualifikimit instrumental.

Një tjetër arsye më ngacmoi për të sjellë në kujtesën e kohës një ***fenomen*** të artit muzikor tradicional. Teksa kam ngjitur shkallët e menaxhimit, duke ushqyer skenat e duke u ushqyer nga ky "bunar" i pastër e i freskët popullor, ngarkohesh apo mbushesh me disa emocione frymëzuese, që patjetër kërkon t'i shkarkosh diku si një "dhuratë" për ndonjë të "panginjur", që pret edhe për "bulëza", për të guxuar e për të lënë gjurmë në rrugën e bukur e të mundimshme të artit.

Sigurisht çdo fenomen krijues xixëllon së pari në ndonjë "skutë", por falë forcës së tij të brendshme e mjedisit favorizues e shton flakën, duke u kthyer në një zjarr të ndritshëm nga i cili marrin ngrohtësi e energji gjenerata të reja. Kështu lindi ***fenomeni*** i instrumentisteve vajza në zonën e *Prellit* të trevës së Matit.

Ishte mësuesi *Ferit Këputa* ai që kishte ndezur mangallin me prushin që bulëronte prej kohësh në atë zonë shumë artdashëse. Ai kishte mundur të thithte amatorë gra e burra për të dhënë sinjalin e parë të një ansambli të ardhshëm që në fillim të viteve '50 të shekullit XX. Të parat pjesëmarrëse vajza qenë: Rabie A. Këputa, Dushe H. Këputa, Bedrije V. Osmani nga Laçi, File D. Neziri nga Bruçi, Selvi S. Hysa nga Rukaj etj.

Ky mësues pasionant u bë i besueshëm nga banorët në sipërmarrjet e veta të veprimtarive jo vetëm shoqërore, por edhe prodhuese. Grupi folklorik i shkollës së Bruçit shumë shpejt u njoh dhe nderohej brenda dhe jashtë zonës në ato vite duke e bërë lëvizjen folklorike pjesë të prioriteteve të organeve të pushtetit lokal dhe të institucioneve. Puna e tij dhe e kolegëve më pas do të institucionalizohej duke vijuar me rrethet artistike të valleve, këngëve e intrumentave folklorikë.

Në grupin prej mbi 50 instrumentistësh në vitin 1968, 20% ishin vajza. Feriti nuk shquhej si këngëtarë, valltarë apo instrumentist. Por ky edukator e vlerësonte forcën e trashëgimisë shpirtërore si një mjet të rëndësishëm emancipimi iluminues. Vlera e tij drejtuese u bë e prekshme nga aftësia e tij për gjetjen e përshtatjen e repertorit të grupit, në punën sistematike e me program, në sjelljen korrekte e të kujdesshme me talentet e reja, në mënyrën e komunikimit, këmbënguljen dhe disiplinën duke fituar besueshmërinë e artistëve të vegjël e të rinj. Por ajo që duhet mësuar e theksuar është se u thyen disa tabu të kohës se *skena nuk qenka vetëm për meshkuj, apo se instrumentat muzikorë të zonës mund të mësohen edhe nga vajzat e reja*. Dalja në skenë e vajzave me çifteli bashkë me djemtë në shkollën e Bruçit, pjesëmarrja në konkurrimet lokale e kombëtare, përkrahja e përgjithësimi i shembullit të tyre, shtroi trasenë e rrugës së mundimshme, por të bukur e krenare të shtimit të një numri të konsiderueshëm vajzash në orkestrinat popullore në shkallë rrethi. Tashmë ajo shkëndijë e shtriu rrezatimin e saj edhe në Zenisht e Derjan, në Cërujë e Gërman, në Baz e Fullqet etj. Nuk ishte më e rrallë që në orkestrinat e shumta të shkollave e të shtëpive të kulturës të kishte edhe vajza. Ky fenomen nuk ishte thjeshtë një dekor emancipues, por intonim i plotë e i saktë bashkëtingëllues në atë formacion muzikor. Hap pas hapi u arrit të kishte orkestrinë vetëm me vajza, madje duke shoqëruar veten në këngë. Kështu, nga Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastër-1968 e pas në orkestrinën prestigjioze e me famë me intrumenta popullorë të Matit do të luajnë në çifteli edhe femra. Nga skena madhërishme e Kalasë së Gjirokastrës në vitin 1973, rapsodja Vitore Gjeçi e zonës së Rrazës do të shoqëronte veten në rapsodinë "Jam një cucë e re bazjane", më pas këngëtarja e talentuar Drita Suçi do të këndonte me çifteli rapsodinë kushtuar qëndresës së matjanëve më 1943 në asgjësimin e autokolonës fashiste në Vig të Shëlliut. Kjo traditë vazhdon e thellohet deri në paraqitjen në Kalanë e Argjirosë në vitin 1983 të një grupi vajzash me çifteli në shoqërimin e këngës "Pa liri nuk rron shqiponja" kushtuar Lidhjes shqiptare të Prizrenit, kënduar nga Hamide Merra.


Amatorizmi solli edukimin e prirjeve dhe mprehjen e talentit duke përgatitur kontigjentin e ardhshëm të kuadrove të arsimit e të kulturës. *Sania, Dylberja, Mexhitja, Xhevahirja, Mira, Drita, Nafija, Vera, Beharja, Manja, Valentina, Nadirja,* etj mbaruan shkollën e mesme dhe u kthyen në krye të grupeve të tyre, me "amanetin" e mësuesit të tyre për ta mbajtur ndezur "prushin në mangall"

Sot ka dy pamje: Instruktori Y. Neli "Mjeshtër i Madh" vazhdon me sukses të mbjellë fidanët e përgatitjes së instrumentistëve të rinj. Teksa ndjekim pjesëmarrjen dhe prurjet nëpër festivale të instrumentistëve të vegjël, dallon me kënaqësi se performanca e orkestrinës së të vegjëlve të Burrelit inkuadruar në QK të Fëmijëve, dekada me radhë është një shembull që rrezaton në shkallë kombëtare. Në formacionin e tij që drejton dallon me kënaqësi vajza me lauri në skenë, një befasi e këndshme kjo.

Ndërsa tradita në zona ku ende japin mësim në shkolla instrumentistet e lartpërmendura apo më të reja është arratisur. Si duket janë pajtuar me zbehjen drejt zhdukjes së asaj tradite unikale edhe si rezultat i heqjes së normimit të punës me rrethet artistike, pa lere më me grupet amatore.

Bota e internetit me avantazhet e saj bën mrekullira në eksplorimin e gjithësisë, por traditën e ruajtjes dhe zhvillimit e promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore të gjeneratave nuk e gjejmë dot sado të klikojmë me mouse. Trashëgimia e përcjellur dhe e dhuruar me bujari nga gjeneratat është dhe do të mbetet pjesë origjinale e qytetërimit të hershëm dhe bashkëkohorë. Ajo është kontribut në bashkësinë evropiane. Tashmë diamanti shkëlqen në gishtin e "fukarait". "Diamantet" na rrethojnë çdo ditë, po "fukarenjtë" ku janë...?

Botim i ri



YMER A. KETA
HERONJTË E NËNTOKËS
Minatorët dhe gjeologët që u flijuan në minierat e kromit Bulqizë dhe Batër


Botimet "Emal"
ISBN 978-9928-04-147-0
Çmimi: 1000 lekë/10 Euro

...Në ato ditë të vështira, kur pushka me gjalmë kërciste në male për çlirimin e vatanit e gjaku i derdhur mbushte lumenj, nuk pati më shumë viktima sesa në Minierat e Kromit Bulqizë e Batër, apo edhe ato të Bakrit e të qymyrit pas çlirimit, lubi e pangopur me jetë njerëzish, varrosën minatorë në galeritë e nëntokës, por dhe në sektorë të mbitokës jo pak djem nënash nga zonat e Dibrës, të Matit, të Mirditës dhe nga e gjithë Shqipëria...

(Fragment nga libri)

Mendime për librin e Abdurahim Ashikut
"Rrëfimet e Komshiut"

Të jetosh mes **magjisë** së **shkronjës**



Nga **NAMIK SELMANI**

Janë disa shkronjëbërës edhe në letrat shqipe që i rrinë në dekada në roje të shkronjë shqipe që shkojnë me punën e tyre gati deri në kufijtë e pabesueshmërisë. Ata bëhen robër të një dashurie që lexuesit mund ta shohin në të gjitha qelizat falë këtij pasioni që i kalon kufijtë e të zakonshmes.

Kur bisedon me Abdurahim Ashikun dhe sheh nga afër tërë atë aktivitet të tij në disa fusha e beson se je përpara një njeriu me një pasion atdhetar plot përkushtim. Dikur në rininë time të parë i lexoja me shumë interes reportazhet e tij për Dibrën. Ishte "profesori" i parë i gazetarisë dibrane që na e bëri edhe më të dashur Dibrën me zakonet e saj të bukura, me mençurinë e saj në breza, me trimërinë e saj e sidomos më e atë punëdashje që rrallë mund ta gjesh në krahina të tjera të vendit.

Kanë kaluar gati 60 vjet kur ai ka bërë shkrimin e tij të parë në gazetari. E tani në këtë prag ditëlindjeje kur ai po përgatitet që të festojë 72 vjet të jetës së tij (11maj) ka pasur me qindra pse jo dhe mijëra shkrime në tërë këto dekada. Po Profesor Abdurahimi nëse do ta quaja kështu me shumë respekt për punën e tij nuk i përket atyre gazetarëve të paraviteve ' 90 që për shumë arsye vetëm heshtën në vitet e demokracisë. Të paaftë për t'u përballuar me këtë gazetari më të hapur, më të lirë por edhe më profesionale nëse ajo që ishte bërë më parë në bazë të disa skemave standarde. E pikërisht në këto vite, e sidomos kur ai mori statusin e emigrantit, nisi të botojë gati çdo vit nga një libër voluminoz aq sa mund të thuash se zëri i emigrantëve shqiptarë në Greqi, nuk mund të ishte i plotë emocionues po të mos ishin veprat e tij në prozë si "Njerëz që i dua", "Rilindësit e kohës sonë", "Shkolla shqiptare e Athinës", "Po Dibrës! Jo Skavicës!" , "Rrëfimet e komshiut".

Kemi në duar për të bërë sa më mirë portretin e tij të krijuesit librin shumë interesant "Rrëfimet e komshiut" që ka si temë emigracionin. Për fatin tonë të keq në Shqipëri ende nuk ka një Muze Emigracioni si atë që shohim në New York që flet qoftë edhe për fillimet e para të emigracionit në SHBA që në fillim të shekullit të kaluar e më tej.

Edhe këtu ata që mund t'ia thuash këtë ide të ngrenë supet për paratë që mungojnë, për idetë. Të gjithë thuhen veç muze nuk ka. E them këtë se po qe se e lexon me laps në dorë këtë libër sheh sa e sa stenda shkronjore që mund të bëjnë disa muze jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe të ndryshme.

Jo më kot në përkushtimin e librit të tij në fillim të librit pas familjes vë në një nderim të madh gjithë miqtë e emigracionit që janë pjesë e këtyre tregimeve. Janë njerëzit që ai i do kaq shumë e që nuk mund të bëjë pa ta as në arën e bardhë të shkronjës aq në rrugët e Athinës e më tej në qytetet e Greqisë ku sheh me mijëra e mijëra djem e vajza shqiptare, sheh familje, sheh artistë, sportistë, shkrimtarë, gazetarë, etj.

Duke lexuar me një frymë këtë libër, m'u kujtua një ngjarje që lidhet me disa vite më parë. Para dy vitesh miku ynë i përbashkët Profesor Murat Gecaj na kishte shpërndarë një shkrimin tim që fliste për një gjyq që ishte bërë prej disa vitesh në Athinë në mbrojtje të gjuhës shqipe të nxënësve shqiptarë që donin të mësonin shqip. Gjykata e Athinës kishte dënuar dy mësuese për këtë gjë. Opinioni i fuqishëm demokratik duke përfshirë edhe këtë gazetar veteran bëri që ato të merrnin pafajësinë. E pra, tematika e gjerë e dhimbshme e kurbetit na vjen në çdo faqe të këtij libri.

Një kontribut i jashtëzakonshëm është kujtimi i ndritur i arvanitasit të shquar Arsitidh Kola që ai e ka pasur mik të ngushtë për shumë vite. Në datën 7 korrik të këtij viti është edhe ditëlindja e të paharruarit Arisitidh Kola për të cilin në shenjë nderimi dhe kujtimi ai ka menduar të organizojë edhe një veprimtari përkujtimore në Thiva, ku ka lindur e ka jetuar për vite të tëra Arisitidh Kola.

Ka një rrëfim të jashtëzakonshëm Abduarahim Ashiku në këtë libër. Ka një dialog shumë të zhdërvjellët që tregon përvojën e madhe të shkrimit të tij, por edhe një qëmtim shumë të mirë të leksikut të gjuhës shqipe. Është një kronikan shumë profesionist. Në pamje të parë sikur kemi vetëm tregime, por nuk është vështirë që të kuptosh se sa simbolikë ka secili tregim. Rrëfimi i tij është tepër objektiv natyrisht dhe kurajoz edhe dashamirës.

Redaktorja e librit Miranda Goleci shkruan për stilin e tij: **Libri "Rrëfimet e Komshiut" janë rrëfime, që "të thuash e lexova është pak, por e përjetova, qava, u gëzova, u hidhërova. Të gjitha ndjenjat përziheshin gjatë leximit të tij. E të tilla libra që të bëjnë të futesh thellë, vetëm një shkrimtar me një shpirt të madh dhe i talentuar si Duro mund ta bëjë".**

Ndryshe nga librat e tjerë të kurbetit në këtë libër Abdurahimi nuk tregon vetëm fillimet e tij atë të emigracionit në këtë vend, por jep atë në një fazë më aktuale. Në një fazë kur emigranti shqiptar ka edhe pak më shumë personalitet

Abdurahim Ashiku, me serinë e librave "Njerëz që i dua", tashmë është midis emigrantëve shqiptarë në të gjithë kontinentet: në Evropë, Amerikë, Australi.

aq sa edhe një grek i quajtur Kosta dhe që është pronari grek i "Akropolit", lokal në ishullin e Santorinit sipas autorit është i detyruar që të thotë me shumë sinqeritet: ***"Shqiptarët janë të mrekullueshëm. Bashkëpunoj me shqiptarët. Janë të mrekullueshëm dhe jam shumë i gëzuar që bashkëpunoj me ata prej shumë vitesh. Nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë problem. Janë shumë mirë në punë dhe, mbi të gjitha, me karakter shumë të mirë. Për mua kjo ka rëndësi. Nuk kam se çfarë të them më shumë. Të gjithë janë shumë të mirë."***

Është shumë interesante se me këtë libër ai bën një lloj URE mes shumë qyteteve dhe krahinave shqiptare me Greqinë. Kështu shohim Librazhdin, Kukësin, Dibrën, Fierin etj. Rrëfimet ende pse janë për raste konkrete janë shkruar me shumë dashuri, me shumë krenari.

Një karakter shqiptar i befason njerëzit e pasur perëndimorë që shkojnë në hotel për të ngrënë çuditen me punën e tij. Tregimi "Plumb pambuku" ka shumë lirizëm dhe një intrigë të rrallë, nga ato që autori i ka fjetur në të këto vite të fundit për të ndërtuar tharmin e librit të tij. Kamerieri e ndëshkon në mënyrë të çuditshme pronarin që për shumë kohë në mënyrë të padrejtë ia ka mohuar hakun e tij të punës . E ai mbledh shokët u kërkon që të porosisin aq sa pronari i detyronte dhe nuk ia paguan paratë. Një zgjidhje që e detyroi pronarin që të kërkonte falje për at që kishte bërë.

Natyrisht veç tregimeve për jetën e gjallë të emigrantëve për zgjimin e jetës së tyre, për atë dritë që kanë zemrat e tyre na jepet edhe një shans shumë i rëndësishëm i jetës së këtij mërgimi, ajo e grave në kurbet. Po edhe ajo e sakrificës që bëjnë shqiptarët për të mësuar shqiponjën. Jo më kot e në mënyrë shumë simbolike ai e hap librin me një parathënie shumë të veçantë që nuk e shohin në asnjë libër të këtij lloji. Është një letër e disa fëmijëve shqiptarë të fshatit grek të Sarantit në Thiva të Greqisë që kanë dalë edhe nën një foto të përbashkët me Xhaxhi Duron që në këtë foto ndjen një lumturi të pa treguar në jetën e tij. Të gjithë fëmijët janë të gëzuar e në duar mbajnë libra të Gjuhës Shqipe.

"Më tepër se kopertina e një libri, shkruan mësuesi Eqerem Elezi, autor kopertinës, kjo skicë e thjeshtë është një bashkëpunim me fëmijët e shkollës "5 Maji" të fshatit grek të Sarantit. Po, po nga duart e tyre është bërë ngjyroja . Duken gërvishtjet e lapsave, duket dora fëminore në bashkimin e shkronjave, duket dashuria dhe dëshira e Dhimitrës e Aldos, e Megit, e grekut të vogël Panajotis, e Aspasisë, Erit, Frrokut, Kledit.. Donin të gjithë të vinin diçka në këtë kopertinë se edhe xhaxhi Duro i do dhe i ka ndihmuar kaq shumë. Saranti, Thiva, 5 Maj 2011

Në mënyrë indirekte shohim edhe ndihmesën e tij në fushën e fotografisë në të gjithë aktivitetet që ka ndjekur në këto vite edhe pse i duhet që edhe në këtë moshë të punojë për të siguruar udhëtimin e përditshëm. Ende arkivi i tij i dorëshkrimeve ka libra për të botuar

Nga ana tjetër do të jepnim një vërejtje: Të vjen keq që libra të tillë nuk i gjen në raftet e librarive në qytete të tjera të Shqipërisë. Vlera të tilla letrare njohëse që fare mirë të jenë në bibliotekat e nxënësve, të politikanëve, të institucioneve arsimore, pse jo edhe të shkrimtarëve që shohin në të një rrëfim shumë elegant, me një pasuri shumë të madhe frazeologjike që është një shembull shumë i lavdërueshëm për mësuesit e letërsisë, për krijuesit e rinj, etj.

Ndonëse nuk zënë shumë vend janë shumë interesante edhe dy tregime që flasin për atdheun, për miqtë e tij si shkrimtari Dritëro Agolli. Njeh shumë mirë etnografinë, njeh gjeografinë, njeh historinë e sidomos letërsinë.

Në urimin më të mirë që do të jepnim për këtë punë të lavdërueshme do të jetonim me padurim që të lexonim edhe libra të tjerë të këtij karakteri.

Pasthënie: Ndërsa kisha vënë pikën e fundit në meditimin tim për Abdurahim Ashikun dhe librat e tij një urim në facebook nga Përtejoqeanit, nga Detroiti i Miçiganit, nga ish nxënësi i tij në Shkollën e Mesme Bujqësore Peshkopi Gjovalin Lumaj më tërhoqi vëmendjen. Nuk mund ta lija pa e cituar...

"Profesor i nderuar!

Më kini dërguar 5 librat tuaj me postë nga Greqia.

Mbasi i kam lexuar dhe rilexuar shumë prej tregimeve sa të bukura po aq prekëse, ashtu si dikur kur kërkoje nga unë si nxënës të flas në mënyrë të përmbledhur për mësimin, ashtu edhe sot mund të jap "provimin" për ato që mësova nga librat tuaj.

Mesazhi i madh i ruajtjes së vlerave, mbijetesa, shpirti i lartë i sakrificës, përgjegjësia që të jep krenaria si Shqiptar, bëjnë të mundur edhe të pa mundurën, ashtu siç e kanë bërë shumë emigrantë në Greqi të cilët i gjeta aq bukur të portretizuar në librat tuaj.

Njëkohësisht qëndrimi burrëror ndaj së keqes, drejt për së drejti pa lajka dhe "lakime" është një tjetër vlerë e madhe e cila në shkrimet e sotme gjendet rrallë. Sot një shumicë autorësh fillojnë me UNË vazhdojnë me UNË, dhe mbyllen me UNË..! Kjo në librat tuaj është zëvendësuar me sakrificat dhe vlerat që kanë ATA dhe ATO.

Librat tuaj po bëjnë "xhiron" në rrethin e miqve të mi. Kur ata flasin fjalët më të mira për profesorin tim, unë ndjehem krenar dhe nga që e ruaj gjithnjë sensin e humorit u them:

"Mos e vlerësoni profesorin vetëm nga ato që ka shkruar. Për ta vlerësuar më mirë profesorin, shikoni nxënësin"

Nderime e përqafime,

Mirënjohje dhe falënderime. Edhe sot vazhdoj të mësoj nga ju.

Gjithmonë nxënësi juaj Gjovalin Lumaj, Detroit, Michigan, 17 prill 2013

Abdurahim Ashiku, me serinë e librave "Njerëz që i dua", tashmë është midis emigrantëve shqiptarë në të gjithë kontinentet: në Evropë, Amerikë, Australi.

botime

Ky libër paraqet para lexuesit informacione, detaje, përjetime emocionale që nga eksodi i dibranëve në vitin 1913 e deri në vitin 2013, vit kur mbushen plot 100 vjet të bashkëjetesës së dibranëve dhe tiranasve

"Dibranë dhe Tiranas 100 vjet së bashku"

Shoqata "Bashkësia Dibranë" në bashkëpunim me shoqatën "Tirana", nën kujdesin e Bashkisë së Tiranës, si dhe me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, organizoi në mjediset e Hotel Tirana International ceremoninë e promovimit të librit "Dibranë dhe Tiranas 100 vjet së bashku" të autorit Dr. Faruk Borova.


Kryetari i Bordit Drejtues të AIITC, Dr. Faruk Borova promovon librin e dytë me titull: "Dibranë dhe Tiranas 100 vjet së bashku". Ky libër vjen para publikut shqiptar me rastin e 100 vjetorit të eksodit të dibranëve. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: Kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Lulzim Basha, Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe z.Ruzhdi Lata, Kryetari i shoqatës "Tirana" z. Arben Tafaj, përfaqësues të fushës politike, përfaqësues të instituticoneve të ndryshme shtetërore dhe joqeveritare, miq, të afërm, bashkëpunëtorë dhe dashamirës të Dr. Farukut, dibranë dhe tiranas, etj.

Ishte vet Dr. Faruk Borova që mbajti fjalën e parë përshëndetëse të këtij promovimi, i cili në fillim falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë ditë të veçantë për të. Më pas ai i bëri një rezyme të shkurtër librit që promovonte, ku ndër të tjera nxorri në pah vlerat më të larta të dibranëve, si dhe bujarinë dhe mikpritjen e tiranasve, të cilët i hapën portat e shtëpive dhe zemrave të tyre dibranëve, pikërisht në atë kohë kur ata kishin më së tepërmi nevojë. Ai gjithashtu përmendi faktin se si dibranët emigruan drejt Tiranës dhe jo drejt një qyteti tjetër, mos ndoshta e parandienin se Tirana do të kishte këtë zhvillim që ka tani dhe do të bëhej kryeqendra e Shqipërisë? Dr. Borova e përfundoi fjalimin e tij duke cituar një pjesë nga fundi i librit, ku ai përmend shembullin e dy të rinjve dibranë dhe tiranas në vitin 2030, ku vetëm ata të dy do ta dinë se nga e kanë prejardhjen, pra cili prej tyre është tiranas dhe cili dibran, ndërsa të tjerët as që kanë për ta kuptuar. E gjithë kjo ndodh për shkak të shkrirjes dhe gërshetimit të të gjitha dallimeve në një të vetme.

Më pas fjalën e mori Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe z. Ruzhdi Lata, i cili emocionoi të gjithë të pranishmit me fjalën e tij. Ai falënderoi në mënyrë të veçantë të gjithë ato familje tiranase të asaj kohe, të cilët mikpritën me shumë dashuri dhe bujari dibranët, të cilët të detyruar nga shovinizmi dhe reprezaljet serbe morrën rrugën e mërgimit, pa e ditur se ku do të përfundojnë. Z. Lata shtoi:"Kur vijmë në Tiranë, na duket sikur vijmë në shtëpinë tonë të dytë, sepse Tiranën e konsiderojmë "nënën e madhe" të të gjithë shqiptarëve anekënd botës".

Miku nga Dibra e Madhe, falëndëroi dhe përgëzoi autorin e librit Dr. Faruk Borova, për nismën që kishte ndërmarrë duke sjellë dhe paraqitur para publikut shqiptar informacione, detaje, dhe përjetime emocionale që nga eksodi i dibranëve në vitin 1913 e deri në vitin 2013, vit kur mbushen plot 100 vjet të bashkëjetësës dibranë dhe tiranas së bashku. Ai gjithashtu e konsideroi këtë aktivitet si një ngjarje historike për të gjithë shqiptarët në përgjithsi, dhe për komunitetin dibran dhe tiranas në veçanti.

Fjalën e radhës e mbajti Kryetari i Shoqatës "Tirana" z. Arben Tafaj, i cili tha: "Ndihem i privilegjuar që jam i pranishëm në një aktivitet të tillë, ku në fokus janë dy komunitetet më të mëdha të Tiranës, dibranë dhe Tiranas". Ai gjithashtu përmendi faktin e përshtatjes së të dy komuniteteve në shumë drejtime, si në traditat e ndryshme, lidhjen e martesave mes të dy komuniteteve, bashkëpunimin e frytshëm, etj. Aktivitetin e përshendeti edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha, i cili edhe ai falënderoi familjet autoktone tiranase për mbështetjen e madhe dhe të pashlyeshme që i ofruan dibranëve gjatë kohës së eksodit të vitit 1913.



Një panoramë më të detajuar, më konkrete, më konçize të librit "Dibranë dhe Tiranas 100 vjet së bashku" paraqiti z.Bedri Telegrafi, i cili në fillim përcolli në mënyrë të veçantë për të gjithë të pranishmit përshëndetjet e Drejtorit të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam Dr. Ramiz Zekaj, si dhe të AIITC në përgjithsi, institut i cili e ka mbështetur botimin e këtij libri, si dhe organizimin e kësaj ceremonie promovimi. Z.Bedri Telegrafi përmendi ato fakte përtej rreshtave të këtij libri. Ai përmendi se dibranët nuk e patën fatin ta gëzonë pavarësinë e Shqipërisë, ashtu si të gjithë shqiptarët e tjerë, sepse shovinizmi serb nuk i la.

Gjithashtu z. Telegrafi përmendi dëmet e shumta të agresionit serb si: me mijëra njërëz të vrarë, burra, gra, pleq e fëmijë, me mijëra shtëpi, xhami e teqe të djegura e të shkatërruara. Pikërisht këto ishin ndër shkaqet më kryesore që detyruan më shumë se 20.000 dibranë të emigrojnë drejt qyteteve të tjera të

> "Kur vijmë në Tiranë, na duket sikur vijmë në shtëpinë tonë të dytë, sepse Tiranën e konsiderojmë "nënën e madhe" të të gjithë shqiptarëve anëkënd botës".
>
> Ruzhdi LATA
> *Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe*

Shqipërisë, por edhe jashtë saj, por kryesisht në Tiranë, e cila në atë kohë përbehej nga 8000 banorë. Recensenti i këtij libri Bedri Telegrafi nuk harroi të nxjerr në pah para të pranishmëve edhe heroizmin, vendosmërinë dhe rezistencën e dibranëve për të mbrojtur vendin e tyre nga çdokush që synon të cënojë të drejtat dhe kufinjtë e tyre gjeografikë dhe jo vetëm. Bedri Telegrafi tha se Dibra ka nxjerrë burra të rrallë, që u shndërruan në personalitete të shquara të vendit tonë si: Vehbi Dibra, Haki Sharofi, Isuf Elezi, Iljaz Dibra etj.

Një shembull konkret të lidhjes së ngushtë të dibranëve me tiranasit edhe në ditët e sotme e dha nën/kryetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, z. Zamir Ndroqi, i cili është nga Tirana, ndërsa bashkëshorten e ka dibrane. Ai theksoi harmoninë dhe dashurinë reciporke që gëzojnë këto dy komunitete për njëri-tjetrin. Të gjithë të pranishmëve iu dhurua nga një kopje e këtij libri, për t'u njohur më nga afër me përmbajtjen e tij. Edhe në këtë ditë të veçantë për Kryetarin e Bordit Drejtues të AIITC, Dr. Faruk Borova, AIITC i qëndroi pranë duke vënë në shërbim të tij të gjithë stafin teknik që disponon. Ceremonia e promovimit të këtij libri u shoqërua edhe me një kokteil për t'i dhënë mundësinë të gjithë të pranishmëve për të diskutuar nga afër në lidhje me librin.

E urojmë Dr. Faruk Borova për këtë libër, duke i dëshiruar suksese të mëtejshme dhe libra të tjerë, po aq të rëndësishëm.

Marrë nga "standardi.info"

ASLLAN MUHARREMI, ME NJË TUFË LIRIKASH: "BRYMË NË BOSTON"

Lirikat e dashurisë



Nga **Dr. FEJZULLA GJABRI**

Në një takim të ish-pedagogjikasve, maturë – 1966 në Shkodër, mësova se Asllan Muharremi, bashkënxënësi ynë, kishte botuar një vëllim poetik. Pra ishte poet. Nuk kishte dhuratë më të madhë, kur gjithë shokët e klasës së afër 40 viteve, lexonin ndonjë poezi dhe shihnin Asllanin në sy. Mendonim djaloshin e atëhershëm çapken e sot të thinjur aq shumë, bardh fare. Rrallë e njohëm, se unë, p.sh.e shihja për herë të parë pas 40 viteve. Disa tjerë kishin një vit që e kishin kaluar ketë situatë. Por, jo vetëm Asllani ishte thinjur. Kishte të tjerë që nuk i kishin fare flokët, e për 'të kompensuar' humbjen e tyre, ndonjëri përdorte kapele. Kjo është jeta. Dikur çapkënë, sot me barrë thinjash e mendueshëm. Në ketë takim Asllani vinte me një tufë poezish, që tregonte se çapkënllëqet i vazhdonte, por në mënyrën e seriozitetit dashuror. Pra, jo me citate dashurie, siç bënim zakonisht të rinjtë e asaj kohe, por me thirrje të gjatë dhe të epshme për jetën dhe dashurinë. Tashmë shkruan: "….*Dashuria s'njeh formulë/ edhe mbretërit i përkul./E kthen ferrin në parajsë/, i bën njerëzit kamikazë. (Dashuria).* Lexonin poezi të tilla dhe shihnin me bisht të syrit Asllanin…

Të dalim te vëllimi poetik.

Lirikat e vëllimit " Brymë në Boston" janë cilësuar 'thirrje për jetën dhe dashurinë'. Të paktën kështu e ka cilësuar në hyrje të vëllimit Flutura Açka, poete e njohur. Asllan Muharremi na ka dhënë një poezi njerëzore, plot ndjenja, , herë-herë me dhimbje në ditë 'të rënda', por që triumfon shpresa. Nëpër poezi ka ndonjëherë vijnë nga dilema të cilat vijnë në kohë mungese të dashurisë:

Ishin ditët e vështira,/ fundin përjetonim, sytë e tu rrathënxira, më nuk xixëllonin. /Nuk t'i thashë të gjitha fjalët e vërteta,/ kur sytë e tu buronin vetëm lot të nxehta /ankthe e dilemma. (Pa ty) *Ndërsa besnikërin e shpreh: S'iu nënshtrova askujt,/ vetëm një fjale, /betimit të shejtë, zemrës që fale.* (Vetëm një fjalë)

Ky vëllim poetik në vete ngërthen një larmi temash, që ka arritur vlerën serioze e të pasur, si për nga ndërtimi, po ashtu edhe për nga qasja si ju ka rrekur poezisë. Poetja Flutura Açka thotë: *Realisht, fare shkoqur është bota e brendshme e vetë poetit Muharremi. Penda e tij është një pendë e talentuar, një krijues që ka fituar një vetëbesim së pari për vetë jetën të shkrirë në poezi, që pa asnjë frikë del para lexuesit me tërë fuqinë e tij krijuese që e ka. Vargjet tregojnë talentin poetik, me bindje dhe siguri në artin e thurjes së vargjeve në moment vështirësie: "Asnjë çast/ s'më linte vetëm/e mundonte dhimbja/Kur shihte si tretem.* (Limforma).

Në gjetjet e poetit shohim se na vijnë situata sa origjinale aq dhe emocionale dhe nuk kemi si të mos mbetemi të befasuar:

Dola në dritare
dhe mora frymë,
vjeshta në Boston
hyn me brymë.

"Brymë në Boston" është i thjeshtë, njerëzor, i ngrohtë dhe priret kah zemra, nga edhe buron. Të mund të ruash një ndjenjë kaq lirike në poezi, është një meritë, pasi është meritë e vetë thelbit të poetit që e shkruan atë. Është një arsye që të çon të mendosh për vlerën e këtij materiali. Një koncept i hijshëm njerëzor në komunikim te kjo shoqëri ku fati e çoi. Mendon nga vendi i vet që po ndërtohet, demokratizohet dhe përligj mendimin e fjalës së lirë.

Kur erdha
pranvera kishte ikur,
hëna ishte fshehur,
yjet ishin fikur.
Për diellin
isha bindur
enigëm
për të mos lindur!
(Brymë në Boston)

Duket se poeti e njeh diellin një orë përpara të tjerëve, duke pohuar pohime, që prodhojnë ndjenja çdo ditë dhe çdo orë. Janë pohime në ato re të bukura që të ngacmojnë ndjenjat e që të bëjnë të kërkosh sa më parë origjinën e thinjave. Rikthim në rini: *… Vitet i kam shkruar,/Dhe ëndërroj akoma,/Për buzët ovale,/ që veç njëherë t'i njoma.*(Fjalët e pathëna). Në pasionin dashuror duket ekzaltimi, që po ta përkthesh brënda atij konteksi, poeti nuk të çon kurrë në rrugën e mëkatit: *"S'kish rënë nga qielli,/As ishte ringjallur/ Nga dashuri e saj shpirtin kishte falur"*. Pra njerëzor, brenda njerëzores; i dashuruar brenda dashurisë. Këto janë vargjet e Asllan Muharremit.

Ky libër është ai trupëzim që synon dashurinë dhe gëzimin njerëzor. Sheh vetë jetën që tek poeti 'po kalon' para syve. Diku sheh pleqërinë, të kaluarën që "*S'e kuptoj çfarë ndodh, vetëm kur troket, Flokët e murrme, të zbardhen si moket"*. Edhe pse pjesën më të madhe të vëllimit poetik e ze vatra dashurore, nuk largohet nga traditat, nga natyra e bukur e vendlindjes, nga gëzimet e dhimbjet jo vetëm vetjake.

Ishte nga Gurra e Madhe,
bablok i fjalës dhe besës,
i odave si livadhe,
si lis në krye të vatrës.
Masiv dëbore
i dukej qeleshja,
fliste ai burrë
kur fillonte heshtja.
(Plaku i Gurrës)

Në poezitë e tij duket ruajtja e mrekullueshme e lirizmit, që e shkruar në ditët tona, e ka ruajtur, mbrojtur dhe përhitur njerëzoren brenda vetes, duke pasqyruar poetikisht edhe tisin melankolik e sentimental, që vjen nga kalimi i viteve.

Diku hulumton edhe psikologji që kërkon respekt për mendimin e lirë që përcjell tek lexuesi me vargje lakonike të llojit të vet. Në parafytyrimin tonë na bën të vërtitemi rreth këtyre poezive me një konceptim të hijshëm, të vlefshme edhe për kompozitorë, pasi ka nota poetiko-muzikore me shumë bemola, që kumbojnë hijshëm…

Poezi nga Islam Çenga



Korabi në qershor. Foto: © Bujar Karoshi

“ …dhe zogjtë e **vendlindjes** fluturojnë”

Në Kala të Dodës

Në Korab e Veleshicë, nëpër Gramë e Sorokol
Veshur nata me mëndafsh si një hanëm arabie
Kuturis ky Drini i Zi nëpër shkurre si hafije
Kur kalon cuca e Kalasë me shami e me dimije...

Që nga sisa e Korabit rrjedh si qumësht Veleshica
Ulen cucat parsi zana e lajnë shtatin, çuçurisin
Kurm` i hënës mblidhet skrupull krejt i mbushur me mornica
Laureshë e Radomirës ngre folenë majë lisit.

Maja lisit dega-dega, gjeth e gjeth e syth e syth
Trung i çarë nga rrufeja e lëvore deje deje,
Po s`u ngjita lart në majë do t`a pres me rrënjë at` lis
Veç t`a rrok njëherë në krah fal` gjithë botën ke prej meje.

E t`ja puth nishan` në faqe e t`a nduk flokun e zi
Nëpër Bjeshkë të Korabit, Gramë e Tejz e Sorokol
Sa jam gjallë e sa marr frymë, si sulltan e djalë i ri
Unë do t`jem për Laureshën hem ashik hem karrakoll..

Pa thënë lamtumirë

(Ja fal mjekut stamatolog,
shokut dhe mikut, Përparim Rushitit)

I thashë Rimit,
Merr një rrënjë mollë nga vendlindja
Dhe mbille diku tek “Rruga e Kavajës”
Ku çdo mëngjes ngre jakën e palltos
Me qeshjen e shpirtit hap qiellin e kaltër...
Merri në një dorë ca turshi të nënës
Mbetur në një kthinë të dimrit të ashpër
E pimë një gotë raki për të ngrohur mallin
E një fishkëllimë motiv për të dashurën...
Ca lule mëllage mblidhi pragjeve e dritareve
Të çelin udhës me agun e mëngjezit
Merre dhe pallton e babait të paveshur me vite
Palose në kremastarë mani ku puthen pëllumbat.

Hej mik, mos harro të marrësh në valixhe
fytyra të dashurish
Zogjtë në delir nga aroma e blirit
Një copë udhë fëmijërie me këmbët vrarë gjithë vraga
Një puthje të rinisë mbetur ende në beben e syrit...
Hej shoku, mos harro hapësirën blu të qiellit
Natën e martesës që na dehu në delir të kallur
Një copë suva guzhine dhe një pjatë alumini të gjyshes
Dhe fotot dhe librat në raftin e dritares së kalbur...

Hej kapo, mos harro dhe mirëseardhjen tek pragu
Tungjatjetën dhe udhëembarën që t`a ka fal gjindja
Të gjitha, të gjitha ngjeshi me kujdes
në valixhen e shpirtit,
Që kur t`a hapësh, të mbushet boshi i njeriut
që i mbetet nga vendlindja.

Mos harro
Merr dhe një vale kaltëroshe nga Drini i Zi
Nga thatësira i pakët, nga vjeshta i fryrë
Dhe njom çdo mëngjes sytë e t`u të mallur
Pa thënë shoku, lamtumirë...

Kafeja në prag dimri

Ne jemi në një bar-bufe në rrugën Zhan Dark
Në udhën me shi qindra hapa nguten
Mijra thashetheme ngrejnë pluhur në asfalt
Si plaka të lemeritura...janë plaka...
Në fasada vjeshte
Kanata dritaresh që nduken nga era
Thyejnë bizhutë e qelqta

Druvarët në mal ngrejnë jakat e pelixhes
Si makth nga ngutja e dimrit
Turfullimi i kuajve shkund gjethn` e fundit
Nga lisi mbetur cung
Në zgripin e vjeshtës

Pas gardhit të fundvjeshtës
Kolliten mëllenjat
Të kapura në lukth.

Numërojnë tespijet pleqtë
E duke nëmur plakat
Dremisin në mindere
Si maçokë të lodhur...

5 kostarë dhe babai 6

5 kostarë dhe babai 6, kositnin parcelën e jonxhës
Dhe nëna gatuante drekën në mutfakun si fole turtulli
Kostarët fqinj merrnin me vete fëmijën më të vogël
Babai merrte time motër;

Secili në korsinë e tij si në garat me kuaj
Palosnin jonxhën rradhë-rradhë në anë
Dhe ishte qetësi
Vetëm gjingallat dhe tehu i kosës
Dhe matanë një vijë uji
Dhe ca bretkosa
Dhe një fishkëllimë lopçari që kthehej nga kullota
Mbushnin djepin prej lisi të fshatit

Do t`a thaj dielli në gjeth e lëkurë, më thoshte babai
Do t`a ngrejmë mullar, thoshte babai
Dhe në dimër do t`ja japim lopës,
Dhe lopa do t`a bëjë qumësht,
Qumështi do të bëhet kos
E kosi dhallë e shëllirë
Deri sa të piqen manat

Do të piqen dhe kulumbritë e luleshtrydhat
E do të heqim trikon e leshtë nga mishi
Kur jonxha do të dalë nga brinjët e dheut
Dhe 5 kostarët e babai 6 do të kositin plakjen
Ne do jemi rritur një pash më tepër...

Prag dimri

Qeleshën e gjyshit herët në vjeshtë në sy ul Korabi
E vesh kupran e tirq të bardhë e gjithë bjeshka
Dhitë e egra në rrëpirat thikë të Gramës
Kërcejnë padjeshka...

Veleshica njerkë në mjergull ngre pusinë
Dy gra i ka lënë, shtatë gra i ka prapë
Velenxë i mban për dimër
Dhe për verën fllad.

Gërr-gërr ariu i borës gërhet në Korab
Drin e Veleshicë mornica nëpër shtat...

Bukëndore

Si bukëndore në qiell theket Dielli
E unë,
E ti,
E ne,
E ju e të tjerë
Hamë nga një vakt bukëndore Diell.

Shuajmë urine, por na kap etja
Shuajmë etjen, por na shtohet urija

Si bukëndore në sofër theket mosha
E unë
E ti
E ne
E ju të tjerë
Në çerep prej balte gatujmë
Bukëndore shprese...

Në rrugën me gardhe sa shtati im

Shtëpinë time në fshat babai ja dhuroi motrës
D.m.th. hallës time
Asnjë gur s`pata vënë në themele
Asnjë tjegull s`pata ngjitur në çati
Veç një man mbolla në kopësht që i vogël
Një man që lotonte me sytë e trungut
Sa herë mungoja unë
Sa herë shkoja unë;

Ndoshta do të ishte shembur shtëpia
Po të mos ishte halla
Vetë ja lyen muret e gurta,
Vetë ja çel dritaret e drujta
Po vetë pastron hajatin dhe oborrin
Dhe sa herë ujit qeptë e specin në kopësht
Ujit dhe manin.

Babai im e fali shtëpinë e fshatit motrës
Dmth hallës time
Në ishim të vegjël
Dhe morrëm dy dhoma e guzhinë në qytet
Oborr nuk kishim, as fole dallëndyshesh
As ahur dhe kalldrëm me bajga
Por në dritaren time sillte era në hejbe
Në netët pa gjumë rënkimet e manit...

Mani sytë i ka tek trungu dhe loton
Në degë foletë e zogjve dhe shpreson

Ka mote pa e parë...

Gardhi i thurur nga gjyshi

Gardhi i thurur nga gjyshi po ha me dhëmbë
thonjtë e mbetur
Tash e 100 vjet
Hithrat e kanë kapluar, kafshari e ka rralluar
Gjind e sorollop futen në qejf të vet
Në shteg
E pa shteg...

Ne ikëm në qytet. Pas lamë gardhin mbërthyer në një
Pëllëmbë tokë me ferra qeverie,
Me trëndafilë të egër,
Me murriz të plakur,
Ndër plepa hardhi e hallakatur...

Zhgryhen pulat, qentë bëjnë seks
Fryhen hardhucat nga shullimi në qejf
Aspfalt me jargë shtrojnë kërminjtë sedef
Grenxat thumbojnë të dashurën e vet...

Fëmijët kacavirren në natën më hënë
Luajnë kukamçeftas,
E luftas si i thonë
Nën ditën me diell nëpër hunj shurrojnë
Dhe diell mbajnë në dorë...

Gardhi i thurur nga gjyshi po ha me dhëmbë
thonjtë e mbetur.

portret

Jeta e Haxhi Leshit është kalvar i gjatë, mbushur me mundime, vuajtje, luftime, heroizma, triumfe, mbijetime, besëlidhje e besëmbajtje, përmbajtje e guxime, vendime drastike për hir burrërie, qëndrime të paepura ndaj të liqve, luftë titanike për idealin që sakrifikoi, fitore e lavdi, zell e shqiptari.

Haxhi Lleshi *sipas dokumenteve*

Nga **HILË LUSHAKU**

Haxhi Lleshi i përket një treve shqiptarie nga më të zjarrtat për atdhetari, sikurse është Dibra e Skënderbeut, porta ku turqit faleshin, grykat ku lanë kockat shumë armiq. E vërtetë e dokumentuar nga shumë studiues e historianë të ndershëm por edhe nga disa shkrues korbazinj është edhe fakti se ai nuk u lind në një konak që mbahej nga një tra i nxirë prej bloze, por pinjoll i një derë të shquar dhe bir i një trimi, me spaleta e gradë majori në shërbim të çështjes shqiptare, biri i Halit Lleshit, përkrahësit të kongresit të Lushnjës, miku patriotëve antizogistë: Bajram Curri, Elez Isufi, Hasan Prishtina, Aqif pashë Elbasani, Mihal Grameno. Haliti e la Haxhiun 10 vjeçar jetim por jo të varfër, i vrarë nga dora gjakatare e prefektit Neki beu i Starovës, me urdhër të Zogut, pak kohë pas lëvizjes së marsit 1922, ku prijësi dibranë luftoi me armë në dorë për largimin nga froni të uzurpatorit karrierist e satrap.

Jeta e Haxhi Leshit është kalvar i gjatë, mbushur me mundime, vuajtje, luftime, heroizma, triumfe, mbijetime, besëlidhje e besëmbajtje, përmbajtje e guxime, vendime drastike për hir burrërie, qëndrime të paepura ndaj të liqve, luftë titanike për idealin që sakrifikoi, fitore e lavdi, zell e shqiptari. Kjo solli emrin e Haxhi Leshit në wikipedia, në enciklopedi të huaja dhe shqiptare, në libra e gazeta, në dokumente të panumërta që askush nuk mund t'i fshijë apo mohojë. Ka qenë vetë Haxhi Lleshi që jetën e tij e ka dëshmuar në librin "Vite, Njerëz, Ngjarje", ku gjen persekutimin zogist, jetën në emigracion, etjen për shkrim e këndim shqip, refuzimin qeveritar për të mos e lejuar të kryente shkollën e mesme, praninë e tij në odat dibrane, lidhjet e miqësia në emigracion me antizogistë si: Myslim Peza, Kajo Karafili, Xhevdet Doda, Vasil Shanto, Thoma Kalefi, Mustafa Gjinishi, Gaqo Mosko, Nazmi Shehu, apo heroikën e tij në luftën nacionalçlirimtare e në punën ndërtimtare të Shqipërisë së djegur e të shkatërruar nga lufta.

Janë të shumta dokumentet që dëshmojnë se Haxhi Lleshi antizogist e antifashist u kthye nga emigracioni në Dibër në mars 1941 dhe iu bashkua idealit kombëtar për çlirim. Dokumentet italiane dhe historiku i Dibrës provojnë se natën e 4 prillit 1941, me 300 burra të armatosur, Haxhi Lleshi sulmoi forcat ushtarake italiane të Divizionit "Firence" të cilëve u rrëmbyen shumë armë, municione, ushqime e veshmbathje. Aktiviteti atdhetar i tij në vitet 1941-1942, për të mbjellë farën e bashkimit e të besës në krahinën e Dibrës, provohet me dokumente të botuara prej komunistëve, legalistëve apo edhe kujtimeve të bajraktarëve, ku pohohen takimet me Abaz Kupin, Fiqiri Dinen, Hysni Demën, Muharrem Bajraktarin, Hysen Selmanin, etj.

Roli i tij prej luftëtari i çështjes kombëtare është dokumentuar në historikun e disa rretheve si Mati, Korça, Berati, Skrapari. Emri i tij nuk mungon edhe në korrespondencën që ka prefekti i Dibrës, Qazim Mulleti, me Ministrinë e Brendshme, i cili u përpoq ta joshte me fjalët: "Nuk do t'ju dalë keq, po të dorëzoheni në besën time, Qeveria nuk do t'jua kursejë as shpërblimet, as postet". Po kështu ai është i evidentuar në ato vite si mospajtues me sjelljen e prefektit edhe për shpërblimet që u jep shërbëtorëve të fashizmit si Halil Alia, Cen Elezi, Fiqiri Dine, Dine Dema, Selim Xhetan Kaloshi, Ukë Cami, Myftar Kaloshi, të cilët përndjekin miqtë e tij Nazmi Rushiti, Xhavit Hatibi, Demir Gashi, Irfan Hajrullai e Ahmet Jegeni.

Aktiviteti nacionalistit Haxhi Lleshi përjetohet edhe në historikun e Pezës, vendit të bashkimit atdhetar të shqiptarëve pa dallim feje, krahine,



bindjeje politike e ideje, duke nisur që nga 8 marsi 1942, kur ai mbërriti në Pezë e u mirëprit nga Myslym Peza dhe më pas kur u takua me Qemal Stafën, Vasil Shanton, Mustafa Gjinishin, Esat Dishnicën, Nako Spirun, Abaz Kupin dhe me Enver Hoxhën, pamja fizike e të cilit dhe qartësia ideopolitike e interesimi tij i jashtëzakonshëm për të njohur gjendjen në Dibër i lanë mbresa që nuk iu shlyen kurrë nga kujtesa.

Emri Haxhi Lleshit si luftëtar me pushkë në dorë lidhet me krijimin e çetës partizane të fshatit, me veprimet e saj në aksionin e parë në Bulqizë, te "Gurët e Skënderbeut", me bashkimin e saj me komunistët Ramadan Çitaku, Nazmi Rushiti, Qazim Prishtina, Zoi Themeli, Irfan Hajrullai dhe Veli Deva, me pjesëmarrjen në aksionin e 24 korrikut 1942 për prerjen e linjave telefonike e rrëzuar shtylla të linjave telefonike në Dibër e Madhe-Maqellarë, Peshkopi-Sllovë, Dibër e Madhe-Zerqan-Bulqizë. Në raportin e kuesturës së Dibrës, më datë 24 gusht 1942, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë provohet zyrtarisht plagosja e Haxhi Lleshit në urën e Topojanit mbi lumin Drin, kur po shkonte në konferencën e Pezës. Haxhi Lleshi njihet zyrtarisht si miku besnik i nacionalistit e luftëtarit Baba Faja Martaneshi, i cili e priti në "odën e selamllëkut", dhe së bashku udhëtuan drejt Pezës.

Dokumentet arkivore të zhvillimit të konferencës së Pezës, më 16 shtator 1942, provojnë pjesëmarrjen dhe rolin e tij tashmë si një udhëheqës i luftës, ku për herë të parë pati rastin të shprehet për punën që po bëhet në krahinën e Dibrës, Kosovës, Gostivarit, Tetovës, Kërçovës e Strugës për organizimin e qëndresës antifashiste. Me aktivitetin dhe emrin e Haxhi Lleshit në kohën e luftës nacionalçlirimtare janë krenuar Zerqani e Strikçani, Maqellara e Bllaca, fshatrat e Grykës së Madhe e Gjorica ku ai krijoi batalionin partizan më 26 korrik 1943, e gjithë krahina e Dibrës si dhe shumë fshatra të Matit, Bulqizës e Krujës, jo vetëm si komandant por edhe financues me napolona floriri.

I shquar në odat e kuvendeve burri i urtë e paqedashës në krahinë, Haxhi Lleshi atdhetar nuk rreshti kurrë për të bashkuar krerët e parisë së Dibrës në luftën e përbashkët kundër armikut pushtues, sidomos në takimet e kuvendimet me Fiqiri Dinen, Hysni Demën, Arif Konicën, Muharrem Bajraktarin, Myftar Kaloshin, Abaz Kupin, Mit'hat Frashërin, Hasan Dostin, Ali Këlcyrën, madhe edhe pas prishjes së marrëveshjes së Mukjes. Atdhetaria e përgjegjësia e lartë për kauzën që u shtrua në Pezë, spikat te Haxhi Leshi edhe në mbledhjen historike të jetës politike të Partisë Komuniste Shqiptare zhvilluar në Labinot të Elbasanit më 10 korrik 1943, për të cilën ai ka shkruar: *"Fola për njësitet partizane dhe për shtimin e radhëve të tyre, për aksionet, për kështillat nacionalçlirimtare, ...te qëndrimet e krerëve të parisë, punën që kemi bërë me ta, sidomos në frymën e Konferencës së Pezës. Tregova se elementë të tillë si Fiqiri Dine, Hysni Dema, Myftar Kaloshi e të tjerë, në një mënyrë apo në një tjetër, po i shërbenin fashizmit,...etj."*

Dokumentet e PKSH në një anë dhe ato të kuesturave fashiste nga na tjetër kanë përjetuar faktet se më 10 korrik 1943 Haxhi Lleshi është zgjedhur në përbërje të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, së bashku me Enver Hoxhën, Myslym Pezën, Spiro Moisiun, Ramadan Çitakun, Bedri Spahiun, Mustafa Gjinishin, Dali Ndreun, Abaz Kupin, Mustafa Xhanin. Po kështu, në konferencën e dytë të Labinotit, e cila përfundoi punimet në 8 shtator, ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, si dhe anëtar i kryesisë së këtij Këshilli. Urtësia, besa, burrëria, trimëria e guximi i Haxhi Lleshit dolën në pah edhe kur kapitulloi Italia fashiste, rast kur ai ka asistuar në dorëzimin e 12000 personave dhe një teknikë luftarake të shumtë të Divizionit "Firence" në forcat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ku u përball me shefin e misionit ushtarak anglez pranë batalionit partizan të Dibrës, kapitenin Hends.

Burrëria e autoriteti i tij prej udhëheqësi ushtarak e politik i LANÇ-it ndikoi që më 12 shtator 1943, forcat partizane në Dibër lejuan e shoqëruan ushtarët italianë të lëvizin drejt Durrësit e Tiranës. Zhvillimet e mëvonshme nxorën më mirë në dukje aftësitë e tij drejtuese e komanduese ushtarake por edhe politike në përballjen e armatosur me formacionet ushtarake të krahinës, të komanduara nga bashkëqytetarët e tij Fiqiri Dine, Hysni Dema, Halil Alia, Riza Drini, etj. Kjo situatë solli nevojën për të shkuar në Korçë, në dhjetor 1943, në kuadrin e bashkërendimit të operacioneve partizane, ku gjeti Koçi Xoxen, Medar Shtyllën, Ramadan Çitakun, Pandi Kriston. Jeta e Haxhi Lleshit kaloi në fillin e vdekjes gjatë luftës partizane, duke qenë përballë armiqve por edhe pseudomiqve. Ai nuk ndali marshimin e tij partizan edhe kur humbi lidhjet me Shtabin e Përgjithshëm, madje mori mbi kurriz përgjegjësi të mëdha si anëtar i atij shtabi dhe Kryesisë së Këshillit Antifashist.

Haxhi Leshi ka shkruar emrin në historinë e krijimit të disa brigadave partizane, ku përmend: brigada 4-të S, në bashkëpunim me Teki Kolanecin, komandant i çetës së parë partizane të Korçës, të Gorë-Oparit dhe Raqi Qirinxhiun; brigada 5-të S, krijuar më datë 15 janar 1944, në Sheper të Zagorisë, të cilës i dërgoi me korrier përshëndetjen në emër të Shtabit të Përgjithshëm; brigada 7-të S, më 17 mars 1944, në Vlushë, ku pati përkrah Bedri Spahiun, Ymer Dishnicën e Medar Shtyllën në çastin kur i ka dorëzuar flamurin luftarak komandantit të brigadës Gjin Markut. Ai la emrin e tij edhe në përurimin e Brigadës së 12 Sulmuese, në Sukë të Përmetit, më 18 maj 1944, duke qenë i deleguar i Shtabit të Përgjithshëm.

Në vitin 1944 ai konfirmohet si një nga liderët e luftës fitimtare, duke qenë në ballë të saj në zonat më të vështira. Më 15 prill 1944 mbërriti në Helmës të Skraparit, ku u mbajt mbledhja e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe u hodh ideja për mbajtjen e kongresit të Përmetit. Në zbatim të detyrave të shtruara në këtë mbledhje ai ka punuar në qarkun e Beratit. Historia mban brenda vetës faktin e dokumentuar se më 24 maj 1944 Haxhi Leshi ishte pjesëtar i kongresit të Përmetit, ku është zgjedhur anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe është emëruar në detyrën e të ngarkuarit me Punët e Brendshme. Haxhi Lleshi është nënshkrues i vendimeve të kongresit të Përmetit, të cilat janë përmbledhur në dokumentin e quajtur "Libri i Kongresit". Referuar dokumenteve arkivore të fondit të Ministrisë së Mbrojtjes, Haxhi Lleshi është caktuar nga Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar dhe nga Shtabi i Përgjithshëm për të shkuar me Divizionin e Parë Sulmues në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut si njohës i mirë i këtyre zonave, në zbatim të urdhrit të dhënë më datë 1 qershor 1944, nga Shtabi i Përgjithshëm, duke qenë i pranishëm në inkursionet luftarake për përballimin e operacionit armik të qershorit, si në malësitë e Skraparit, në qarkun e Korçës, në rrethinat e Pogradecit, në Mokër, në Qarrishtë, në Gollobordë, Zerqan, në Varret të Vrame, në Fushë-Alijë, në Martanesh, në krahinat e Dibrës së Madhe, në çlirimin e Dibrës më 2 shtator 1944, në krahinën e Lumës, prej ku është njoftuar për t'u nisur menjëherë për në Odriçan të Përmetit "për një mbledhje të rëndësishme".

Në vazhdim të përgjegjësive politike dhe administrative që mori në kongresin e Përmetit, ka përshëndetur përsëri në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare krijimin e Brigadës 18-të Sulmuese, krijuar më 20 gusht 1944, në Sllatinë të Dibrës. Në shtator 1944, në cilësinë e liderit politik e ushtarak të luftës patriotike ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar me Muharrem Bajraktarin, së bashku me Hysni Kapon e Dali Ndreun, për t'i bërë thirrje edhe një herë tjetër që të bashkohej me Luftën Nacionalçlirimtare, por ndonëse bajraktari i Lumës "...pranoi vendimet e kongresit të Përmetit, e kërkoi një premtim për kolltuk, në fund deklaroi se *"Kundër jush unë nuk do të luftoj, por edhe me ju nuk do të bashkohem"*. Në vijim, më 20-23 tetor 1944, mbasi qe larguar nga Odriçani, ka marrë pjesë në mbledhjen e Beratit, ku u vendos që "Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar" të kthehej në "Qeveri Demokratike Provizore të Shqipërisë", ndërsa Haxhi Lleshi mori aty postin e lartë e më të vështirin, atë të ministrit të Brendshëm, i njohur zyrtarisht pjesëtar i kabinetit të qeverisë së parë komuniste të drejtuar nga Enver Hoxha, fakt që dokumentohet në shumë dokumente. Fotoja e tij është në ballë të drejtuesve të luftës antifashiste duke hyrë në Tiranën e çliruar më 28 nëntor 1944, një dokument që flet qartë se partizani trim e udhëheqësi i shquar nacionalist, Haxhi Lleshi, tashmë ishte një nga zbatuesit e programit të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, të ideuar nga Partia Komuniste Shqiptare, anëtar i së cilës qe regjistruar që më 4 prill 1943.

Dokumentet e shumta në arkivin e MPB pasqyrojnë punën e vyer të bërë prej Haxhi Leshit dhe bashkëpunëtorëve të tij për sigurimin e rendit në vend, duke dëshmuar se ajo punë kishte filluar më herët dhe në ditët e para të çlirimit u vunë menjëherë në zbatim, të dhëna të cilat unë i kam prezantuar gjerësisht në librin "Rrugëtimi i Policisë Shqiptare 1913-1945". Haxhi Leshi ka qenë i qartë në organizimin fillestar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke e organizuar me tre drejtori, përkatësisht e personelit, e administratës dhe e policisë, të domosdoshme për mirëfunksionimin e saj në situatë paslufte. Ai e ka konsideruar strukturën e policisë *"organ sigurimi për popullin kundër keqbërësve"*. Sa ishte Haxhi Lleshi në postin e ministrit u bënë arrestime të bujshme të bashkëpunëtorëve të nazi-fashizmit por edhe disa të tjerë që iu kundërvunë pushtetit që doli nga gryka e pushkës së luftës partizane, ku spikatin: në nëntor 1945 pjesëtarët e grupi të "Bashkimit të Shenjtë" dhe në janar 1946 anëtarët e grupit socialdemokrat.

Haxhi Lleshi la gjurmë edhe në detyrën "ministër shteti", në periudhën mars 1946 deri në pranverë të vitit 1950, duke qenë ndërkohë edhe në detyrën e anëtarit të Komisionit të Kontrollit të Shtetit nga fundi vitit 1946 deri 1948 dhe të kryetarit të kolegjiumit pranë Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë nga fundviti 1948 deri më 23 tetor 1949, të dhëna këto që portretojnë më saktë figurën e tij në administratën e lartë shtetërore.

Ashpërsia e zhvillimeve politike në gjirin e Partisë në periudhën 23 tetor 1949 deri më 20 prill 1954 e mënjanuan disi rolin e Haxhi Lleshit por nuk e zvetënuan, ndonëse ai kreu detyrën e drejtorit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë ecuri të veten ai e ka shkruar qartë në fletë-anketën e plotësuar prej tij dhe që ruhet në Arkivin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kopje të cilit i kam në dorë. Sipas këtij dokumenti Haxhi Lleshi, më 21.04.1954 ka filluar detyrën në postin e lartë të Presidentit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, por në një dokument tjetër, madje më bindës shkruhet se: *"...pas disa funksioneve të tjera ministrore, Haxhi Lleshi në vitin 1953 do t'i zinte vendin, Presidentit të atëhershëm të Presidiumit të Kuvendit Popullor, Omer Nishani"*. Sipas dokumenteve arkivore rezulton se në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave, më 23 korrik 1953 është caktuar në postin e postin e Presidentit të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe filloi detyrën më 1 gusht. Radio "Zëri i Amerikës" në një emision në fundin e korrikut të vitit 1953 ka komentuar rastin e emërimit të Haxhi Lleshit në detyrë: *"...Haxhi Lleshi është nga Peshkopija, afër kufijve të Jugosllavisë, por ky është një armik i fqinjës së Shqipërisë.*

(Vijon në faqen 23)

Libri përmban mbi 40 eksperienca që lidhen me shitjet, funksionimin e organizatave shqiptare në treg, komunikimin si një aset çmuar drejt suksesit...

Libri që na çon drejt **suksesit**

Nga **SHAQIR SKARRA**

Vitet e fundit jemi mësuar me promovime librash si në poezi, prozë, studime, duke mbushur kështu salla të vogla dhe të mëdha në metropolin shqiptar. Por më datën 8 qershor ora 10 në sallën e muzeut historik u bë promovimi i një libri krejt ndryshe sa ishim mësuar dhe kishim lexuar, një libër i ri por dhe me një risi të re që në fakt nuk e kishim parë më parë në bibliotekën kombëtare apo në librarité e Tiranës. Blerim Deda, një mësues fizike i talentuar pas një pune të gjatë në mësimdhënie, në gjimnaze të ndryshme të vendit doli para lexuesit me librin e tij "Tregu, marketingu, suksesi". Salla këtë radhë ishte mbushur jo vetëm me studiues, gazetar të mediave të ndryshme por së shumti dhe me biznesmenë të suksesshëm në fusha të ndryshme si në ndërtim, përpunim, prodhim dhe shitje mobileri, industri ushqimore, tekstile etj. Libri ishte vërtet një risi ndryshe, libër që nuk ishte botuar më parë në llojin e tij por ja që kemi nevojë të gjithë për të sidomos ato që merren me biznes dhe marketing pse jo dhe për pedagog dhe studentë në degë të ndryshme të fakultetit të ekonomisë. Autori i librit zoti Blerim Deda vjen nga fusha e arsimit, diplomuar për fizikë dhe aktualisht mësues në shkollën e mesme "Elez Isufi" në Bathore por pas një përvoje të gjatë 12 vjeçare , në kompani të suksesshme në vend arrin së fundi të na sjellë një libër që i duhet marketingut dhe biznesit në vendin tonë. Në diskutimin e tij biznesmeni Bardh Beqiri ndër të tjera tha: «E paskemi të vështirë të diskutojmë sot rreth librit, kemi një libër disi ndryshe, se një risi ndryshe na ka sjellë autori Blerim Deda. Ky libër sot duket i vështirë për të diskutuar rreth subjektit por vlerat që mbart do na shërbejnë të gjithëve, do na shërbejnë në punën tonë. Drejtori i shkollës «Elez Isufi» zoti Fadil Bushi u shpreh: «Blerimi si mësues fizike në shkollën tonë është një intelektual me diapazon të gjerë. Ne e pritnim se do na botonte së shpejti ndonjë libër artistik, qoftë në poezi, qoftë në prozë. Unë për vete nuk di të them se çfarë lidhje ka fizika me marketingun, por ja që Blerimi na solli një libër të ri në duar, na solli atë që na kishte munguar të gjithëve». Dhe vërtet Blerim Deda i mblodhi të gjithë bashkë arsimtarë, studiues, historianë, intelektualë e biznesmenë. E kush e ka bërë këtë më parë. Biznesmenët nuk kanë kohë të vijnë nëpër promovime librash. Sot ja tek erdhën për librin e Blerimit, erdhën dhe e mbushën këtë sallë të bukur se ky është një libër që ju duhet, një libër që ju shërben jo vetëm biznesmenëve por dhe të gjithëve që kërkojnë që të jenë një risi në botën e miks marketingut. Libri "Tregu, marketingu, biznesi" ndodhet në duart e lexuesit shqiptar, një botim ky vërtet luksoz do t'ju shërbejë marketierëve, shitësve, drejtuesve të organizatës, punonjësve, lexuesve të zakonshëm dhe gjithë atyre që në fakt dëshirën për të prekur suksesin e kanë prioritare. Libri përmban mbi 40 eksperienca që lidhen me shitjet, funksionimin e organizatave shqiptare në treg, çfarë marka sjellin ato për konsumatorët, konkurrencën dhe mënyrat e përballimit të saj,komunikimin si një aset çmuar drejt suksesit, motivimin e punonjësve, marrjen e përgjegjësive shtesë brenda organizatës dhe jo vetëm, kënaqjen e kërkesave konsumatore gjithnjë në rritje për hir të vërtetës, ide që prodhojnë rezultate etj. Blerimi përveç një mësimdhënës i talentuar, duke punuar për shumë e shumë vite në gjimnaze të ndryshme të vendit, një ndër pasionet e mëdha të tij është dhe marketingu dhe arti i bukur i komunikimit.

Në fjalën e tij, në fund autori i librit duke përshëndetur të pranishmit dhe për t'jua bërë më të lehtë në të kuptuar librin u shpreh: « Ky libër synon të qartësojë kanalet dhe rrugët e organizatave drejt suksesit. Materialet e tij emetojnë qartësi, rrugë të shkelura, ide, eksperienca, vizion dhe janë novatore. Lexoni këto shkrime, rilexoni ato, analizoni dhe konkludoni! Çdo organizatë, departament marketingu apo individ, mund të gjejë sado pak veten e tij nëpër këto shkrime. Të gjithë merremi me shitjet dhe shitjet janë në këtë tekst. Të gjithë merremi me marketingun dhe marketingu është pjesë esenciale e tekstit. Të gjithë komunikojmë dhe komunikimi është guri më i çmuar në mozaikun me plot gurë të tillë të vendosur në tekst. Të gjithë e duam suksesin dhe suksesi në trajtën e një vale elektromagnetike i përshkon gjithë faqet e librit «Tregu, marketingu, suksesi». Individ rendin gjithandej! Organizata po kështu. Investime dhe ide zhvillohen. Marketingu sofistikohet. Suksesi absorbohet aq sa dhe ikën në fund. Shpesh ngurrojmë dhe mezi marrim vendime. Shumë herë kapim çastin edhe pse ai mund të jetë rezultat i gabuar. Zbulojmë botën neutrale që na thërret në rrugën drejt synimeve tona. Ankthi dhe vrulli alternohen. Të gjitha këto dhe plot të tjera janë shtjelluar në trajtë analitike dhe sintetike në këtë libër. Iniciativa për këtë risi të botës së marketingut, erdhi nga leximi i jetës dhe veprës së të madhit Steve Jobs, një piketë e fortë referimi për gjithë botën e biznesit në përgjithësi dhe atij shqiptar në veçanti. Steve Jobs kërkonte produkte të thjeshta, por



> Të gjithë e duam suksesin dhe suksesi në trajtën e një vale elektromagnetike i përshkon gjithë faqet e librit «Tregu, marketingu, suksesi». Individët rendin gjithandej! Organizata po kështu. Investime dhe ide zhvillohen. Shoqëria jonë e futur në ekonominë e tregut ka nevojë për botime të tilla".

që vinin nga bota e ndërlikuar e teknologjisë së avancuar, produkte dhe shërbime të lehta në përdorim, që sillnin risi dhe që edukonin konsumatorët me standardet më të larta të performancës dhe dizajnit.

Këtë gjë dëshironte edhe konsulencë marketing në ideimin e "Tregu, marketingu, suksesi". Unë edhe ne dëshironim një tekst ndryshe, jo një kopi pastë, jo skematik. Unë dhe ne donim një shkëndijë marketingu në treg, një shkëndijë që të rrezatonte vlera reale marketingu dhe suksesi. Shkrimet në librin «Tregu, marketingu, suksesi » paraqesin një realitet lakuriq të evoluimit të kompanive shqiptare në rrugën e tyre të pa ndalur drejt suksesit. Natyrisht në këtë rrugë shumë prej tyre rrëzohen, shumë të tjera ringrihen dhimbshëm, por disa prej tyre shkëlqejnë. Këto syresh shkëlqejnë pasi kanë ditur të ngrenë organizata të vërteta ku skuadrat e tyre janë kryengritëse, koordinojnë mes tyre, dhe mbajnë me vete kudo që ndodhen objektivat e kompanisë, madje i reformojnë ato në shërbim të progresit. Këto organizata po kështu kanë zhvilluar marketing të jashtëm me një fluks derivatesh të tij si dhe janë kujdesur për një balancë mes marketingut të jashtëm dhe atij të brendshëm». Por Blerimi tashmë nuk mjafton me kaq, i është futur bukur mirë botës së marketingut. Ka vendosur të jetë në treg me një sipërmarrje marketingu e cila ka disa objektiva në kuadër të një planifikimi strategjik dhe konkretisht asistencë për kompanitë dhe biznesin, trajnim të punonjësve, shpërndarje e reklamës së kompanive, si postera, kalendarë, fletëpalosje, internet, etj., vendosje e logove në fasada, leksione dhe praktika marketingu, etj. Kjo sipërmarrje quhet Konsulencë marketing dhe ka për administrator zotin Blerim Deda. Përveç sa ma sipër Konsulencë marketing ka si synim të sjellë në treg botime specifike marketing si dhe të marrë përsipër shkrime në media për kompanitë shqiptare të suksesshme të cilat po revolucionarizojnë tregun duke emetuar produkte dhe shërbime të pa përsëritshme. Gjithmonë në shërbim të asaj që quhet kënaqësia konsumatore.

Në fund për të pranishmit u shtrua një koktej ku të gjithë bashkë dhe tokën gotat duke uruar Blerimin: "Suksese dhe të urojmë ky libër i sapo botuar të mos mbetet i fundit. Shoqëria jonë e futur në ekonominë e tregut ka nevojë për botime të tilla".

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.

Oficeri që hodhi në hava festin e kuq

Nga **DESTAN RAMA**

Krajka është një fshat me një bukuri të rrallë natyrore i pozicionuar ne shpatin jugor të malit me të njëjtin emër. Mali i Krajkës është vazhdimi i vargmalit lidor të Temlës dhe që përfundon tej deri mbi fshatin sofraçan.

Relievi i fshatit është i thyer me lugina e kodra te bukura të veshura me bimë e pemë frutore. Në mes të tyre dallon rrafshe të mbjellura me grurë, vreshta e kopshtije. Emri i fshatit Krajkë lidhet me dyndjet sllave në mbarim te shek. IV dhe fillimi i shek. V.

Në këtë vend u vendos udhëheqësi i tyre me emrin "Kral". Ky e ndërtoi qytezën bashkë me kalanë dhe muret rrethues të saj. Në këtë kohë qytëza e Krajkës mori nje zhvillim të madh që dallohej nga të gjithe fshatrat e tjerë të trevës së Grykës së Madhe, ndaj edhe emri ne nje version tjetër mund të lidhet me Kreu – Kraj – Krajkë.

Sidoqoftë emri i fshatit Krajkë njihet si vendbanim i hershëm që ne vitin 1273, biles dhe më parë me emrin Craye (Krajka). Mendohet që edhe ritet fetare, kishtare, banorët e qytezës i bënin në Libaraz (Lagj. Zerqanit) pasi këtu ishte kryeqendra e kataliçizmit për gjithe zonën. Këtë e ka dëshmuar rruga e shtruar me kalldrëm guri nga Qyteza – Zall Sopot – Kishë, Libaraz. Zbuluar gjate punimeve te banorëve vendas. Kalaja që ka qëndruar, rrënojat e të cilës duken edhe sot, mbi fshat, si shqiponja me krahëhapur gati për fluturim, është simboli i qëndresës shekullore të Krajkës dhe Grykës së Madhe, në luftërat për liri.

Në këtë fshat me emër u lind rreth vitit 1790 Fasli Malja. Në fakt llagapi i tij ishte Kurcani. Babai quhej Ismail, shkurt i thirrnin Male. Kështu duke i thirrur shpesh Fasliu i Males i mbeti llagapi Male (Fasli Malja).

Si gjithë fëmijët e tjerë djali u rrit me vështirësi të mëdha nga prindërit e tij, që në moshe të re, ai shkonte me bashkëmoshataret duke kullotur ato pak bagëti që kishte familja. Mali që kishte dhe Kalaja mbi shtëpi i fali qëndresën dhe madhështinë, shkëmbi fortësinë, dhe shqiponja krahët. Kështu ai dallonte mbi shoket e tij për zgjuarsi, shkathtësi, mençuri.

Dëshira për dije e mundonte shumë, për këtë me mjaft mundime e vështiresi vajti si shumë te rinjë të tjerë emigrant ne Turqi. Atje u shkollua dhe u bë një oficer i zoti në përvetësimin e artit ushtarak. Atje u lidh me shumë patriotë dhe atdhetarë te tjerë nga Gryka e Madhe e Shqipëria. Mori pjesë në disa fushta ushtarake te ushtrisë turke si komandant. Që këtu krijoi nje urrejtje të madhe kundër saj si një ushtri gjakatare e pushtuese dhe mezi priste momentin për ta braktisur atë.

Ndërkohë mendja nuk mund t'i shqitej nga Gryka e Madhe, nga Krajka e tij e dashur. Herë pas here e shkonte në mendje atë bukuri natyrore te fshatit që natyra ia kishte falur, por si në antitezë me të, ishte jeta e varfër e plot vuajtje të banorëve te tij. Shkaktar për këtë ishin regjimet e egra të pushtuesve, të cilat ia zinin frymën fshatit e gjithë trevës së Grykes së Madhe.

Momenti erdhi. 23 tetor 1844. Atë ditë lugina e Drinit të Zi ishte e veshur me një til të hollë mjegulle. Retë në qiellë lëviznin me një shpejtësi të paparë sa në lindje e në perëndim.



Shpesh herë copat e qiellit blu dukeshin ne sfond si për t'i grishur forcat kryengritese për lufte, për fitore. " Në gjetëshi kohë të bëni një sy gjumë sonte mirë, në mos u pjekshim nesër, - tha Sheh Mustafë Zerqani", komandanti drejtues i luftës të Nëntë Maleve të Dibrës, në mbledhje me të gjithë krerët e tyre.

Pra të nesërmen do të bëhej luftë. Forcat kryengritëse të Grykës së madhe me në krye Sheh Mustafën kishin zënë vijën Gjoricë – Çerenec. Filloi kështu një luftë e përgjakshme jo vetëm me armë, por edhe trup me trup me jatagana e shpata, me sopata dhe sokorre….

Fasli Malja ashtu si Skënderbeu në Betejën e Nishit u rreshtua për krah Sheh Mustafë Zerqanit. Me armën në dorë u fut thellë ne vijën e frontit turk dhe ia drejtoi pushkën mu në lule te ballit vetë Hajredin pashës, i cili shpëtoi për pak, sepse plumbi i Fasliut ia hodhi ne hava, të shpuar, festin e kuq.

Këtu mbeti ai si për t'u thënë kryengritësve: "vazhdojeni luftën me urretjen më të madhe kundër armikut, me pushkë, me hangjar, me thika, e me ç'tu ndodhet!."

Eshtrat e tij pushuan për jëtë në tokën e tij, në fshatin Krajkë, në vendin e quajtur "Vakuf".

Në gurin e varrit u shkrua turqisht epigrafi: "Fasli Malja rënë heroikisht ne luftën e Drinit të Zi më 1844".

Populli e përjetësoi me vargje luftën kundër Hajredin pashës.

Ndalu pashë ti ku po shkon?
S'durojm turk në vendin tonë,
Në çdo pëllëmbë vend,
këmbë armiku,
Si vullkan zien Rahoniku.
Gjëmojnë malet kërcet Radika,
I gjithë bregu u mbush me prita,
Skuqet Drini valë – valë,
Këmbë turku s'ka me dale.
Kush ia shpoi festin pashës?
Fasli Malja, qaku (plaku) i Krajkës...

Vijon nga faqja 21

Haxhi Lleshi sipas dokumenteve

Një xhaxha i tij, Aqif Lleshi, mbajti qëndrim të keq kundër Jugosllavisë, dhe ky qëndrim e bëri atë që Jugosllavia ta burgoste. Haxhi Lleshin, Hoxha e ngarkoi me këtë përgjegjësi, sepse ai ka një simpathi në popullin e Peshkopisë. Dhe s'ka dyshim se kjo është një nga manovrat djallëzore për të shti në dorë edhe popullin kreshnik të Peshkopisë...".

Në marrëdhëniet e shtetit me ndërkombëtarët ai është referuar edhe si kryetar i Parlamentit, President ose kryetar i Shtetit Shqiptar, e kjo është përjetuar në korrespondencën me kryetarët e shteteve, gjë e dokumentuar dhe e ruajtur në arkiva. Ai ka qenë një nga tre njerëzit më të fuqishëm të regjimit komunist, krahas Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut.

Haxhi Lleshi ka mbajtur këto dekorata e medalje: Medaljen e Kujtimit; Medaljen e Çlirimit; Urdhrin "Ylli i Kuq"; Medaljen e Trimërisë; Medaljen "10 vjetori i ushtrisë"; Urdhrin "Ylli Partizan" i klasit të parë; Urdhrin e Trimërisë; Urdhrin e Flamurit; Urdhrin e Lirisë të klasit të dytë; Urdhrin e Lirisë të klasit të parë (më 1 maj 1958 kur festoi 45 vjetorin e lindjes); Urdhrin e Lirisë të klasit të parë (me dekret nr.7337, datë 13.11.1989); Titullin "Hero i Popullit", me vendimin nr.142, datë 27.4.1963, të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, akorduar me rastin e 50 vjetorit të lindjes, etj. Po kështu ai është dekoruar nga Velimir Stojniç me medaljen "Ylli Partizan", në vitin 1947, të cilin Lleshi e ka quajtur shenjë vëllazërimi midis dy popujve kundër të njëjtëve armiq.

Haxhi Lleshi është zgjedhur kandidat në Komitetin Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë në kongresin e parë të saj dhe është rizgjedhur kandidat edhe në kongresin e dytë, ndërsa në kongresin e tretë të Partisë së Punës është zgjedhur anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe në vijim është zgjedhur në këtë funksion edhe në kongreset pasardhëse të saj. Figura e tij plotësohet më tej si i zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor në të gjitha legjislaturat e tij. Haxhi Lleshi është liruar nga detyra e lartë e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor më 22 nëntor 1982, afërsisht 30 vjet pas marrjes së detyrës, ndonëse në kremtimin e 60 vjetorit të lindjes Enver Hoxha i pati premtuar: *"...Ju do të qëndroni përjetësisht në detyrën e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor"*. Haxhi Lleshi e pa veten disa herë të lëkundur dhe me këtë



Haxhi Lleshi me ish partizanë të Çetës së Dibrës e kuadro si: Kalosh Daci,Selaudin Baftjari, Selim Pira, Shaqir Domi, Sali Hoxha, Hasan Jano, Qazim Prishtina, Ilmi Çausholli, Rexhep Doda, Adli Dibra, Sefer Muça e Ymer Lleshi, në 60 vjetorin e lindjes së tij më 1 Maj 1973

është përpjekur të abuzojë edhe ndonjë servil politik, por me shkrimet e publikuara e kanë burrëruar më tej Haxhi Leshin. Dokumentet arkivore prezantojnë një Haxhi me integritet, që nuk pranonte intrigat dhe nuk duronte bishtpërdredhurit. Karakteri malësorit të heshtur, të matur, të kujdesshëm, të vendosur e të palëkundur në fjalë, më shumë se asgjë tjetër nuk pranoi shumë afrimitet me dokëdo, pavarësisht pozitës së lartë politike, madje edhe anëtarë të Byrosë Politike Komuniste, gjë për të cilën janë shprehur edhe bashkëpunëtorët e tij, të cilëve shpesh u thoshte: "mos m'i afroni në zyrë".

Në pleqërinë e tij të thellë Haxhi Lleshi nuk ishte një person që ngeli jashtë vëmendjes politike, ndonëse kishte vite i pensionuar, por në shkurt 1991, Ramiz Alia e përzgjodhi atë midis shumë të tjerëve në të ashtuquajturin "këshill presidencial". Më 31 mars 1991, veterani Haxhi Lleshi u zgjodh deputet në emër të Komitetit të Veteranëve. Po ashtu Haxhi Lleshi nuk ngeli as jashtë vëmendjes së ambasadës ruse në Tiranë, madje me shpenzimet e shtetit rus, u bë i mundur edhe kurimi i tij në Rusi në vitet e pluralizmit. Këtë gjë e dëshmon vetë Lleshi gjatë një interviste dhënë për gazetën "Populli Po", të datës 5 nëntor 1994.

Emri e vepra atdhetare e Haxhi Lleshit ka zënë vend edhe në kujtimet e të huajve. Reginald Hibbert, në librin e tij "Fitorja e hidhur" Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, ka shënuar *"Haxhi Lleshi, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të Enver Hoxhës për krahinën e Dibrës, i ka kërkuar shpjegime Riçard Ridëllit dhe misionarëve të tjerë anglezë për mungesën e furnizimeve dhe embargon e vënë partizanëve nga Bari, qendra operacionale që mbështeste fuqitë ballkanike në luftë kundër gjermanëve"*, apo *"...udhëtova me Haxhi Lleshin dhe qeshë në gjendje të shihja mirëseardhjen e jashtëzakonshme me të cilën e prisnin, ndërsa ne kalonim përmes fshatrave që ishin të krahinës së vendlindjes së tij"*, më tej Haxhi Lleshi *"Ka pranuar rekomandimet e misionarëve anglezë "që t'i shihte krerët si aleatë të mundshëm e jo si armiq"*.

Edhe oficeri amerikan i Shërbimeve të Jashtme, Jacobs, në një Raport të Departamentit të Shtetit lidhur me Çështjet e Brendshme të Shqipërisë, në periudhën 1945-1949, ka shkruar: *"...vizitova Haxhi Lleshin, ministër i Brendshëm, i cili është një oficer ushtrie shumë i sjellshëm dhe mjaft i përmbajtur. Ai më tha se detyra e tij e parë ishte mbrojtja e ligjit dhe rregullit në vend dhe gradualisht këto funksione ai do t'ia kalonte Forcave të Mbrojtjes së Popullit. Ai më bëri të ditur që në vend ndodhnin krime të pakta dhe njerëzit ishin shumë të ndershëm, por megjithatë në malësi vazhdonin gjakmarrjet e vjetra...pak nga armiqtë e Frontit Nacionalçlirimtar fshiheshin në malet e tyre duke qëndruar në vende të fshehta, në pritje të ndonjë mundësie për të shpëtuar, dhe detyra e tij ishte që t'i kapte këta njerëz dhe më pas ata të dënoheshin. Ai më deklaroi në lidhje me këtë se disa persona të opozitës janë ende në male"*.

Emri i tij, Myslym Pezës e Dali Ndreut janë shënuar edhe në listën e Titos, por këto janë dëshmi intriguese për të gjithë ata që nuk i kanë ndjekur me kujdes prapaskenat e zhvillimeve të lëvizjes komuniste gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, gjë e cila rezulton njëlloj edhe në dokumentet e Shërbimit britanik SOE dhe në tetor 1952 edhe në listat e CIA-s, krahas Muharrem Bajraktarit, Sait Kryeziut, Abaz Kupit, Gjon Markagjonit, Dalip Ndreut, gjë që ka dalë në pah edhe më vonë kur emri i tij ishte planifikuar nga agjentura e përgatitur nga Vincent Fogart që të përzihej në ngjarjet e shtatorit të viti 1982, kur grupi i kryesuar nga Xhevdet Mustafa erdhi në Shqipëri. Duket se këtu loja e agjenturave synoi të përçajë udhëheqjen politike shqiptare e kjo kuptohet lehtë edhe në dëshminë e Halit Bajramit, kolegut të Sabaudin Haznedarit ish-mik e ish-luftëtarë me Haxhi Leshin në luftë, gjë e cila është shënuar në gjyqin kundër Kadri Hazbiut. Ndonëse Haxhi Lleshi respektohej e nderohej nga shtete të koalicionit botëror antifashist, apo vlerësohej prej qeverive të tyre për peshën e madhe në qeverinë komuniste, në vitin 1996, qeveria dhe shpuara e Sali Berishës, e arrestuan, e burgosën, e akuzuan për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, madje grupime politike të djathta e quajtën "diktator, kriminel, themelues i shoqatës së vullnetarëve të Enverit, shef i padeklaruar i sigurimit të shtetit, enverist, nostalgjik, konservator, etj". Haxhi Lleshi u është përgjigjur këtyre: *"...paraardhësit, gjyshërit dhe etërit e këtyre që sot na hiqen si triumfatorë, ishin ata që ikën me turp nga Shqipëria, së bashku me pushtuesit, më 29 nëntor 1944...ikën se i trembeshin drejtësisë, gjykimit të madh popullor, që do t'i damkoste me vulën e turpit për të gjitha krimet dhe tradhtitë e tyre të shëmtuara...akuza për gjoja krime e gjenocid është sot gjëja më e thjeshtë dhe më e zakonshme, me të cilën mund të rrasësh në burg dhe të dënosh si e sa të duash cilindo që ka qenë deri dje kundërshtari i yt politik."*

Ai ka kundërshtuar akuzën për gjenocid dhe terror duke theksuar: *"Kam qenë kurdoherë kundër terrorit dhe egërsisë. Të vrasësh, është gjëja më e lehtë në botë, të falësh është virtyt"*. Duke kërkuar respekt për të rënët, pa dallim kohe e sistemi politik, ai është shprehur: *"...njohja e veprës së dëshmorëve dhe luftëtarëve tanë është gjithashtu meritë dhe forcë karakteri, është detyrë e çdo pushteti dhe sistemi shoqëror"*. I thjeshtë si gjithnjë ai ka pohuar: *"Në ditën e çlirimit unë isha në listën e gjeneralëve, por mund të isha edhe në listën e dëshmorëve. Më takoi të isha në karrigen e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, por mund të isha edhe midis shokëve të mi, në një varr të thjeshtë dëshmori. Jam plagosur në luftë. Nëse mbeta i gjallë, kjo është rastësi. Mundet edhe të kisha vdekur dhe, në vendin tim, gjeneral apo president do të ishte një tjetër nga fitimtarët. Postet dhe gradat janë të përkohshme, i fiton, i humbet, i fiton përsëri, ndërsa nderi dhe burrëria janë të përjetshme. Po i humbe këto, ke humbur emrin, ke mbaruar me të tëra, siç themi ne në Dibër."*

Sa kanë shkruar Uran Butka dhe Blendi Fevziu për Haxhi Lleshin, tendenca e tyre është të mbulojnë lisin me miligona, por atyre ashtu ua do puna, të varakosin karavidhen e të tentojnë të ndryshkin floririn në llucën ku vegjetojnë.

Haxhi Lleshi njihet firmëtarë në dekretet e periudhës 1953-1982, në stimujt e titujt e nderit të njerëzve të shquar, dëshmorëve e njerëzve të dalluar në punë, në letërkëmbimet protokollare e në çdo përvjetor të festave kombëtare me kryetarë shtetesh. Ai ka nënshkruar aktet e gjykatave për dënimet kapitale dhe miratimet e lënies apo fitimit të nënshtetësisë shqiptare. Fakti që në ceremoninë mortore të Haxhi Lleshit kanë asistuar edhe atashetë ushtarakë të Rusisë, Kinës dhe Italisë e ngre emrin e tij si figurë e vlerësuar edhe në arenën ndërkombëtare. Ai nuk qe një rastësi në rrugëtimin për lirinë e Shqipërisë, ai ishte një personash real i madhështisë shqiptare, një përfaqësues i shquar i brezit të luftëtarëve antifashist, një diamant që meriton të ruhet në altarin e përjetësisë në kujtesën tonë historike.

Sot Dera e Lleshajve ngadhënjen, është hapur për miqtë e dashamirët, ka pavdekësinë, e ish-presidenti meriton përjetësinë në kujtesën historike shqiptare. Këtë ceremoni përkujtimore e konsideroj një qiri për shpirtërim e ngushëllim për prehje të qetë të Haxhi Lleshit, apel për qeveritarët që të mos ngurojnë, t'u bëjnë nder institucioneve duke pagëzuar rrugë, objekte apo institucione me emrin e nderuar "Haxhi Leshi".

foto e muajit



Në foto: Një turist i huaj duke shijuar bukuritë natyrore të Dibrës gjatë një udhëtimi me biçikletë.
Dibra fsheh shumë resurse turistike për vendasit dhe të huajt dhe me Rrugën e Arbrit ato do jenë më të vizitueshme.
Foto: © B.Karoshi

Firmos peticionin për rrugën e Arbrit
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arbëri-road-ndërtoni-sa-më-shpejt-dhe-me-standarde-rrugën-e-arbërit

cyan magenta yellow black